



COMMUNITY



# **KURRIKULA**

**për ngritjen e kapaciteteve të  
mësimdhënësve dhe punëtorëve rinorë  
për zbatimin e  
Projekteve të Vullnetarizmit Edukativ**

**REDAKTOR: EDINA MALKIĆ**

**AUTORËT SIPAS RENDIT ALFABETIK:**

- 1. ALŽBETA BROZMANOVÁ GREGOROVÁ**
- 2. EDINA MALKIĆ**
- 3. LEONITA BAJRA**

**Kurrikulë për ngritjen e kapaciteteve të mësimeve dhe punëtorëve rinorë për zbatimin e projekteve të Vullnetarizmit Edukativ**

**SHQYRTUESIT SIPAS RENDIT ALFABETIK:**

**ALEXANDRA RUSŇÁKOVÁ**  
**DONARTA UKA**  
**IVETA HARVÁNEKOVÁ**  
**LUCIA ROSSOVÁ**  
**MARIA BUTYKA**  
**MARKÉTA KOLÁČKOVÁ**  
**MARTA HAUSER**  
**TAMARA FABAC**

Kurrikula është krijuar si pjesë e projektit "Service-learning in fostering youth civic engagement, diversity, and social inclusion in the CEE region - SlipStream" shpallur në kuadër të Programit Erasmus+ (në tekstin e mëtejme Erasmus+), siç përcaktohet në kontratë. Numri 2023-1-SK220-YOU-000159836. Projekti zbatohet nga Platforma dobrovolníckých centier a organizací (Sllovakia), Udruga za razvoj civilnog drustva SMART (Kroaci), Fundatia noi orizonturi Lupeni (Rumani), Međunarodno udruženje "Interaktivne otvorene" - MIOS Tuzla (Bosnje dhe Hercegovinë), MIšniaskolz Národní asociace dobrovolnictví, z.s., (Republika Çeke), OJQ TOKA (Kosovë) dhe Center europeen du volontariat (CEV) (Belgjikë).

Mbështetja e Komisionit Evropian për prodhimin e këtij publikimi nuk miraton përmbajtjen që pasqyron vetëm pikëpamjet e autorëve dhe nuk është përgjegjës për çdo përdorim që mund t'i bëhet informacionit të përmbajtur në të



**Funded by  
the European Union**

## HYRJE

Vullnetarizmi Edukativ ose mësimi përmes angazhimit u mundëson fëmijëve dhe të rinjve të perceptojnë dhe zgjidhin probleme ose të adresojnë nevoja brenda komunitetit ndërsa marrin përvojë personale mësimore dhe zhvillojnë kompetenca të ndryshme. Theksi është në të nxënit përmes përvojës (mësimi duke bërë), i cili përfshin mësimin jashtë klasës ose organizatës së shoqërisë civile, në komunitetin ku ndodhin probleme reale dhe ndikojnë në jetën e qytetarëve. Vullnetarizmi Edukativ mund të zbatohet në shkolla, institucionet parashkollore, universitete si dhe në organizata të shoqërisë civile<sup>1</sup> me theks të veçantë në organizatat që punojnë me të rinj<sup>2</sup>. Ai siguron mësimin e asaj që duhet të mësohet ndërsa bëhet diçka e nevojshme dhe kuptimplotë ME dhe BRENDA komunitetit.

Shkurt, Vullnetarizmi Edukativ karakterizohet nga një lidhje e fortë midis përmbajtjes së kurrikulës dhe shërbimit (aktiviteteve vullnetare) që fëmijët ose të rinjtë ofrojnë brenda komunitetit, domethënë, ekuilibri i mësimin dhe shërbimit. Ai fillon nga nevoja(t) e njohura brenda komunitetit, duke lidhur aktivitete vullnetare me kurrikulën mësimore dhe përmes zbatimit të aktiviteteve vullnetare dhe mundësive të mësimin<sup>3</sup>, fëmijët ose të rinjtë mësojnë, reflektojnë dhe zhvillojnë qëndrime, njohuri dhe aftësi. Për më tepër, ata mësojnë për kontekstin në të cilin ofrohet shërbimi, lidhjen midis tij dhe objektivave të tyre të mësimin dhe zhvillimit personal dhe rolet e tyre si qytetarë.

Praktikat/projektet e Vullnetarizmit Edukativ<sup>4</sup> karakterizohen nga:

- Transferim i lartë i njohurive në baza ditore përmes mësimin në komunitetin lokal dhe shkollë/organizatë rinore,
- Zhvillim holistik i kompetencave të fëmijëve/të rinjve,
- Shkallë e lartë e pjesëmarrjes së fëmijëve/të rinjve në proceset e mësimin dhe vendimmarrjes lidhur me përmbajtjen, metodat dhe aktivitetet vullnetare (shërbimin),
- Kontakti me qytetarët, problemet dhe sfidat e tyre të jetës dhe ofrimi i mënyrave për të rritur cilësinë e jetës së bashku.

Kurrikula është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të organizatave partnere nga Europa për të zhvilluar burime gjithëpërfshirëse materiale për të kuptuar, zhvilluar dhe zbatuar praktikat/projektet e Vullnetarizmit Edukativ në ekosistemin arsimor<sup>5</sup> të Europës.

---

<sup>1</sup> Shumë organizata të shoqërisë civile në Evropë ofrojnë klube rinore ose klube vullnetare si një strukturë për të rinjtë që të angazhohen dhe të kontribuojnë në zhvillimin e komunitetit.

<sup>2</sup> Për lexim dhe lundrim të lehtë nëpër përmbajtje do të përdorim termin organizata rinore por po aq nënkuptojmë edhe organizata të shoqërisë civile.

<sup>3</sup> Në shkolla, institucione parashkollore dhe universitete ekzistojnë planprograme lëndore, planprogram me rezultate të të nxënit të cilat duhet të përmbushen gjatë vitit shkollor. Në organizatat e shoqërisë civile ekziston një program trajnimi apo kurrikulë për ngritjen e kapaciteteve të të rinjve që në këtë rast siguron lidhjen ndërmjet shërbimit dhe kurrikulës.

<sup>4</sup> Vullnetarizmi Edukativ është qasja që përdoret si pjesë integrale e procesit mësimor brenda shkollave, institucioneve parashkollore, universiteteve, prandaj quhet praktikë mësimore. Në organizatat e shoqërisë civile, organizata rinore zakonisht terminologjia është iniciativa rinore ose projekt rinor. Në këtë dokument me qëllim të leximit dhe lundrimit të lehtë nëpër përmbajtje, ne do të përdorim termin Projektet të Vullnetarizmit Edukativ.

<sup>5</sup> Nga ekosistemi arsimor ne pranojmë dhe përfshijmë të gjitha format e konteksteve dhe mundësive arsimore formale, joformale brenda Evropës.

Materiali është krijuar në kuadër të projektit “Vullnetarizmit Edukativ in fostering youth civic engagement, diversity and social inclusion in the CEE region” (shkurt SlipStream) financuar përmes programit Erasmus + - KA220-YOU - Partneritetet e bashkëpunimit në rini.

Qëllimi i këtij projekti është të nxisë dhe përmirësojë cilësinë e mundësive për pjesëmarrjen e të rinjve në jetën demokratike dhe angazhimin social e qytetar në komunitete përmes lidhjes së mësimit formal dhe joformal duke krijuar kushtet për zhvillimin e strategjisë së Vullnetarizmit Edukativ në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore (rajoni i EQL). Projekti dëshiron të krijojë mjete dhe kushte për të zbatuar Vullnetarizmin Edukativ dhe për ta bërë atë më gjithëpërfshirës.

Ne përgatitëm skemën e kurrikulës për ndërtimin e kapaciteteve të mësimeve të mësimdhënësve, punonjësve rinor të përfshirë drejtpërdrejt në punë ose proces edukativ me fëmijë dhe të rinj. Ajo siguron një pasqyrë të komponentëve thelbësorë të rëndësishëm për zbatimin e suksesshëm të projekteve të Vullnetarizmit Edukativ duke respektuar diversitetin e qasjeve dhe përvojave në zbatimin e pedagogjisë së Vullnetarizmit Edukativ në të gjithë Evropën.

Kurrikula shoqërohet me Doracakun/Manualin e metodave, mjeteve, ushtrimeve që mund të përdoren për trajnime si dhe për zbatimin praktik të Vullnetarizmit Edukativ dhe Manualin e standardeve të cilësisë për projektet e suksesshme të Vullnetarizmit Edukativ.

Ne ju urojmë mësim dhe zbatim të këndshëm të Vullnetarizmit Edukativ me fëmijët ose të rinjtë tuaj.

Konsorciumi SlipStream

# TABELA E PËRMBAJTJES

<b>HYRJE</b>	<b>1</b>
<b>FUSHA</b>	<b>4</b>
<b>GRUPI I SYNUAR</b>	<b>5</b>
<b>QËLLIMI I KURRIKULËS</b>	<b>5</b>
<b>REZULTATET E MËSIMIT</b>	<b>5</b>
<b>TEMAT PËR EDUKIM/TRAJNIM</b>	<b>6</b>
<b>METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË TRAJNIMIT</b>	<b>7</b>
<b>KOHËZGJATJA E TRAJNIMIT</b>	<b>8</b>
<b>MATERIALET MBËSHTETËSE TË MËSIMIT</b>	<b>9</b>
<b>CERTIFIKATA/KRENCENCIALET</b>	<b>9</b>
<b>KËSHILLA TË PËRGJITHSHME PËR TRAJNIMIN</b>	<b>9</b>
<b>RRJEDHA E TRAJNIMIT</b>	<b>10</b>
<b>PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE TË TRAJNIMIT:</b>	<b>13</b>
Kush është kush në dhomë	13
Biseda të Vogla	14
Çfarë pres dhe kam frikë nga ky udhëtim	15
Ne jemi komunitet	16
Udhëtimi ynë i të mësuarit	17
Pse Duhet të Ndryshoj Praktikën Time të Mësimdhënies?	18
Shërbimi dhe Mësimi në Vullnetarizmin Edukativ	19
Eksplorimi i Aktiviteteve të Orientuara nga Komuniteti	20
Parimet e Zbatimit të Edukimit të Fëmijëve dhe të rinjve për Vullnetarizëm (Parimet e Vullnetarizmit Edukativ)	22
Vullnetarizmi Edukativ nga A në Z – Koncepti dhe Modeli	26
Dallimi në mes të Koncepteve	27
Hapat në një Projekt Vullnetarizmi Edukativ në Komunitet	28
Strategjia e Marketingut për Palët e Interesuar	31
Tejkalimi i Barrierave në Implementimin e Vullnetarizmit Edukativ (S-L)	32
3. Puna në Grupe – Gjetja e Zgjidhjeve (25 minuta):	33
Objektivat e të Mësuarit ose të Shërbimit?	33
Përcaktimi i Objektivave të të mësuarit dhe të shërbimit	35
Vendosja e Qëllimeve në Vullnetarizmin Edukativ	38
Identifikimi i Shkaktarëve dhe Pasojave të Problemit	39
Një aktivitet ose çështje e komunitetit	42
Harta e Komunitetit dhe Identifikimi i Çështjeve në Komunitet	43
Shkrepja e Fotografive	44
Misioni i Pamundur	45
Reflektimi në Vullnetarizmin Edukativ	47

Reflektimi – Niveli, Llojet dhe Pyetjet	48
Pse Reflektimi dhe Vlerësimi	49
Hyrje në Reflektim	50
Standartet për Projektet e Vullnetarizmit Edukativ me Cilësi	52
Hetuesit e Standardeve të Cilësisë	54
Dhoma e Enigmave të Standardeve	58
Standardet e Cilësisë – Jigsaw	59
Udhëzime për zbatimin cilësor të Vullnetarizmit Edukativ	62
Një Yll Publik me Projektin e Vullnetarizmit Edukativ	66
Vlerësimi në Vullnetarizmin Edukativ	67
Koha për Festë	69
Mbyllja Kuptimplote e Projektit të Vullnetarizmit Edukativ	70
Cinquain	71
Çfarë pritet nga ne?	72
3 PPP në Projektet e Vullnetarizmit Edukativ	72
Porta - Rrugëtimi im i Vullnetarizmit Edukativ	74

## FUSHA

- Metodologjia e mësimdhënies - pedagogjia instruktive;
- Edukimi për qytetari aktive;
- Bashkëpunimi me komunitetin lokal;
- Puna e të rinjëve - Ngritja e kapaciteteve të të rinjve

## GRUPI I SYNUAR

Në përgjithësi, profesionistët e angazhuar në procesin edukativ me fëmijë dhe të rinj kanë të drejtë të ndjekin trajnimin.

Trajnimet mund të ndjekin nga:

- mësimdhënësit nga institucionet parashkollore
- mësimdhënësit nga shkolla fillore
- mësimdhënësit nga shkolla e mesme/e lartë
- Pedagogët, psikologët
- Pedagogët e edukimit special
- Asistentët mësimorë në Universitet - pedagogjia instruktive e çdo lënde shkollore
- Punëtorët rinor nga institucionet publike
- Punëtorët rinor nga organizatat rinore
- Vullnetarët nga organizatat rinore
- Studentët e Fakultetit të Psikologjisë dhe Edukimit

Lista e profesionistëve të kualifikuar nuk është vetëm kjo dhe ajo reflekton diversitetin e profesionistëve në peisazhin arsimor evropian.<sup>6</sup>

## QËLLIMI I KURRIKULËS

Kurrikula synon të zhvillojë dhe forcojë kompetencat e mësimdhënies dhe lehtësimit (facilitimit) të edukatorëve dhe profesionistëve të angazhuar në punën bashkëkohore arsimore me fëmijë dhe të rinj. Më konkretisht, ajo synon të zhvillojë kompetencat e nevojshme për të kuptuar, zhvilluar dhe zbatuar projekt të suksesshëm të Vullnetarizmit Edukativ me fëmijë dhe të rinj në institucione të arsimit formal dhe organizata rinore.

## REZULTATET E MËSIMIT

Pas trajnimit, pjesëmarrësi mund të:

- Shpjegojë kuptimin e Vullnetarizmit Edukativ, sfondin teorik dhe kontributin e Vullnetarizmit Edukativ në zhvillimin e kompetencave të fëmijëve dhe të rinjve si dhe zhvillimin e shkollave, organizatave rinore dhe komuniteteve;

---

<sup>6</sup> Në këtë dokument ne përdorim termin mësimdhënës dhe punëtor rinor me të cilin nënkuptojmë të gjithë profesionistët e angazhuar në procesin arsimor me fëmijët dhe të rinjtë .

- Shpjegojë ndryshimet midis Vullnetarizmit Edukativ dhe modeleve e strategjive të tjera të mësimdhënies dhe mësimi në arsimin formal dhe joformal;
- Njohë dhe shpjegojë fazat e zbatimit të projektit të Vullnetarizmit Edukativ;
- Përgatisë planin e përgjithshëm për zbatimin e Vullnetarizmit Edukativ në shkollë/organizatë rinore dhe komunitet;
- Përdorë metoda mësimore, teknika dhe burime, përfshirë ato dixhitale, për të kryer të gjitha fazat e Vullnetarizmit Edukativ;
- Zbatojë kërkimin e nevojave të komunitetit dhe përcaktojë nevojat primare për Vullnetarizmin Edukativ;
- Lidhë rezultatet e mësimi nga programet shkollore/kurrikulat e organizatës rinore me rezultatet e shërbimit në një projekt të Vullnetarizmit Edukativ;
- Integrojë nevojat dhe interesat e fëmijëve dhe të rinjve në zhvillimin e projektit të Vullnetarizmit Edukativ;
- Përdorë metoda jo-direktive të menaxhimit të klasës/grupit rinor ose klubit gjatë zbatimit të projektit të Vullnetarizmit Edukativ;
- Përdorë metoda të përshtatshme reflektimi për komponentin njohës, socio-emocional, civil të zhvillimit të fëmijëve dhe të rinjve gjatë zbatimit të projektit të Vullnetarizmit Edukativ;
- Lehtësojë procesin e zbatimit të Vullnetarizmit Edukativ në shkollë dhe komunitet me fëmijë dhe të rinjtë në kontekstin arsimor formal dhe joformal;
- Përfundoj fazat e Vullnetarizmit Edukativ në ekipe me kolegët dhe fëmijët/të rinjtë dhe partnerët në komunitet;
- Integrojë qasjet, metodat dhe mjetet ekzistuese nga pedagogjia e mësimdhënies (didaktika) në strukturën e Vullnetarizmit Edukativ;
- tregojë fleksibilitet, gatishmëri për të përdorur forma pjesëmarrëse të mësimdhënies në shkollë dhe organizata rinore;
- Krijojë me fëmijët dhe të rinjtë forma të ndryshme të dokumentimit të rezultateve të projektit të Vullnetarizmit Edukativ;
- Inkurajojë ndërveprimin dhe kohezionin në marrëdhëniet midis fëmijëve dhe të rinjve dhe mësimdhënësve/punonjësve rinor, dijë si të inkurajojë, zhvillojë dhe/ose përmirësojë ndërveprimin përmes projekteve të përbashkëta me fëmijë, të rinj, mësimdhënës, punëtor rinor, prindër, partnerë të jashtëm.

## TEMAT PËR EDUKIM/TRAJNIM

Temat e trajnimit:

### **Vullnetarizmi Edukativ si metodë e mësimdhënies bashkëkohore**

- Karakteristikat e Vullnetarizmit Edukativ;
- Bazat teorike të Vullnetarizmit Edukativ (Kolb, Dewey, Frankl, Freira, Gardner, Goleman)
- Standardet e cilësisë për Vullnetarizëm Edukativ të suksesshëm - një pasqyrë;

### **Fazat e implementimit të Vullnetarizmit Edukativ**

- Fazat dhe rrjedha e zbatimit të Vullnetarizmit Edukativ;



- Rolet e aktorëve të ndryshëm në Vullnetarizmin Edukativ: mësimitdhënësit, fëmijët, anëtarët e komunitetit, partnerët nga komuniteti;
- Parakushtet për punë të suksesshme në zbatimin e Vullnetarizmit Edukativ: përgatitja e ekipit të mësimitdhënësve ose punëtorëve rinor, grupit të fëmijëve ose të rinjve;
- Bashkë-krijimi i objektivave mësimore/rezultateve të mësimit dhe rezultateve të shërbimit.

### **Zbatimi praktik i Vullnetarizmit Edukativ**

- Përgatitja për zbatimin e Vullnetarizmit Edukativ;
- Vlerësimi i nevojave dhe përzgjedhja e një ideje për Vullnetarizmin Edukativ: metodat, procesi, aktorët;
- Përcaktimi i fazave të Vullnetarizmit Edukativ;
- Zbatimi i projektit: mësimi dhe shërbimet;
- Reflektimi: monitorimi i progresit të nxënësve dhe procesi i mentorimit gjatë zbatimit të Vullnetarizmit Edukativ;
- Metodot e reflektimit në procesin e mësimitdhënies: para, gjatë dhe pas;
- Festimi i mbylljes: Vlerësimi i arritjeve të Vullnetarizmit Edukativ, promovimi.

### **Standardet e cilësisë për Vullnetarizmin Edukativ**

- Standardet e cilësisë për praktikat/projektet e suksesshme të Vullnetarizmit Edukativ;
- Analizimi i ideve të Vullnetarizmit Edukativ përmes standardeve të cilësisë;
- Reflektimi, vlerësimi formativ dhe përmbledhës.

### **Puna me partnerët**

- Roli i partnerëve dhe gjetja e partnerëve brenda komunitetit;
- Si të përcaktohet roli i partnerëve në Vullnetarizmin Edukativ;
- Roli i partnerëve në reflektim;
- Komunikimi në ekip dhe me partnerët e jashtëm.

### **Dokumentacioni**

- Rëndësia e dokumentacionit
- Metodot e dokumentacionit

## **METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË TRAJNIMIT**

Trajnimi i Vullnetarizmit Edukativ është përvojë edukative shumë pjesëmarrëse. Qasjet e partnerëve dhe institucioneve të ndryshme tregojnë fleksibilitet të lartë në aspektin e formatit (fizike - online), kohëzgjatjes dhe procesit të mentorimit gjatë procesit të trajnimit.

Organizatrat rinore që punojnë me të rinjtë organizojnë për shembull kamp ose trajnim 3 deri në 6 ditë dhe punëtorët rinor ose udhëheqësit e klubeve rinore gradualisht mësojnë, përjetojnë, reflektojnë mbi përmbajtjen, procesin dhe zhvillimin e tyre. Në rastin e kampit, pjesëmarrësit kalojnë gjithashtu kohë rekreative së bashku, praktikojnë procesin e vendimmarrjes. Në këtë mënyrë ata marrin kuptim më të

thellë të lidhjes dhe besimit midis punëtorëve rinor dhe të rinjve për zbatimin e suksesshëm të Vullnetarizmit Edukativ dhe investimin e kohës në procesin e reflektimit.

Organizata që punon me shkolla, institucione parashkollore kombinon trajnime modulare: dy deri në tre takime dhe siguron mësimin përmes përvajës, qarqet e reflektimit, kuptimin e procesit të mësimdhënies në lidhje me ofrimin e shërbimit. Çdo modul mund të jetë dy deri në tre ditë i gjatë, në varësi të burimeve në dispozicion. Disa partnerë ofrojnë një takim hyrës online gjysmë dite që ofron raportin teorik, kuptimin e ndryshimit midis Vullnetarizmit Edukativ dhe çdo qasje tjetër metodologjike në praktikën e mësimdhënies, dhe një pasqyrë të fazave të Vullnetarizmit Edukativ. Kjo pasohet nga trajnime fizike me aktivitete të bazuara në përvajë. Midis moduleve pjesëmarrësit mund të punojnë në praktikë. Për shembull pas modulit të parë pjesëmarrësit mund të zbatojnë vlerësimin e nevojave me fëmijët ose të rinjtë e tyre dhe të kthehen me nevojë(a) reale që mund të përdoren për mësim dhe përgatitje të mëtejshme të projektit.

Trajnimi mund të ofrohet në format online në rast nevojë, qëllime mësimore dhe burimeve në dispozicion. Formati online mund të jetë sinkron ose asinkron. Në trajnimin online sinkron, trajneri dhe pjesëmarrësit takohen në "kohë reale" duke përdorur aplikacionin softuerik ose platformën për takim në kohë reale si MS office teams, Zoom, Hangout. Shtesë ata mund të përdorin aplikacione për proceset e bashkë-krijimit si Miro board, Padlet që është hapësirë virtuale për punë në grup dhe shkëmbim.

Në trajnimin online asinkron, pjesëmarrësit mësojnë në kohën dhe ritmin e tyre duke kaluar nëpër njësi të përmbajtjes dhe materialit. Pas çdo njësie pjesëmarrësit plotësojnë testin për të vlerësuar kuptimin dhe njohurinë që hap njësinë e re. Organizatori mund të zhvillojë këtë platformë duke përdorur mundësi të ndryshme.

Pjesë kritike gjatë zhvillimit profesional është procesi i mentorimit që ndodh midis trajnimeve dhe zbatimit praktik të Vullnetarizmit Edukativ. Këto janë rastet për të reflektuar përvajën dhe vështirësitë me pjesëmarrësit, qartësuar pyetjet dhe dyshimet, ofruar mjete të reja për zbatimin e fazave të Vullnetarizmit Edukativ, rretëzimin midis pjesëmarrësve. Numri i takimeve të mentorimit, kohëzgjatja e tyre varet nga organizatori dhe nevoja. Një shembull i kësaj është mbajtja e dy takimeve mentorimi - në fillim dhe në fund të zbatimit të Vullnetarizmit Edukativ - ose deri në 5 në varësi të kompleksitetit të projektit të Vullnetarizmit Edukativ dhe kapaciteteve të mësimdhënësve ose punëtorëve rinor.

Gjatë zbatimit të trajnimit, trajnerët mund të kombinojnë qasje, metoda dhe mjete të ndryshme për të përmbushur rezultatet e mësimin. Vullnetarizmi Edukativ është një qasje shumë dinamike në mësimdhënie dhe ndërtimin e kapaciteteve të të rinjve dhe mund të përfshijë punë individuale dhe në grup, metoda interaktive dhe bashkëpunuese të mësimdhënies, eksperimente, hapa analitike dhe zgjidhje problemesh, procese si vendimmarrja, përcaktimi i prioriteteve dhe mjete të ndryshme si harta e vlerësimit të nevojave, ose harta e empatisë ose mjete reflektimi për të siguruar angazhim, mësim dhe ndryshim pozitiv social brenda komunitetit si dhe brenda fëmijëve, të rinjve, mësimdhënësve dhe punëtorëve rinor.

## KOHËZGJATJA E TRAJNIMIT

Ne njohim diversitetin në peisazhin arsimor evropian, kështu që në aspektin e kohëzgjatjes ka qasje të ndryshme midis partnerëve. Në rastin e trajnimeve modulare mund të zgjasë deri në tre muaj kohëzgjatje - trajnim i ndërlidhur dhe zbatim praktik i Vullnetarizmit Edukativ. Partnerët në mesatare organizojnë rreth 50 deri në 24 orë trajnim efektiv dhe deri në 30 orë zbatim praktik duke përfshirë procesin e mentorimit. E njëjta gjë vlen edhe për një trajnim online asinkron. Megjithatë, kjo është vetëm një orientim dhe mund të përshtatet sipas nevojave organizative.

Ne nuk bëjmë kompromis në aspektin e përmbajtjes dhe të nxënies përmes përvojës që duhet të ndodhë në mënyrë që të kemi mësimdhënës dhe punëtor rinor kompetentë dhe të gatshëm për ta zbatuar atë.

## MATERIALET MBËSHTETËSE TË MËSIMIT

- Materiale trajnimi - fletë pune, ushtrime,
- Manual për zbatimin e praktikave/projekteve të Vullnetarizmit Edukativ në shkolla, organizata të shoqërisë civile me metoda, mjete dhe shembuj,
- Përshkrime të shembujve të projekteve/praktikave të suksesshme të Vullnetarizmit Edukativ (dixhitale, video, ...).

## CERTIFIKATA/KRENCIALET

Pjesëmarrja në trajnim u lejon pjesëmarrësve të marrin një certifikatë kompetence për zbatimin e Vullnetarizmit Edukativ me pjesëmarrje minimale të pritshme gjatë trajnimit: 80% e orëve të planifikuara/realizuara të trajnimit.

Disa organizata shtojnë një kriter tjetër - zbatimin e një projekti të Vullnetarizmit Edukativ. Megjithatë, ky është një kriter OPSIONAL dhe një vendim individual i organizatës organizatore.

## KËSHILLA TË PËRGJITHSHME PËR TRAJNIMIN

Përgatitja e një trajnimi të suksesshëm është një hap i rëndësishëm përpara ofrimit të përmbajtjes së trajnimit. Përfshin përgatitjen e trajnerit, materialin e trajnimit dhe hapësirën dhe burimet e trajnimit.

**Përgatitja e trajnerit** përfshin vendimmarrjen për kohëzgjatjen, formatin dhe thellësinë e procesit të të mësuarit të pjesëmarrësit. Trajneri pritët të përgatisë skenarin e trajnimit ose planin e rrjedhës së trajnimit për të siguruar mësimin dhe angazhimin kuptimplotë të pjesëmarrësit. Skenari i trajnimit përfshin rrjedhën e trajnimit nga fillimi në fund të aktivitetit, pavarësisht nëse trajnimi po zhvillohet fizikisht apo në formatin online. Ai përbëhet nga informacioni i qëllimit të aktivitetit, përshkrimi i aktivitetit, qasja dhe metodat që do të përdoren për organizimin e pjesëmarrësve, materialin e nevojshëm mësimor, burimet e nevojshme, kushtet teknike, caktimin e kohës për çdo aktivitet. Kjo mund të organizohet në formatin e tabelës ose në skriptin e detajuar të trajnimit (në varësi të përvojave

të trajnerit). Në rast se trajnimi mbahet nga dy trajnerë, të dy trajnerët planifikojnë skenarin dhe ndajnë përbajtjen mes njëri-tjetrit në mënyrë që trajnimi të mbahet pa probleme.

Në përgjithësi rekomandohet të ketë një raport të ekuilibruar të aktiviteteve mësimore, aktiviteteve për pushim mendor dhe aktivizimin e sistemit nervor - p.sh. akullthyes, aktivizim energjie, lojëra dhe pushime. Kjo kurrikulë nuk ofron sugjerime për ato aktivitete por ne ju inkurajojmë t'i siguroni ato në procesin tuaj të trajnimit, qoftë nga ju ose nga pjesëmarrësit.

**Përgatitja e materialeve të trajnimit:** siç tregohet në skenarin e trajnimit, trajneri(ët) pritet të përgatisin materialin e trajnimit (p.sh. studime të rasteve, fletë pune, postera ose çdo material tjetër) që pjesëmarrësit do ta përdorin gjatë trajnimit në kopje të mjaftueshme. Në rastin e trajnerëve të trajnimit online pritet t'i përgatisë ato në aplikacione të përshtatshme (p.sh. Padlet, Zoom, Jamboard, etj) për përdorim gjatë trajnimit. Gjithashtu, ju lutemi merrni parasysh përdorimin e materialit të formatit dixhital si p.sh. fletushkat e leximit të cilat mund të ndahen për shembull, përmes QR kodit. Në këtë mënyrë ne kursejmë burimet.

**Hapësira dhe burimet e trajnimit** përfshijnë hapësirën ku do të zhvillohet trajnimi dhe burimet teknike për të pasur trajnime të suksesshme (laptop, projektor, energji elektrike, tabela flipchart, etj). Hapësira është një segment i rëndësishëm i përgatitjes së trajnimit. Dhoma duhet të jetë mjaft e madhe që të ketë të gjithë pjesëmarrësit me hapësirë të mjaftueshme për të lëvizur, mjaftueshëm e ngrohtë ose e ftohtë për të mos anashkaluar mësimin, dritë dhe ajër të pastër të mjaftueshëm, karrige të rehatshme, të organizuara në atë mënyrë që të sigurojë një pamje të lehtë në ekranin e projektimit. Në rast të një trajnimi online, jepini këshilla të ngjashme pjesëmarrësve.

Të tre komponentët e përgatitjes duhet të bëhen para trajnimit. Trajnerët dhe përgatitja e materialit duhet të bëhet të paktën tre ditë para trajnimit dhe hapësira të paktën një ditë para trajnimit.

## RRJEDHA E TRAJNIMIT

Trajnimi për mësimdhënësit dhe punëtorët rinor mbi pedagogjinë e Vullnetarizmit Edukativ është një proces mësimor me shumë pjesëmarrës. Ai përfshin punë praktike, studime rastesh, proceset e planifikimit dhe reflektimit. Siç është përshkruar në seksionet e mëparshme, metodologjia e trajnimit, koha dhe formati mund të përshtaten për nevojat e pjesëmarrësve si dhe për nevojat e organizatave organizuese.

Faqet në vijim përmbajnë mjete dhe aktivitete që trajnuesit mund të përdorin gjatë trajnimit. Përbajtja është e organizuar sipas temave të trajnimit, por në praktikë kjo mund të organizohet në rend të ndryshëm në varësi të nevojave, qëllimeve të trajnimit dhe rezultateve që priten. Lista e mjeteve dhe aktiviteteve të ofruara nuk është përfundimtare dhe mund të përdorni edhe mjete të tjera, për sa kohë që ato sigurojnë mësimin e pjesëmarrësve (rezultatet e mësimin).

Gjithashtu, është shumë e rekomanduar që trajnerët të përdorin aktivitete dhe mjete nga "Manuali i metodave dhe mjeteve për projektet e Vullnetarizmit Edukativ" dhe "Standardet e Cilësisë për projekte të suksesshme të Vullnetarizmit Edukativ në punën me të rinjtë ". Ky manual përmban mjete dhe

aktivitete të përshtatshme që pjesëmarrësit do të përdorin gjatë mësimit mbi Vullnetarizmin Edukativ duke siguruar kështu një shpërndarje më të lehtë në praktikë më vonë. Për shembull:

- Për krijimin e qëllimeve të mësimit, trajneri/ja mund të përdorë matricën e qëllimeve të mësimit nga manuali;
- Për hartimin e nevojave të komunitetit, trajneri/ja mund të përdorë një ose më shumë metoda të hartimit të nevojave nga manuali;
- Për reflektimin e mësimit gjatë trajnimit, trajneri/ja mund të përdorë metodat e sugjeruara të reflektimit nga manuali duke demonstruar përdorimin e duhur të këtyre metodave të reflektimit për të siguruar mësim dhe zhvillim të fëmijëve/rinjëve (në aspektin kognitiv, social, emocional dhe qytetar të mësimit).

**Tabela me një përmbledhje të përmbajtjes së kurrikulës dhe aktiviteteve të sugjeruara**

Tema	Mjetet dhe aktivitetet për trajnerët
<p>Hyrja</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Prezantimi i pjesëmarrësve</li> <li>● Pritshmëritë dhe frikërat</li> <li>● Rregullat</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Kush është kush në dhomë</li> <li>● Biseda të vogla</li> <li>● Çfarë pres dhe kam frikë nga ky udhëtim</li> <li>● Ne jemi komunitet</li> <li>● Udhëtimi ynë i mësimit</li> </ul>
<p>Vullnetarizmi Edukativ – bazat</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Karakteristikat kryesore</li> <li>● Hapat dhe procesi i përgjithshëm</li> <li>● Llojet e shërbimit të Vullnetarizmit Edukativ</li> <li>● Kuadrantet e Vullnetarizmit Edukativ</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● A duhet të ndryshojë praktika ime mësimore? Pse?</li> <li>● Shërbimi dhe mësimi në Vullnetarizmin Edukativ</li> <li>● Eksplorimi i aktiviteteve të orientuara ndaj komunitetit</li> <li>● Parimet e zbatimit të edukatës për fëmijët dhe të rinjtë në vullnetarizëm (Parimet e Vullnetarizmit Edukativ)</li> <li>● Vullnetarizmi Edukativ nga A në Z – Koncepti dhe Modeli</li> <li>● Dallimi midis koncepteve</li> </ul>
<p>Përgatitja për zbatimin e S-L + pengesat e implementimit dhe si t'i kalojmë ato</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Hapat në një Projekt të Community Vullnetarizmit Edukativ</li> <li>● Përgatitja për zbatimin e Vullnetarizmit Edukativ</li> <li>● "Strategjia e marketingut" për palët e interesuara</li> <li>● Kapërcimi i pengesave në zbatimin e Vullnetarizmit Edukativ</li> </ul>
<p>Objektivat në S-L</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Objektivat e të mësuarit</li> <li>● Objektivat e shërbimit</li> <li>● Si të lidhim objektivat e mësimit dhe të shërbimit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Vendosja e objektivave të mësimit dhe të shërbimit</li> <li>● Objektiva e të mësuarit apo të shërbimit</li> <li>● Vendosja e qëllimeve në Vullnetarizmin Edukativ</li> <li>● Identifikimi i shkaqeve dhe pasojave të problemit</li> </ul>

Hartimi i nevojave, hartimi i komunitetit	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Një aktivitet ose çështje e komunitetit</li> <li>● Hartimi i komunitetit</li> <li>● Shënim fotografik</li> </ul>
Planifikimi i projektit Vullnetarizmi Edukativ	3 PPP në projektet Vullnetarizmi Edukativ
Veprimi <ul style="list-style-type: none"> <li>● Roli i mësimdhënësit</li> </ul>	Misioni i pamundur
Reflektimi në Vullnetarizmin Edukativ	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Prezantimi i reflektimit</li> <li>● Reflektimi në Vullnetarizmin Edukativ</li> <li>● Reflektimi – nivelet, llojet dhe pyetjet</li> <li>● Pse reflektimi dhe vlerësimi?</li> </ul>
Standardet e Cilësisë për praktikën e suksesshme të Vullnetarizmit Edukativ	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Standardet për projektet e cilësisë së Vullnetarizmit Edukativ</li> <li>● Hetuesit e standardeve të cilësisë</li> <li>● Dhomat e enigmave të standardeve</li> <li>● Jigsaw i standardeve të cilësisë</li> <li>● Udhëzime për zbatimin e cilësisë së Vullnetarizmit Edukativ</li> </ul>
Komunikimi dhe dokumentimi	Një yll publik me projektin Vullnetarizmi Edukativ
Vlerësimi <ul style="list-style-type: none"> <li>● Vlerësimi i mësimi</li> <li>● Vlerësimi i shërbimit</li> </ul>	Vlerësimi në VE
Festimi dhe mbyllja	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Koha për festë</li> <li>● Mbyllja kuptimplotë e projektit Vullnetarizmi Edukativ</li> </ul>
Vlerësimi i trajnimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Cinquain (poezi e shkurtër)</li> <li>● Çfarë ndodhi me pritshmëritë tona</li> <li>● Porta – udhëtimi im në Vullnetarizmin Edukativ</li> </ul>

## PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE TË TRAJNIMIT:

### Kush është kush në dhomë

**Kohëzgjatja:** 20 minuta

#### Përshkrimi:

Ky aktivitet hyrës u mundëson pjesëmarrësve të prezantohen dhe të njohin më mirë njëri-tjetrin duke

shpërndarë informacion mbi përvojën e tyre në lidhje me Vullnetarizmin Edukativ. Çdo pjesëmarrës do të thotë emrin e tij, organizatën ose institucionin ku punon, qytetin nga vjen dhe përvojën e tij me Vullnetarizmin Edukativ. Pas prezantimit, pjesëmarrësit do të shkruajnë emrin e tyre në një copë ngjitëse dhe ta vendosin në rrobat e tyre, në mënyrë që të tjerët t'ua kujtojnë lehtësisht emrin. Vetëm personi që mban topin mund të flasë. Pas prezantimit ata do të kalojnë topin te një pjesëmarrës tjetër i cili do të prezantohet. Trajneri duhet të llogarisë kohën e caktuar për çdo pjesëmarrës, në varësi të numrit të tyre.

#### **Materialet e Nevojshme:**

- Top i vogël ose ndonjë objekt që mund të kalojë lehtësisht (diçka të lehtë për t'u mbajtur)
- Ngjitëse
- Markera

#### **Udhëzime për Trajnerin:**

1. Do të bëjmë një aktivitet të shpejtë prezantimi për t'u njohur më mirë me njëri-tjetrin. Çdo person do të prezantohet duke thënë:

- Emrin e tij/saj,
- Organizatën ose institucionin që përfaqëson,
- Qytetin nga vjen dhe
- Përvojën e tij/saj me Vullnetarizmin Edukativ.

2. Pasi të përfundojmë prezantimin, shkruajeni emrin tuaj në një cope ngjitëse dhe ngjitni atë në rrobat tuaja, në mënyrë që të gjithë mund ta kujtojnë lehtësisht emrin tuaj.

3. Personi që mban topin është i vetmi që mund të flasë. Pas prezantimit, ai do ta kalojë topin tek dikush tjetër që nuk ka folur ende dhe personi tjetër do të prezantohet.

4. Le të fillojmë! Unë do të filloj i pari, pastaj do ta kaloj topin tek dikush tjetër.

#### **Biseda të Vogla**

Ky aktivitet ka për qëllim që të ndihmojë pjesëmarrësit të njohin më mirë njëri-tjetrin pas prezantimit të emrit dhe është një aktivitet interaktiv dhe në lëvizje. Ai u mundëson pjesëmarrësve të krijojnë lidhje dhe të përgatiten për punën që do të bëjnë së bashku.

#### **Materialet e Nevojshme:**

- Kohëmatës (ose orë për të ndjekur kohën)
- Sinjalizues (duartrokitje, bilbil, ose ndonjë tingull tjetër për të treguar fundin e një raundi)

#### **Kohëzgjatja:**

10 minuta (ose më shumë nëse ka shumë pjesëmarrës)

- **1 minutë për çdo bisedë çift-shi**
- **Të paktën 5 runde të bisedës (mund të shtohen runda të tjera në varësi të numrit të pjesëmarrësve)**

### **Udhëzime për Trajnerin:**

Pjesëmarrësit do të ftohen të ngrihen në këmbë dhe të formojnë çifte. Trajneri do të shpallë një temë bisede për çdo raund dhe pjesëmarrësit do të kenë 1 minutë për të biseduar me partnerin e tyre për temën e caktuar. Pas përfundimit të minutës do të bjerë një sinjal (p.sh. një duartrokite, zile ose tingull tjetër) për të treguar se është koha për të ndërruar partnerë. Më pas trajneri do të shpallë një temë të re bisede për raundin tjetër. Çiftet do të ndryshojnë të paktën 5 herë dhe mund të shtohen më shumë raunde nëse ka shumë pjesëmarrës. Qëllimi është që pjesëmarrësit të ndërveprojnë shkurtimisht me disa njerëz të ndryshëm dhe të diskutojnë një sërë temash.

### **Temat e bisedave janë:**

- Përvoja ime me vullnetarizmin
- Të rinjtë e sotëm
- Cilat janë forcat e mia (çfarë bëj mirë)
- Pushimi im i ëndrrave
- Një rekomandim për librin tim të preferuar
- Çfarë më pëlqen më shumë nga puna ime

### **Çfarë pres dhe kam frikë nga ky udhëtim**

**Kohëzgjatja:** 20 minuta

### **Përshkrimi:**

Ky aktivitet i inkurajon pjesëmarrësit të reflektojnë mbi pritshmëritë e tyre, vetëdijen dhe shqetësimet e mundshme në lidhje me trajnimin. Secili pjesëmarrës do të shkruajë përgjigjet e tij/saj për katër pyetje specifike në ngjitëse post-it (sticky notes) me ngjyra të ndryshme:

1. "Çfarë pres nga trajnimi?"
2. "Çfarë pres nga grupi?"
3. "Çfarë pres nga vetja?"
4. "Nga çfarë kam frikë? A ka ndonjë gjë që nuk dua të ndodhë gjatë këtij trajnimi?"

Pas pesë minutash reflektimi individual, pjesëmarrësit vendosin postimet e tyre në një tabelë të ndarë në katër kolona, secila e etiketuar me një nga pyetjet. Ndërsa ngjitin shënimet e tyre në kolonat përkatëse, ata i shpjegojnë shkurtimisht grupit. Trajneri komenton pritshmëritë e pjesëmarrësve, identifikon se si trajnimi mund t'i përmbushë këto kërkesa dhe nëse disa pritshmëri janë përtej qëllimit të trajnimit, sugjeron burime ose njerëz që mund të ndihmojnë. Trajneri trajton gjithashtu frikën e përbashkët, duke diskutuar mënyrat për t'i zbutur ato dhe nëse është e përshtatshme, pyet: "Përgjegjësia e kujt është?" Kjo pyetje mund të çojë në krijimin e rregullave të grupit si aktiviteti tjetër.

### **Materialet e Nevojshme:**

- Katër ngjitëse post-it me ngjyra të ndryshme për çdo pjesëmarrës
- Flipchart i ndarë në katër kolona të etiketuar me pyetjet
- Markera



- Fletë të mëdha për rregullat e grupit (opsionale mund të ilustrohen, si një kod)
- Ngjites për ta vendosur kontratën finale të grupit

### Udhëzime për Trajnerin:

1. "Do të fillojmë me një aktivitet reflektues për të kuptuar më mirë çfarë secili prej nesh shpreson të fitojë, ndaj me të tjerët dhe të ndajmë disa shqetësime që mund të kemi rreth këtij trajnimi.
2. Merrni katër ngjitëse post-it me ngjyra të ndryshme. Do t'ju kërkoj të shkruani përgjigjet për këto katër pyetje – një në çdo ngjitës:
  - Çfarë pres nga ky trajnim?
  - Çfarë pres nga grupi?
  - Çfarë pres nga vetja ime?
  - Çfarë më frikëson? Ka diçka që nuk dua të ndodhë gjatë këtij trajnimi?
3. Keni 5 minuta për të shkruar përgjigjet.
4. Kur të keni përfunduar, ejeni te flipchart-i dhe vendosni çdo ngjitës në kolonën e duhur. Pasi ta keni bërë këtë, mund të ndani për secilën përgjigje me grupin.
5. (Pasi të kenë përfunduar të gjithë pjesëmarrësit) Unë do të rishikoj pritshmëritë dhe frikërat dhe do të shpjegoj si ky trajnim mund të adresojë pritshmëritë tuaja. Nëse disa pritshmëri janë jashtë fushës së trajnimit, do t'ju sugjeroj burime të tjera ose mbështetje.
6. (Për frikërat) Le të diskutojmë si të adresojmë shqetësimet tona. Ndonjëherë frikërat mund të zvogëlohen nëse kuptojmë se ku qëndron përgjegjësia. Le të mendojmë – kujt i takon kjo përgjegjësi? Kjo do të na ndihmojë të krijojmë disa rregulla grupi në aktivitetin tjetër."

## Ne jemi komunitet

**Kohëzgjatja:** 15 minuta

### Përshkrimi:

Në këtë aktivitet, pjesëmarrësit përcaktojnë në mënyrë bashkëpunuese rregullat që duan të ndjekin gjatë trajnimit bazuar në përvojat dhe pritshmëritë e tyre të kaluara. Secili pjesëmarrës ndan atë që ata besojnë se është e nevojshme për një mjedis të respektueshëm, produktiv dhe të këndshëm. Trajneri i shkruan këto rregulla në një tabelë ose letër të madhe, e cila do të vendoset në një vend të dukshëm gjatë gjithë trajnimit.

Rregullat e sugjeruara:

1. Respektoni opinionet e njëri-tjetrit – Pikëpamja e secilit është e vlefshme dhe duhet trajtuar me respekt edhe nëse ka mosmarrëveshje.
2. Dëgjimi aktiv – Dëgjoni me kujdes kur dikush është duke folur pa e ndërprerë.
3. Konfidencialiteti – Informacioni personal i ndarë brenda grupit duhet të qëndrojë brenda grupit.
4. Përpikëri – Mbërritni në kohë për të respektuar oraret e njëri-tjetrit dhe për të ruajtur rrjedhën në sesione.

Pjesëmarrësit mund të diskutojnë nëse do të përfshijnë pasojat për shkeljen e rregullave dhe të bien dakord që lista të mbetet e hapur duke lejuar shtimin e rregullave tjera sipas nevojës.

### **Materialet e Nevojshme:**

- Flipchart ose fletë e madhe
- Markera
- Shirit ngjites për t'i vendosur rregullat

### **Udhëzime për Trajnerin:**

1. "Pasi kemi diskutuar pritshmëritë dhe shqetësimet tona, do të kalojmë në një aktivitet për të përcaktuar disa rregulla grupi për të udhëhequr ndërveprimet tona gjatë trajnimit."
2. "Mendoni për atë që do të kishit nevojë nga ky grup për t'u ndjerë të rehatshëm, të përqendruar dhe të mbështetur."
3. "Kur të ndani idetë tuaja, unë do t'i shkruaj rregullat në flipchart, dhe kur të mbarojmë, do ta vendosim atë në një vend të dukshëm për të gjithë."
4. "Ja disa sugjerime për të filluar: Respektoni mendimet e të tjerëve, Dëgjim aktiv, Konfidencialitet."
5. "Po ashtu, mund të vendosim së bashku nëse do të ketë pasoja për mosrespektimin e këtyre rregullave."
6. "Në fund, le të bien dakord që kjo listë të mbetet e hapur, kështu që mund të shtojmë rregulla të reja."

**Hapi tjetër:** Vendoseni fletën e rregullave në një vend të dukshëm, duke i lejuar të gjithë t'i referohen asaj dhe të përshtaten sipas nevojës.

### **Udhëtimi ynë i të mësuarit**

**Kohëzgjatja:** 50 minuta

#### **Përshkrimi:**

Ky aktivitet synon të krijojë një marrëveshje grupore me rregulla dhe parime të dakorduara reciprokisht, të cilat do të udhëheqin sjelljen dhe ndërveprimin e të gjithë pjesëmarrësve gjatë trajnimit ose projektit. Procesi i inkurajon pjesëmarrësit të kontribuojnë me pritshmëritë dhe shqetësimet e tyre personale të cilat më pas përkthehen në udhëzime të qarta, të zbatueshme që të gjithë mund t'i respektojnë dhe ndjekin. Aktiviteti nxit ndjenjën e përgjegjësisë së përbashkët dhe ndihmon në krijimin e një atmosfere pozitive dhe të sigurt brenda grupit.

#### **Udhëzime për Trajnerin:**

1. Filloni duke shpjeguar qëllimin e aktivitetit: të krijoni një kontratë në grup që do të shërbejë si një udhëzues për mënyrën se si sillen dhe ndërveprojnë të gjithë gjatë trajnimit ose projektit. Theksoni se kur njerëzit vendosin rregullat e tyre, ata kanë më shumë gjasa t'i ndjekin ato sesa kur ato imponohen nga jashtë.
2. Lëri pjesëmarrësit të ulen në një gjysmërreth përballë trajnerëve. Shpjegoni se për ditët në vijim, ata do të punojnë së bashku dhe është thelbësore që të gjithë të ndihen rehat dhe të sigurt, duke ndjekur takimet me entuziazëm dhe jo me ankth.

3. Shpërndani ngjitëse post-it dhe stilolapsa për secilin pjesëmarrës. Kërkojuni atyre të shkruajnë diçka që është e rëndësishme për ta për t'u ndjerë rehat në grup, diçka që do të ndihmojë në ruajtjen e një atmosfere pozitive. Ata mund të mendojnë për momentet kur janë ndjerë të përhumbur në një grup apo situatë dhe të reflektojnë se përse ishte kjo.
4. "Disa shembuj për t'ju ndihmuar:
  - o 'Nuk pranoj dhunë fizike, as edhe për shaka.'
  - o 'Nuk më pëlqejnë komentet për pamjen fizike.'
  - o 'Më shqetëson kur dikush më ndërpret.'
  - o 'Është e rëndësishme për mua të dëgjoj mendimet e të gjithëve.'
  - o 'Nuk më pëlqen kur dikush preferohet mbi të tjerët.'
  - o 'Më shqetëson kur dikush vonohet.'
  - o 'Nuk më pëlqen kur formohen grupe të vogla brenda grupit.'
  - o 'Më shqetëson kur dikush bën gjeste përqeshëse ndaj të tjerëve.'
5. Jepuni pjesëmarrësve 5-6 minuta për të shkruar idetë e tyre në ngjitëset post-it. Kur shumica e grupit të ketë mbaruar, nxitini ata që nuk kanë mbaruar të përfundojnë për rreth 1 minutë.
6. Kërkojuni pjesëmarrësve të fillojnë të lexojnë shënimet e tyre një nga një. Ndërsa secili pjesëmarrës lexon, trajneri/ja duhet të shënojë konceptet kryesore në tabelë (p.sh., "pa tallje") dhe të pyesë nëse dikush tjetër ka një rregull të ngjashëm.
7. Mblidhni shënimet dhe rregullojini pranë fjalëve përkatëse të shkruara në tabelë. Vazhdoni këtë proces derisa të diskutohen të gjitha shënimet.
8. Pasi të mblidhen të gjitha rregullat, shpjegoni se këto seksione do të formojnë themelin e kontratës në grup (p.sh. respekti, komunikimi, pa dhunë).
9. Krijoni një faqe të re flipchart me titullin "Kontrata". Pyetni pjesëmarrësit se çfarë mendojnë kur dëgjojnë fjalën "kontratë" dhe mblidhni përgjigjet e tyre. Shpjegoni se një kontratë është një marrëveshje midis njerëzve për t'u sjellë në një mënyrë të caktuar.
10. Kaloni nëpër çdo seksion të shkruar në flipchart, duke pyetur nëse duhet të përfshihet në kontratë. Për shembull, "A mendojmë se "asnjë tallje" duhet të jetë pjesë e kontratës?" Mblidhni komente nga pjesëmarrësit dhe shkruani rregullat përfundimtare të kontratës.
11. Pas përfundimit të kontratës, përgëzojeni grupin për krijimin e saj. Kërkojuni të gjithëve të nënshkruajnë kontratën, duke theksuar se nënshkrimi i saj do të thotë të angazhoheni për t'iu përmbajtur rregullave.
12. Diskutoni rëndësinë e mbajtjes së këtyre rregullave dhe se si ato do ta ndihmojnë grupin të funksionojë në mënyrë efektive dhe harmonike.

### **Përmbledhje:**

- Si u ndjetë gjatë këtij procesi?
- Pse mendoni se kjo kontratë është e rëndësishme për grupin?
- Çfarë sfidash mendoni se mund të lindin në ndjekjen e kësaj kontrate?
- A mund të mendoni për situata të tjera jashtë këtij grupi ku një proces i ngjashëm do të ishte i dobishëm?

Shënim për lehtësuesin: Nëse ndonjë pjesëmarrës refuzon të nënshkruajë kontratën, sigurojeni grupin se të gjithë janë një individ i pavarur. Bëjini të ditur se janë të lirë të zgjedhin nëse do të nënshkruajnë,

por nëse vendosin të mos nënshkruajnë, kjo mund të ndikojë në pjesëmarrjen e tyre. Ofroni një bisedë private pas sesionit nëse është e nevojshme.

## **Pse duhet të ndryshoj praktikën time të mësimdhënies?**

**Kohëzgjatja:** 45 minuta

Përshkrimi:

Trajneri/ja do të përdorë një version të modifikuar të metodës së Disney-t për të shqyrtuar pyetjen: *Përse duhet të ndryshoj praktikën e mësimdhënies?* (Për më shumë mbi Metodën e Walt Disney-t, shih Mulder, P. (2012). *Walt Disney Method*. Marrë nga ToolsHero: <https://www.toolshero.com/creativity/walt-disney-method/>).

Ky ushtrim do të përfshijë tre raunde diskutimi, ku pjesëmarrësit do të kalojnë përmes tre perspektivave: *ëndërrimtar*, *realist* dhe *kritik*. Nëse ka hapësirë, trajneri/ja mund të caktojë tre zona të ndara në dhomë për çdo perspektivë.

Faza 1 – Ëndërrimtar:

Pjesëmarrësit do të shqyrtojnë pyetjen në mënyrë kreative, pa kufizime ose shqetësime për realizueshmërinë. Qëllimi është të krijohet një mori mundësish pa pengesa, duke imagjinuar mundësitë pa kufizime. Një ëndërrimtar sheh gjithçka si të mundshme dhe pa kufizime.

Faza 2 – Realist:

Pjesëmarrësit kalojnë në një pikëpamje më praktike, duke vlerësuar se si mund të realizohen këto ide në mënyrë realiste. Ata shqyrtojnë burimet e disponueshme, kohën dhe aspekte të tjera praktike. Për realistin, qëllimi është të shihen rrugët për të bërë ëndrrat realitet dhe të kuptohet si kufizimet mund të shndërrohen në sfida.

Faza 3 – Kritik:

Në fund, pjesëmarrësit do të adoptojnë perspektivën e një kritiku, duke menduar se si mund të pritët plani nga të tjerët, duke identifikuar problemet e mundshme dhe duke sugjeruar përmirësime. Kritiku nuk e kundërshton idenë e ëndërrimtarit apo të realistit, por e shqyrton planin si një vëzhgues, duke evidentuar çdo rregullim të nevojshëm.

Pasi të mbyllen të tri fazat, grupi ndan perceptimet dhe të dhënat nga çdo perspektivë.

**Pyetje për reflektim:**

1. Çfarë bëtë?
2. Çfarë mësuat?
3. Si mund ta aplikoni këtë në punën tuaj të ardhshme dhe në zbatimin e qasjeve inovative?

**Materialet e nevojshme:**

Letër flipchart, markerë dhe përshkrime rolesh për pjesëmarrësit

## Shërbimi dhe Mësimi në Vullnetarizmin Edukativ

**Kohëzgjatja:** 45 minuta

### **Përshkrimi:**

Ky aktivitet i lejon pjesëmarrësve të eksplorojnë se si objektivat e lëndëve të tyre mund të përshtaten me nevojat reale të komunitetit, duke mundësuar një qasje të mësimi në Vullnetarizmin Edukativ. Grupi do të ndahet në dy grupe: një grup do të fokusohet në objektivat e lëndëve, ndërsa tjetri do të mendojë për nevojat e komunitetit. Më pas, ata do të formojnë grupe të vogla për të gjetur lidhjet mes këtyre dy fushave.

### **Procesi Hap Pas Hapi për Trajnerin:**

#### **1. Ndaje në Dy Grupe:**

**Grupi 1:** "Çdo pjesëmarrës do të listojë objektivat kryesore të lëndës/ve të tij/saj – mendoni për atë që po mësoni dhe kompetencat që dëshironi që fëmijët/të rinjtë të zhvillojnë. Shkruani çdo objektiv në një copë letre të veçantë."

**Grupi 2:** "Mendoni për nevojat e mundshme që mund të ketë komuniteti jashtë universitetit. Merrni parasysh grupe të ndryshme të synuara në zonën tuaj (p.sh., të moshuarit, të rinjtë, dhe individët pa punë) dhe nevojat e mundshme që ata mund të kenë. Shkruani çdo nevojë të komunitetit në një copë letre të veçantë."

#### **2. Formimi i Çifteve:**

"Pasi të përfundojnë të dy grupet me listat e tyre, do të formoni çifte, me një person nga Grupi 1 dhe një person nga Grupi 2 në çdo çift. Se bashku, zgjidhni një objektiv dhe një nevojë të komunitetit dhe mendoni si mund të lidhen për të adresuar të dyja objektivat në të njëjtën kohë. Si mund të ndihmojë një projekt i Vullnetarizmit Edukativ për të plotësuar këtë nevojë dhe për të arritur objektivat e kursit?"

#### **3. Raporti për Grupin:**

"Çdo çift do të ndajë kombinimin e objektivit dhe nevojës që kanë zgjedhur me grupin e të gjithë pjesëmarrësve. Ndërsa ndani, vendosni copat e letrës në një tabelë ose mur, që të mund ta shohim vizualisht lidhjen mes tyre."

#### **4. Pyetje Reflektimi:**

"Le të reflektojmë mbi atë që mësuam. A mendoni se kombinimi i objektivave të lëndëve me nevojat e komunitetit është i dobishëm? E keni marrë parasysh këtë qasje më parë? A mendoni se mund të funksionojë në klasat tuaja? Çfarë njohurish të reja keni fituar?"

#### **5. Shpjegimi i Vullnetarizmit Edukativ:**

"Për të përmbyllur, do të diskutojmë komponentët kryesorë të Vullnetarizmit Edukativ dhe do të prezantoj disa modele të Vullnetarizmit Edukativ në veprim. Për një kuptim më të qartë, do të shohim disa video të shkurtra që ilustrojnë komponentët kryesorë."

### **Materialet e Nevojshme:**

- Letra dhe marker

- Prezantimi me slajde për komponentët kryesorë të Vullnetarizmit Edukativ

- Fletushkë: Komponentët Kryesorë të Vullnetarizmit Edukativ dhe Definicione
- Video për komponentët kryesorë të Vullnetarizmit Edukativ

## **Eksplorimi i Aktiveteve të Orientuara nga Komuniteti**

**Kohëzgjatja:** 45 minuta

### **Përshkrimi:**

Ky aktivitet prezanton pjesëmarrësit me modelin konceptual të katërkatëshit të CLAYSS për aktivitetet orientuar nga komuniteti për fëmijë/rini përmes një kombinimi të punës në grupe dhe leksionit.

Pjesëmarrësit punojnë në grupe për të ofruar shembuj të aktiviteve të drejtuara nga fëmijët/të rinjtë në komunitet dhe analizojnë se si ato përshtaten në modelin e kuadrantit

### **Procesi Hap Pas Hapi për Trajnerin:**

1. Mësimi përmes Zbulimit – Pjesa 1 (15 minuta):
  - "Formoni grupe prej 2-3 pjesëmarrësish. Së bashku, mendoni për shembuj aktivitetesh orientuar nga komuniteti, në të cilat janë përfshirë fëmijët/të rinjtë, dhe shkruani çdo shembull në një copë letre të veçantë."
  - "Pasi të keni listuar disa shembuj, vendosni secilin shembull në seksionin përkatës të kuadrantit CLAYSS, bazuar në atë se ku mendoni se përkon."
2. Leksion Bazë – Prezantimi i Modelit të Kuadrantit Konceptual (15 minuta):
  - "Tani le të shohim modelin e kuadrantit CLAYSS. Unë do të shpjegoj akset e modelit dhe çfarë përfaqëson çdo kuadrant. Do të shqyrtojmë gjithashtu shembujt që keni dhënë dhe do t'i analizojmë së bashku, duke shpjeguar pse secili përkon në seksionin e tij."
3. Mësimi përmes Zbulimit – Pjesa 2 (15 minuta):
  - "Në grupet tuaja, diskutoni mundësitë e kalimit nga një seksion i kuadrantit në një tjetër. Merrni parasysh se si mund të evoluojë ose adaptohet një projekt për të kaluar nga një kuadrant në tjetrin, në varësi të ndryshimeve të objektivave, metodave, ose nevojave të komunitetit."
4. Pyetje Reflektimi:
  - "Çfarë vëzhguat për llojet e aktiviteve që po bëjnë fëmijët/të rinjtë? A kishte ndonjë shembull që ishte sfidues për ta vendosur në kuadrant?"
  - "Çfarë njohurish keni fituar mbi mënyrën se si mund të kalojnë projektet mes kuadranteve? Si mund t'ju ndihmojë ky model në dizajnimin ose rregullimin e projekteve të bazuara në komunitet?"

### **Materialet e Nevojshme:**

- Tabelë dhe marker
- Letra për të shkruar shembuj
- Fletushkë: Modeli Konceptual i Katërkatëshit të Vullnetarizmit Edukativ

**Fletushkë: Modeli Konceptual i Kuadrantit të Vullnetarizmit Edukativ (VE)**

Kuadranti	Shembuj të aktiviteteve
I	<p><b>Puna në Terren</b> Në këtë kategori, mësimi zakonisht zhvillohet jashtë institucioneve, por përmirësimi i mjedisit apo shoqërisë nuk është domosdoshmërisht i pranishëm. Mund të ketë shumë mësim, por pak ose asnjë shërbim që adreson nevojat specifike të komunitetit. (Tapia, 2006)</p>
II	<p><b>Punë vullnetare e pastrukturuar</b> Në kohë emergjencash (p.sh., cunami, tërmet), shpesh është e nevojshme të organizohen urgjentisht veprime për të përgjigjur ndaj nevojave të situatës krizë. Këto aktivitete spontane ose rastësore kanë pak ose asnjë planifikim dhe u mungon qëllimi edukativ (dimensioni i të mësuarit të integruar është i dobët).</p> <p><b>Fushata spontane për mbledhje fondesh të nisura nga organizata fëmijësh/rinore,</b> për shembull, për të mbështetur një familje ku një fëmijë humbi jetën në një aksident automobilistik kur ajo ishte pjesëmarrëse në Programin "Work &amp; Travel" në SHBA.</p>
III	<p><b>Punë vullnetare e strukturuar</b> Në disa raste, fëmijët/të rinjtë realizojnë shërbim komunitar të organizuar sistematikisht nga institucioni. Për shembull, për aktivitete si "Habitat for Humanity", nuk janë të nevojshme aftësi profesionale për të pikturuar mure. Aktivitetet e tilla nuk kanë një lidhje të qëllimshme me kurrikulën akademike ose profilin e ardhshëm profesional, edhe pse gjatësia dhe kuadri institucional sigurojnë mundësi për zhvillim të gjerë personal.</p> <p><b>Pastrimi i Kampusit të Fëmijëve/të rinjve</b> – një aktivitet bazuar në vullnetarizëm që organizohet një herë ose dy herë në semestrin e vitit akademik nga Këshilli i Fëmijëve/të rinjve të Universitetit Babes-Bolyai, Rumani. Ky është një aktivitet jashtë ambienteve të mësimt, pa lidhje të drejtpërdrejta me kurrikulën akademike dhe mund të merrnin pjesë të gjithë fëmijët/të rinjtë në varësi të kohës dhe disponueshmërisë. Disa foto të fëmijëve/të rinjve duke mbledhur mbeturina në kampus janë postuar në faqen e mediave sociale të Këshillit, me komente mbi angazhimin shoqëror.</p>
IV	<p><b>Vullnetarizmi Edukativ (S-L)</b> Aktivitetet e Vullnetarizmit Edukativ realizohen nga fëmijët/të rinjtë në Shkollën e Shkencave të Sakta në Universitetin Kombëtar të Salta (Argjentinë), dhe ndodhin kur puna në terren është planifikuar akademikisht dhe përmbush nevoja specifike shoqërore përmes vullnetarizmit të thellë. Pra, fëmijët/të rinjtë angazhohen në instalimin e pajisjeve për energjinë diellore për komunitetet rurale të izoluara në Ande, si pjesë e orëve të praktikës që kërkohen për kursin.</p>

## **Parimet e Zbatimit të Edukimit të Fëmijëve dhe të rinjve për Vullnetarizëm (Parimet e Vullnetarizmit Edukativ)**

**Kohëzgjatja:** 50 minuta

**Përshkrimi:** Ky aktivitet do të prezantojë pjesëmarrësit me parimet kryesore që janë të nevojshme për hyrjen e edukimit të fëmijëve dhe të rinjve për vullnetarizëm. Është thelbësore që këto parime të respektohen kur futet vullnetarizmi në mësimdhënie. Gjatë aktivitetit, pjesëmarrësit mund të punojnë vetë ose në grupe (nëse kemi më shumë pjesëmarrës nga e njëjta shkollë, është mirë t'i lejojmë ata të punojnë së bashku).

### **Udhëzime për Trajnerin:**

1. Trajneri do t'i paraqesë pjesëmarrësve 17 parime. Ai do t'u japë një përshkrim të shkurtër për secilën prej parimeve.
2. Trajneri do ta ndajë dhomën e trajnimit në 17 seksione, me secilën seksion që përfaqëson një parim.
3. Teksti i parimit do të printohet në një mënyrë që ka mjaft hapësirë për të shkruar poshtë tij ose do të përgatitet një copë letër e pastër për shkrim, e cila do të vendoset për secilin parim. Trajneri mund të lërë gjithashtu një përshkrim të shkurtër për secilin parim.
4. Pjesëmarrësi (në varësi të numrit të pjesëmarrësve dhe në grupe) merr një marker dhe për 2 minuta shkon tek një parim dhe shkruan në letrën nën parimin përkatës shembujt e tij se si mund të zbatohet parimi në praktikë. Është e rëndësishme që të gjithë të kalojnë në të gjitha parimet brenda 35 minutash.
5. Hapi i fundit është një reflektim 15 minutësh. Gjatë reflektimit, pjesëmarrësit do të reflektojnë së bashku për atë që arritën të shkruanin nën secilin parim, nëse ishte e lehtë për ta, dhe nëse mundën ta imagjinonin menjëherë zbatimin e parimeve të dhëna në praktikë, çfarë i bëri ata të kenë probleme, ose cili parim e perceptojnë si më të vështirë për t'u zbatuar në praktikë. Lejoni pjesëmarrësit të ndajnë mendimet dhe reflektimet e tyre me grupin.

### **Pyetje Reflektimi:**

- "Cilin parim e gjetët më të rëndësishëm për praktikën tuaj aktuale? Pse?"
- "Si mund t'i merrni shembujt që shkruat dhe t'i zbatoni në punën tuaj?"
- "A kishte ndonjë parim që ndjeni se mund të jetë i vështirë për t'u zbatuar? Si mund ta kapërceni këtë sfidë?"

### **Materialet e Nevojshme:**

- Markera
- Letra për shkrim
- Fletushkë: Parimet e Zbatimit të Edukimit të Fëmijëve dhe të rinjve për Vullnetarizëm (Parimet e Vullnetarizmit Edukativ)

Fletushkë: Parimet e zbatimit të edukimit të fëmijëve dhe të rinjve për vullnetarizëm (Parimet e Vullnetarizmit Edukativ).



<b>Ndërlidhja (Cross-section)</b>	Edukimi dhe trajnimi i fëmijëve dhe të rinjve për vullnetarizëm mund të ndërthuret me fushat edukative si një temë ndërdisiplinore. Mund të zbatohet si pjesë e përmbajtjes edukative të lëndëve individuale ose si një lëndë e veçantë brenda mësimëve opsionale.
<b>Lidhja e qartë e eksperiencës së vullnetarizmit me qëllimet dhe përmbajtjen e edukimit</b>	Eksperienca e vullnetarizmit e fëmijëve dhe të rinjve duhet të lidhet në mënyrë të qartë me qëllimet dhe përmbajtjen e edukimit. Mësimdhënësi duhet të planifikojë se cilat njohuri dhe aftësi mund të zhvillohen nga fëmijët/të rinjtë përmes aktiviteteve të vullnetarizmit. Qëllimet duhet të lidhen jo vetëm me qëllimet e edukimit dhe aftësimin të fëmijëve dhe të rinjve për vullnetarizëm, por edhe me qëllimet e edukimit dhe trajnimit në çdo temë apo lëndë tjetër.
<b>Balanca e përfitimeve</b>	Çdo aktivitet vullnetarizmi ka përfitime për disa palë të përfshira. Kur edukohen fëmijët dhe të rinjtë për vullnetarizëm duhet reflektuar se përmes aktiviteteve të vullnetarizmit, ata ndikojnë në shoqëri, ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve dhe mbështesin ndërtimin e solidaritetit. Nga ana tjetër duhet të theksohen edhe përfitimet e realizimit të aktiviteteve për vetë të rinjtë.
<b>Modeli i një të rrituri (ose të rriturish)</b>	Të rriturit duhet të jenë rol model aktiv gjatë procesit të edukimit dhe trajnimit për vullnetarizëm. Ata duhet të zbatojnë aktivitete vullnetarizmi së bashku me fëmijët dhe të rinjtë. Nëse mësimdhënësi nuk është aktiv ai nuk mund të kërkojë një nivel të lartë aktiviteti nga fëmijët/të rinjtë.
<b>Atmosfera "Pro-Vullnetarizëm"</b>	Vullnetarizmi duhet të mbështetet dhe vlerësohet nga drejtuesit e shkollës dhe stafi mësimor dhe ndihmës.
<b>Mësimi përmes përvojës personale</b>	Roli kryesor në procesin e të mësuarit dhe krijimit të zakoneve pozitive luhet nga aktiviteti, domethënë përvoja e vetë, teoria është dytësore, veçanërisht në kontekstin e krijimit të një marrëdhënieje afatgjatë dhe të qëndrueshme me vullnetarizmin. Të mësuarit përmes përvojës personale luan një rol të pagabueshëm në procesin e edukimit dhe trajnimit për vullnetarizëm.
<b>Reflektimi mbi përvojën</b>	Reflektimi mund të imagjinohet si një proces i përpunimit të përvojës nga një aktivitet specifik dhe kthimi i saj në një përvojë të aplikueshme për të ardhmen. Ky reflektim është një kusht i nevojshëm që fëmijët dhe të rinjtë të zhvillojnë dhe formësojnë qëndrimet e tyre në mënyrë të drejtuar.

<b>Fleksibiliteti, larmishmëria dhe zgjedhja</b>	<p>Diversiteti dhe fleksibiliteti duhet të ruhen si llojet e aktiviteteve vullnetare, si dhe në "thellësinë" e angazhimit, nivelin e përgjegjësisë, kohëzgjatjen ose preferencën për formën individuale apo grupore të vullnetarizmit. Fëmijët dhe të rinjtë duhet të kenë mundësinë për të shprehur idetë e tyre.</p>
<b>Argëtimi</b>	<p>Vullnetarizmi duhet të sjellë gëzim, plotësim dhe kënaqësi për fëmijët dhe rininë e përfshirë. Ai ofron mundësi për zgjidhjen e një detyre interesante që ka rëndësi individuale dhe ndikim shoqëror.</p>
<b>Njohja</b>	<p>Nëse qëllimi i vullnetarizmit është ndihma afatgjate për të tjerët dhe për komunitetin, atëherë shpërblimi është kënaqësia dhe motivimi më i fortë për punën dhe angazhimin social në të ardhmen.</p>
<b>Përparësia e nevojës mbi idetë</b>	<p>Përpara se të filloni të planifikoni dhe zbatoni një aktivitet vullnetar nga ana e mësuesit, fëmijëve/të rinjve djem dhe vajza, është e nevojshme të vlerësohet në mënyrë kritike nëse aktiviteti i dhënë është aktualisht i përshtatshëm, i nevojshëm dhe i dobishëm nga pikëpamja e nevojave të shoqërisë, komunitetit apo rrethanave të tjera në të cilat ata duan të zbatojnë aktivitetin dhe nëse është zbatimi i tij si prioritet ndaj ideve të tjera apo aktiviteteve potencialisht të nevojshme.</p>
<b>Puna me komunitetin/njerëzit, Jo për komunitetin/njerëzit</b>	<p>Kur planifikohen dhe realizohen aktivitete vullnetarizmi, duhet ndërtuar një model horizontal ndihme, ku nuk i mësojmë vetëm fëmijët dhe rininë të ndihmojnë, por gjithashtu të respektojnë faktin se të dyja palët në procesin e ndihmës duhet të jenë agjentë aktiv të ndryshimit.</p>
<b>Lidershipi i fëmijëve dhe të rinjve</b>	<p>Fëmijët dhe të rinjtë duhet të përfshihen sa më shumë të jetë e mundur në planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e aktiviteteve vullnetare. Ata duhet të ndiejnë se kanë pronësinë e projektit/aktivitetit vullnetar dhe të jenë liderët e aktiviteteve, jo vetëm implementuesit e tyre.</p>
<b>Parimi i afatgjatësisë</b>	<p>Edukimi dhe trajnimi i fëmijëve dhe të rinjve për vullnetarizëm mund të realizohet përmes aktiviteteve të ndryshme, por duhet të sigurohet hapësira për kalimin nga aktivitete afatshkurtra në shërbime vullnetarizmi më afatgjate dhe më sistematike.</p>

<b>Kërkesat në rritje</b>	Pjesëmarrja në vullnetarizëm ofron mundësinë për rininë të rritet dhe të përparojë vazhdimisht. Kur zbatohet edukimi dhe trajnimi për vullnetarizëm, krijohet hapësirë për rritjen graduale të kërkesave në implementimin e aktiviteteve vullnetare me qëllimin e zhvillimit të një spektri më të gjerë njohurish.
<b>Inkurajimi përmes Shembujve të praktikës së mirë</b>	Për funksionimin e mirë dhe mbështetjen e vullnetarizmit në sistemin e arsimit formal dhe informal, ekzistenca e një ambienti që do të mundësojë ndarjen e një game të gjerë shembujsh të suksesshëm të projekteve dhe aktiviteteve vullnetare është thelbësore.
<b>Motivimi i drejtuar</b>	Fëmijët dhe të rinjtë mund të humbin motivimin, kështu që është e këshillueshme t'i inkurajoni ata rregullisht, të keni më shumë kontakt me ta, si dhe t'u ofroni njohje joformale dhe formale për përfitimet e aktiviteteve të tyre vullnetare, konfirmime, certifikata ose rekomandime për punësim.

## Vullnetarizmi Edukativ nga A në Z – Koncepti dhe Modeli

**Kohëzgjatja:** 25 minuta

**Përshkrimi:** Ky sesion ka për qëllim të njohë pjesëmarrësit me modelin e Vullnetarizmit Edukativ (Vullnetarizmi Edukativ - VE), duke theksuar komponentët kyç dhe përfitimet e tij për fëmijët/të rinjtë. Përmes një prezantimi të shkurtër dhe një filmi, pjesëmarrësit do të marrin një kuptim të qartë për strukturën, qëllimin dhe ndikimin edukativ të VE.

### Procesi Hap pas Hapi:

1. Prezantimi i VE (5 minuta)
  - Filloni me një pasqyrë të shkurtër mbi VE si një metodë edukative që kombinon shërbimin e dobishëm për komunitetin me përvoja mësimore reflektuese.
  - Theksoni komponentët kryesorë:
    - Aktiviteti i Shërbimit (aktivitetet vullnetare) – projekti ose aktiviteti praktik.
    - Procesi i Mësimit – integrimi i mësimëve nga klasa me aplikime reale në botën e jashtme.
    - Reflektimi – procesi kritik i kuptimit të përvojave dhe aplikimit të mësimëve të nxjerra.
    - Lidershipi i të rinjve – inkurajimi i fëmijëve/të rinjve për të marrë iniciativën dhe përgjegjësinë.
  - Theksoni rolin e rëndësishëm të mësimdhënësit ose mentorit në udhëheqjen dhe mbështetjen e fëmijëve/të rinjve gjatë çdo faze.

## 2. Prezantimi me Diagram (10 minuta)

- Përdorni një prezantim të përgatitur për t'i udhëhequr pjesëmarrësit përmes modelit të VE duke shpjeguar secilin komponent në detaje.
- Shpjegoni se si VE është ndryshe nga punët tradicionale vullnetare duke u fokusuar në rezultatet e strukturuar të të mësuarit dhe procesin reflektues.
- Përsëritni se prezantimi është fleksibël varësisht nga koha, nuk është e nevojshme të shfaqen të gjitha faqet/slidet duke mundësuar një përmbledhje të përqendruar.

## 3. Shfaqja e Filmit dhe Komentimi (5-10 minuta)

- Zgjidhni një film të shkurtër që i përshtatet më së miri nevojave të audiencës:

- Opsioni 1: "Project Water – Stay Healthy"  
([https://www.youtube.com/watch?v=m3SVINC\\_Uwc&feature=youtu.be](https://www.youtube.com/watch?v=m3SVINC_Uwc&feature=youtu.be)) (10 minuta) – Tregon të gjithë procesin e VE.
- Opsioni 2: "VE në Sllovaki"  
(<https://www.youtube.com/watch?v=mSl0fmiGC1o&feature=youtu.be>) (5:08 minuta) – Thekson tre shembuj të projekteve VE.
- Opsioni 3: "VE: Aplikime të Vërteta për të Mësuar"  
(<https://www.youtube.com/watch?v=7t30ZMX8uGw>) (5:30 minuta) – Tregon VE në një shkollë amerikane, megjithatë nuk përfshin "identifikimin e nevojave lokale" dhe "leadershipin e të rinjve."

- Pas shfaqjes së filmit, ofroni një komentim të shkurtër për të theksuar komponentët kryesorë të VE që janë parë në video.

## 4. Diskutim dhe Pyetje & Përgjigje (5 minuta)

- Inkurajoni pjesëmarrësit me pyetjen: "Si është VE?"
- Përgjigjet e zakonshme mund të përfshijnë: është si vullnetarizmi, aktivitet edukativ ose një praktikë.
- Përdorni përgjigjet e tyre si një mundësi për të sqaruar se si VE kombinon në mënyrë unike shërbimin dhe mësimin e strukturuar duke i përgatitur ata për aktivitetin tjetër.

Video shtesë për shpjegim:

- Fazat e Vullnetarizmit Edukativ (<https://www.youtube.com/watch?v=kFd-yiAfrmE>)
- Vullnetarizmi Edukativ – Definicioni (<https://www.youtube.com/watch?v=L9AXsV3eull>)
- Ndikimi në Komunitete, Transformimi i Fëmijëve/të rinjve  
([https://www.youtube.com/watch?v=TzLlaypl5\\_I](https://www.youtube.com/watch?v=TzLlaypl5_I))

### **Materialet e Nevojshme:**

- Kompjuter dhe projektor
- Diapozitivat e prezantimit për VE
- Filmi i zgjedhur dhe akses në video

Në fund të prezantimit, pjesëmarrësit duhet të kenë një kuptim themelor të VE, komponentëve të saj dhe vlerës edukative që ajo sjell për fëmijët/të rinjtë.

## Dallimi në mes të Koncepteve

**Kohëzgjatja:** 20 minuta

### **Përshkrimi i Aktivitetit:**

Pjesëmarrësit ndahen në tre grupe, secilit grup i caktohet të analizojë një nga këto koncepte: Praktika, Vullnetarizmi ose Aktivitetet Edukative. Gjatë 10 minutave të para, secili grup diskuton konceptin që i është caktuar dhe bën një listë me karakteristikat kryesore të tij në një flipchart të përbashkët (i ndarë në tre seksione, një për çdo koncept). Ata përqendrohen në definimin e konceptit dhe kuptimin e dallimeve të tij nga konceptet e tjera, bazuar në njohuritë dhe përvojat e tyre të mëparshme.

Pasi të kalojnë 10 minuta, të gjitha grupet mblidhen në një seancë plenare për të krahasuar gjetjet e tyre. Udhëheqësi i aktivitetit udhëheq një diskutim duke ndihmuar që të identifikohen ngjashmëritë dhe dallimet kryesore midis koncepteve, duke sqaruar çdo keqkuptim dhe duke dhënë shembuj nëse është e nevojshme. Në pjesën përfundimtare, udhëheqësi i aktivitetit prezanton "Vullnetarizmin Edukativ" si një koncept të katërt, duke iu referuar informacionit teorik të diskutuar më parë. Pjesëmarrësit kërkohet të mendojnë për mënyrën se si Vullnetarizmi Edukativ krahasohet me tre konceptet e tjera dhe të njohin veçoritë e tij të veçanta.

### **Udhëzime për trajnerin:**

1. Pjesëmarrësit ndahen në tre grupe dhe çdo grup i caktohet një koncept: Praktika, Vullnetarizmi, ose Aktivitetet Edukativ.
2. Secili grup i jepet një flipchart ose një seksion në një flipchart të përbashkët për të shkruar karakteristikat kryesore të konceptit të tyre.
3. Jepni grupeve 10 minuta për diskutim dhe për krijimin e listës.
4. Mblidhni të gjithë grupin dhe kërkojini secilit grup të paraqesë gjetjet e tyre.
5. Udhëheqësi i aktivitetit udhëheq diskutimin plenar, duke theksuar njohuritë kryesore dhe duke sqaruar çdo konfuzion.
6. Prezantoni "Vullnetarizmin Edukativ" si koncept të katërt dhe inkurajoni pjesëmarrësit të bëjnë krahasimin me konceptet e tjera, duke identifikuar aspektet e tij unike.

### **Materialet e Nevojshme:**

- Flipchart
- Markera
- Opsionale: letra me ngjyra, ndihmë vizuale ose video për të përforcuar mbajtjen mend

## Hapat në një Projekt Vullnetarizmi Edukativ në Komunitet

**Kohëzgjatja:** 20 minuta

### **Përshkrimi:**

Ky aktivitet ka për qëllim të njohë pjesëmarrësit me fazat kryesore të një projekti të Vullnetarizmit Edukativ (VE) në komunitet. Ai është dizajnuar për t'i ndihmuar pjesëmarrësit të kuptojnë procesin e planifikimit, implementimit dhe vlerësimit të një projekti. Hapat që do të diskutohen do të ofrojnë

qartësi mbi mënyrën e strukturimit të një projekti të Vullnetarizmit Edukativ duke përdorur shembuj praktikë.

Prezantimi do të përfshijë këta hapa:

1. Identifikimi i Problemit
2. Qartësimi i qëllimit
3. Planifikimi
4. Zbatimi
5. Vlerësimi
6. Festimi

#### **Udhëzime:**

1. Filloni duke rishikuar aktivitetin e mëparshëm dhe duke iu referuar flipchart-it ku pjesëmarrësit kishin identifikuar fazat e një projekti vullnetarizmi në komunitet.
2. Kërkojini grupit "Cilat hapa të projektit kemi identifikuar?" dhe referojuni flipchart-it për përgjigje. Përmbledhni fazat që ata përmendën.
3. Pastaj, prezantoni gjashtë hapat në një projekt të Vullnetarizmit Edukativ. Shkruajini ato në flipchart dhe shpjegoni secilën fazë.
4. Për secilin hap, jepni një përshkrim të shkurtër dhe jepni shembuj nga një projekt i mëparshëm (p.sh., shembulli i ndërtimit të shtëpisë për xhuxhët). Sqaroni se si funksionon çdo hap në praktikë:
  - Identifikimi i Problemit: Definoni problemin që projekti synon të zgjidhë. Ky hap mbështetet në analizën e komunitetit dhe në inputet e anëtarëve të tij.
  - Qartësimi i qëllimit: Vendosni qëllimin ose zgjidhjen specifike që grupi do të ndjekë për të adresuar problemin e identifikuar.
  - Planifikimi: Zhvilloni hapa dhe aktivitete konkrete për të arritur qëllimin e projektit, duke përfshirë detaje si materialet, afatet dhe përgjegjësitë.
  - Zbatimi: Vini në praktikë planin duke realizuar aktivitetet e planifikuara.
  - Vlerësimi: Reflektoni mbi rezultatet e projektit dhe vlerësoni nëse qëllimi është arritur.
  - Festimi: Festoni suksesin e projektit dhe punën e grupit në komunitet.
5. Jepni kohë për pyetje dhe diskutim. Sigurohuni që të sqaroni çdo dyshim dhe inkurajoni pjesëmarrësit të ndajnë mendimet e tyre.

#### **Materialet e Nevojshme:**

- Flipchart-i nga aktiviteti i mëparshëm
- Markera
- Fletushka me informacion mbi hapat në një projekt vullnetarizmi edukativ
- Kompjuter dhe projektor për çdo diapozitiv ose materiale shtesë

Përgatitja për Implementimin e Vullnetarizmit Edukativ (S-L)

**Kohëzgjatja:** 60 minuta

Përshkrimi: Ky aktivitet interaktiv udhëzon pjesëmarrësit përmes një sërë ushtrimesh reflektive dhe bashkëpunuese për të sqaruar qëndrimet, sfidat dhe strategjitë që lidhen me implementimin e Vullnetarizmit Edukativ (S-L) në ambientet e tyre edukative. Ky aktivitet ndihmon pjesëmarrësit të definojnë pikëpamjet e tyre dhe qasjet e mundshme për të inkurajuar S-L brenda shkollave ose organizatave të tyre. Aktiviteti është i dizajnuar për 15 mësimdhënës ose punonjës rinorë që punojnë si individë dhe në grupe të vogla.

### Pjesa 1: Reflektimi Individual mbi Qëndrimet ndaj Vullnetarizmit Edukativ (10 minuta)

Udhëzime:

1. Filloni me një reflektim individual. Çdo pjesëmarrës merr një fletë dhe për 5 minuta, mendon për qëndrimin e tij ndaj Vullnetarizmit dhe Vullnetarizmit Edukativ duke i'u përgjigjur pyetjes:

- “Cili është qëndrimi im ndaj vullnetarizmit dhe Vullnetarizmit Edukativ?”

2. Pasi të ketë përfunduar reflektimi individual, kërkoni që pjesëmarrësit të formojnë çifte dhe të diskutojnë shkurtimisht mendimet e tyre për Vullnetarizmin Edukativ me partnerin për 5 minuta.

Pyetje për diskutim për pjesën 1:

- “Cilat janë arsyet kryesore që mbështesin ose kanë rezerva ndaj Vullnetarizmit Edukativ?”

- “Si ndikon pikëpamja juaj personale në gatishmërinë tuaj për t'u angazhuar me Vullnetarizmin Edukativ në shkollën tuaj?”

### Pjesa 2: Analizimi i Mbështetjes në Mjedisin Shkollor (20 minuta)

Udhëzime:

1. Pjesëmarrësit formojnë grupe nga 3 dhe u jepen letra të mëdha flipchart-i.

2. Çdo grup diskuton dhe përgjigjet në këto pyetje, duke shkruar përgjigjet në letrat e tyre:

- “Cili është qëndrimi i administratës shkollore ndaj Vullnetarizmit Edukativ dhe vullnetarizmit të fëmijëve/rinjve?”
- “Si ndihen mësimdhënësit, këshilltarët dhe stafi tjetër ndaj Vullnetarizmit Edukativ dhe vullnetarizmit të fëmijëve/rinjve?”
- “Si mund ta motivoni administratën shkollore, mësimdhënësit dhe stafin për të mbështetur Vullnetarizmin Edukativ?”

3. Grupi prezanton përfundimet e tij përpara të gjithëve (2-3 minuta për grup).

Pyetje për Diskutim për pjesën 2:

- “Cilat ishin sfidat më të zakonshme që u identifikuan në motivimin e kolegëve dhe administratës?”

- “Cilat strategji për të marrë mbështetje duken më efektive?”

### Pjesa 3: Identifikimi i Faktorëve të Përvojës dhe Motivimit (15 minuta)

Udhëzime:

1. Çdo grup merr tre pyetje për të diskutuar me rotacion:

- “Çfarë përvoje ka shkolla/organizata dhe fëmijët/rinjtë e saj me vullnetarizmin?”
- “Si mund ta motivoni fëmijët/rinjtë të angazhohen në aktivitete vullnetarizmi dhe Vullnetarizëm Edukativ?”
- “Çfarë reagimesh kanë prindërit ndaj vullnetarizmit të fëmijëve/rinjve?”

2. Grupi i ndërron pyetjet çdo 5 minuta duke diskutuar secilën pyetje dhe duke shkruar pikat kyçe në post-it. Më pas, ata i ngjitin ato në mur për t’u parë nga të gjithë.

Pyetje për Diskutim për pjesën 3:

- “Cilat janë faktorët që mund të motivojnë fëmijët/rinjtë të angazhohen në vullnetarizëm?”
- “Si mund t’i adresojmë shqetësimet e prindërve në lidhje me Vullnetarizmin Edukativ?”

**Pjesa 4: Eksplorimi i Nevojave dhe Mundësive (15 minuta)**

Udhëzime:

1. Pjesëmarrësit mbledhen në grupe nga 4. Çdo grup diskuton dhe liston përgjigjet për këto dy pyetje në flipchart:

- “Cilat janë nevojat e shkollës/organizatës tuaj dhe cilat mund të plotësohen përmes Vullnetarizmit Edukativ?”
- “Cilat janë nevojat e fëmijëve/rinjve tuaj që strategjia e Vullnetarizmit Edukativ mund ose duhet të adresojë?”

2. Grupi më pas ndan listat me të gjithë pjesëmarrësit në një format "galeri shëtitjeje", duke lejuar kohë për komente dhe sugjerime nga grupet e tjera.

Pyetje për Diskutim për pjesën 4:

1. “Si mund të ndihmojë Vullnetarizmi Edukativ për të plotësuar nevojat e shkollës dhe fëmijëve/rinjve?”
2. “Çfarë burimesh ose mbështetjeje shtesë do të nevojiten për të adresuar këto nevoja?”

**Materialet e Nevojshme:**

- Flipchart
- Markera
- Post-it
- Fletë dhe stilolapsa

## **Strategjia e Marketingut për Palët e Interesuara**

**Kohëzgjatja:** 20 minuta

**Përshkrimi:**

Njohja e përfitimeve që sjell angazhimi në Vullnetarizëm Edukativ dhe mundësia për t’ia prezantuar ato të tjerëve është një nga detyrat që mësimitdhënësit ose punonjësit rinorë do të duhet të përballen menjëherë pas përfundimit të trajnimit. Ky aktivitet do t’i ndihmojë pjesëmarrësit të kuptojnë përfitimet



që sjell Vullnetarizmi Edukativ për grupe të ndryshme targeti. Pjesëmarrësit do të krijojnë një “strategji marketingu” për të gjithë ata të përfshirë, në mënyrë që të mund ta "shesin" më mirë idenë – pse të fillosh me Vullnetarizëm Edukativ.

#### **Procesi hap-pas-hapi për trajnerin:**

1. Trajneri + përgatit një flipchart, ku shkruan pyetjen në krye: "Cilat do të jenë përfitimet e angazhimit në Vullnetarizëm Edukativ për...?"
  - nxënësit/fëmijët/rinjtë
  - komunitetin
  - shkollën
  - mësimdhënësit
2. Trajneri u shpërndan pjesëmarrësve ngjitëse post-it (është mirë që të jepen 8-10 ngjitëse për çdo pjesëmarrës). Çdo pjesëmarrës shkruan një përfitim të vetëm të angazhimit në Vullnetarizëm Edukativ për secilin grup targeti (nxënësit/komuniteti/shkolla/mësimdhënësit). Ky aktivitet zgjat rreth 10-12 minuta.
3. Trajneri fton pjesëmarrësit të ngjisin post-it me përfitimet në secilin grup targeti. Pjesëmarrësit vijnë një nga një dhe kanë mundësinë të tregojnë përfitimet që ata perceptojnë.  
**Note:** Lejohet që disa përfitime të përsëriten, ato ngjiten bashkë.
4. Trajneri përmbledh përfitimet kryesore në flipchart dhe mbyll aktivitetin, duke krijuar një “strategji marketingu” që do t’u ndihmojë pjesëmarrësve të komunikojnë përfitimet e Vullnetarizmit Edukativ pas përfundimit të trajnimit.

#### **Materialet e Nevojshme:**

- Flipchart
- Markera ose stilolapsa
- Post-it

### **Tejkalimi i Barrierave në Implementimin e Vullnetarizmit Edukativ (S-L)**

**Kohëzgjatja:** 45 minuta

#### **Përshkrimi:**

Ky ushtrim ndihmon pjesëmarrësit të identifikojnë dhe të punojnë për të kapërcyer barrierat që hasin kur përpiqen të implementojnë Vullnetarizmin Edukativ (S-L) në institucionet e tyre. Pjesëmarrësit do të reflektojnë individualisht, kategorizojnë pengesat e zakonshme dhe pastaj do të bashkëpunojnë për të gjetur zgjidhje praktike për t’i kapërcyer ato.

#### **Procesi hap-pas-hapi për trajnerin:**

1. Puna Individuale (10 minuta):

- "Merrni disa minuta për të reflektuar mbi përvojën tuaj dhe sfidat që keni hasur. Do të doja që secili prej jush të përgjigjet në këtë pyetje: 'Çfarë kam frikë?' Mendoni për barrierat ose çështjet

brenda institucionit tuaj që mund të bëjnë të vështirë implementimin e Vullnetarizmit Edukativ. Shkruani çdo pengesë ose shqetësim që identifikoni."

## 2. Puna në Grupe – Kategorizimi i Barrierave (10 minuta):

- Tani, formoni grupe të vogla dhe organizoni barrierat që keni shkruar në kategori. Kategoritë mund të përfshijnë:
  - Fëmijët/të rinjtë
  - Institucionet e Arsimit të Lartë
  - Komuniteti
  - Mësimdhënësit

Diskutoni së bashku se si secila kategori mund të ndikojë në implementimin e Vullnetarizmit Edukativ."

## 3. Puna në Grupe – Gjetja e Zgjidhjeve (25 minuta):

- "Tani, rikthehuni tek lista e barrierave që keni krijuar. Si grup, mendoni për zgjidhje të mundshme për t'i kapërcyer këto pengesa. Mendoni për hapat që duhet të ndërmerreni, kë duhet të afroni në institucionin tuaj, si mund të angazhoni kolegët dhe cilat burime (kohë, njerëz, financa, materiale) do të nevojiten për të implementuar S-L. Gjithashtu, mendoni se kush në institucionin tuaj mund t'ju ndihmojë në zbatimin e këtyre zgjidhjeve."
- Pas zhvillimit të zgjidhjeve, secili grup do të ndajë përmbledhjen e barrierave dhe zgjidhjeve me grupin më të madh. Jo të gjithë duhet të paraqesin, por të paktën 3-4 grupe duhet të ndajnë listat e tyre të barrierave dhe zgjidhjeve."

## 4. Pyetje për Diskutim dhe Reflektim:

- "Cilat ishin barrierat më të zakonshme që identifikuat?"
- "Cilat zgjidhje mendoni se janë më praktike për t'u zbatuar në institucionin tuaj?"
- "Si mund të filloni t'i aplikoni këto zgjidhje dhe kë duhet të afroni për të filluar këtë proces?"

### Materialet e Nevojshme:

- Flipchart dhe markera për të shënuar përgjigjet dhe zgjidhjet.
- Post-it për të shkruajtur pengesat dhe për t'i kategorizuar ato.

## Objektivat e të Mësuarit ose të Shërbimit?

**Kohëzgjatja:** 40 minuta

### Përshkrimi:

Ky aktivitet ndihmon drejtpërdrejt pjesëmarrësit të kuptojnë rëndësinë e objektivave të qarta të të mësuarit dhe të shërbimit në projektet e Vullnetarizmit Edukativ. Pjesëmarrësit do të mësojnë të dallojnë mes objektivave edukative dhe atyre të shërbimit dhe do të mësojnë të perceptojnë lidhjen e tyre me projektin dhe aktivitetet kryesore të tij. Aktiviteti lidh punën në grup të ekipit me punën e

pavarur, kur pjesëmarrësit mendojnë drejtpërdrejt mbi objektivat edukative dhe objektivat e shërbimit duke marrë parasysh kushtet që ata kanë në organizatën ose shkollën e tyre.

### Procesi hap pas hapi për trajnerin:

1. Në bazë të prezantimit të tij PowerPoint, trajneri thekson rëndësinë e vendosjes së qëllimeve edukative të qarta dhe shërbimeve të orientuara dhe thekson karakteristikat e mëposhtme:

	Objektivat e shërbimit/aktiviteteve vullnetare	Objektivat e të mësuarit
Ato fokusohen në	Çështjet/nevojat e komunitetit	Të nxënësve e nxënësve
Ato përbëhen nga	Ndryshimi i sjelljes së njerëzve, politikave, shërbimeve	Zhvillimi i njohurive, aftësive, vlerave, kompetencave
Kriteri	S - specifike M - e matshme A - e arritshme R - realiste T - kohë analizim	S M A R T analizim
Shembuj	Përmirësimi i disponueshmërisë së aktiviteteve të kohës së lirë për fëmijët në zonat rurale.	Mblidhni, përshkruani dhe propozoni aktivitete të reja për fëmijët në komunitetin lokal

2. Trajneri vendos në tryezë shembuj të përzier të 8 objektivave të mësimit dhe 12 objektivave të shërbimit dhe i kërkon grupit 5 minuta për t'i kategorizuar cilat janë objektiva të mësimit dhe cilat janë objektiva të shërbimit. Pasi të përfundojnë, ata i kontrollojnë ato së bashku. Trajneri së bashku me grupin do të plotësojë gojarisht 4 objektiva të shërbimit që kanë mbetur me objektiva të mundshme të të mësuarit.

3. Trajneri u jep çdo pjesëmarrësi një fletë bosh. Detyra e pjesëmarrësve do të jetë të përgjigjen individualisht në pyetjet e mëposhtme:

1. Caktoni 1 objektiv të mësuarit që dëshironi të punoni me fëmijët/të rinjtë.
2. Caktoni 1 objektiv të mësuarit dhe 1 objektiv shërbimi për objektivin e zgjedhur.
3. Shpjegoni si lidhen objektivat e të mësuarit dhe objektivat e shërbimit.
4. Shpjegoni cilin ndryshim dëshironi të arrini me projektin.

Trajneri u jep pjesëmarrësve 15 minuta për këtë ushtrim.

4. Ndërkohë që pjesëmarrësit punojnë në detyrën e tyre, trajneri përgatit një flipchart të ndarë në 4 kolona, ku do të shkruhen katër pyetje për t'u diskutuar (kolona a) deri te d)). Në fund të aktivitetit,

trajneri u jep mundësi pjesëmarrësve të ndajnë çfarë kanë shkruar dhe i shkruan ato në kolonat përkatëse në flipchart.

**Materialet e Nevojshme:**

- Flipchart
- Markers/Pens
- Fletë
- Fletushkë mbi objektivat e të mësuarit dhe të shërbimit

Objektivat e të mësuarit	Objektivat e Shërbimit
- Të aplikohet njohuria e njësisë tematike të mbrojtjes së natyrës në lëndën e biologjisë	- Të mbushet koha e lirë e personave të moshuar me takime dhe aktivitete me nxënës të cilët janë djem dhe vajza
- Nxënësi të mund të përshkruajë zonën e mbrojtur	- Të ndihmohet për të mposhtur ndjenjën e izolimit social të të moshuarve
- Të zgjerohen njohuritë për strehimet e specieve të mbrojtura të zogjve	- Të mbështetet përpjekja e të moshuarve për të ruajtur kontakte me njerëz të tjerë
- Të zhvillohen aftësi manuale në ndërtimin e terrenit të destinuar për shtegun e mbrojtur të zogut mbretëror të lumit	- Të mbështetet nevoja e të moshuarve për të biseduar, kujtuar, luajtur lojëra sociale dhe karta
- Të zhvillohen aftësi organizative, komunikimi dhe menaxhimi bashkëpunues i nxënësve gjatë zbatimit të projektit	- Të zhvillohen marrëdhënie pozitive midis të moshuarve dhe të rinjve
- Të mbështetet krijimtaria e nxënësve	- Të krijohet lidhja e ndërsjellë e brezave
- Nxënësi të mund të planifikojë aktivitete	- Të përmirësohet cilësia dhe niveli kulturor i hapësirave publike në fshat
- Nxënësi të mund të dokumentojë dixhitalisht aktivitetet që po zhvillohen	- Të përmirësohen kushtet për qëndrimin aktiv dhe relaksim të fëmijëve dhe të rinjve
	- Të sigurohet organizimi i stacioneve për fëmijët e kopshteve dhe shkollave fillore

	- Të rritet interesi i publikut për vendet më pak të vizituara në qytet
	- Të përmirësohet shëndeti përmes qëndrimit në një mjedis natyror
	- Të krijohen aktivitete dhe lojëra mjedisore dhe krijuese për shkollat dhe publikun

### **Përcaktimi i Objektivave të të mësuarit dhe të shërbimit**

**Kohëzgjatja:** 90 minuta

#### **Përshkrimi:**

Ky aktivitet fokusohet në ndihmën që i'u jep pjesëmarrësve për të kuptuar rëndësinë e vendosjes së objektivave të qarta të të mësuarit dhe të shërbimit brenda projekteve të vullnetarizmit edukativ. Ushtrimi përbëhet nga tre pjesë: së pari, pjesëmarrësit do të dallojnë midis objektivave të të mësuarit (LO) dhe objektivave të shërbimit (SO); së dyti, ata do të mësojnë rreth karakteristikave kryesore të të dyja llojeve të objektivave; dhe së treti, pjesëmarrësit do të punojnë në grupe për të listuar objektiva e të mësuarit për të rinjtë dhe për t'i lidhur ata me nevojat e komunitetit. Në fund të aktivitetit, pjesëmarrësit do të kuptojnë më mirë si të balancojnë objektivat e të mësuarit dhe ato të shërbimit dhe lidhjet midis tyre.

Udhëzime për Trajnerin:

#### **1. Hyrje (10 minuta):**

Filloni duke shpjeguar rëndësinë e vendosjes së objektivave të qarta të të mësuarit dhe të shërbimit në projekte të vullnetarizmit edukativ. Diskutoni ndryshimet në theksin që i jepet objektivave të mësuarit dhe atyre të shërbimit duke përdorur modelin e R. Sigomon (1994). Ky model përshkruan katër mundësi të lidhjes mes objektivave të shërbimit dhe të mësuarit:

s - I	Objektivat e shërbimit janë të shkëputura nga ato të të mësuarit dhe kanë pak relevancë për njëri-tjetrin.
S - I	Objektivat e shërbimit janë prioritet dhe objektivat e të mësuarit janë dytësore.
s - L	Objektivat e të mësuarit janë prioritet dhe objektivat e shërbimit janë dytësore.

S - L	Objektivat e shërbimit dhe të të mësuarit janë të lidhura fort me njëra-tjetrën dhe janë të barabarta në rëndësi dhe cilësi. Ata fuqizojnë njëri-tjetrin.
-------	---

## 2. Kategorizimi i Objektivave (25 minuta):

Jepni çdo pjesëmarrësi një fletushkë me një set të përzier të deklaratave objektivash (disa objektiva të të mësuarit, disa objektiva të shërbimit). Shembuj mund të jenë:

- **LO:** Dizajnoni dhe implementoni një kërkim vlerësimi.
- **SO:** Përmirësoni cilësinë e shërbimeve sociale për të moshuarit në zonat rurale.

Lejoni pjesëmarrësit disa minuta për t'i kategorizuar këto deklaratat si objektiva të mësimit dhe objektiva të të mësuarit. Më pas, kërkoni që secili të ndajë përgjigjet dhe diskutoni nëse deklarata është një objektiv e të mësuarit apo shërbimi.

## 3. Prezantimi i Trajnerit (20 minuta):

Zgjidhni një objektiv të mësuarit (LO) dhe një objektiv shërbimi (SO) nga ushtrimi i mëparshëm.

Prezantoni dallimet mes dyja duke theksuar:

- Fokusin kryesor të LO: Kompetencat (njohuri, aftësi, vlera).
- Fokusin kryesor të SO: Duhet të jenë specifike, të matshëm, të arritshëm.
- Lidhjen dhe ndërveprimin mes LO dhe SO: Si objektivat e të mësuarit dhe ato të shërbimit mund të mbështesin dhe fuqizojnë njëri-tjetrin.

## 4. Punë në Grupe (30 minuta):

Pjesëmarrësit ndahen në katër grupe duke përfshirë persona nga sektorët e arsimit formal dhe jo-formal. U jepni grupeve këto dy detyra:

- **Detyra 1:** Çdo grup duhet të listojë objektiva të mësuarit për të rinjtë nga perspektiva e arsimit formal dhe jo-formal.
- **Detyra 2:** Lidhni objektivat e të mësuarit me problemet, nevojat ose mundësitë e komunitetit që janë identifikuar në Ushtrimin 5.2 të Njësisë 5.

Pas përfundimit të punës në grupe, çdo grup do të prezantojë gjetjet e tij.

## 5. Përfundimi dhe Reflektimi (10 minuta):

Përfundojeni aktivitetin duke theksuar rëndësinë e balancimit të objektivave të të mësuarit dhe të shërbimit në projektet e vullnetarizmit edukativ. Jepni mundësi pjesëmarrësve të reflektojnë mbi mënyrën se si këto objektiva duhet të ndërthuren dhe lejoni ata të vendosin për balancën më të përshtatshme për projektet e ardhshme që do të realizojnë.

### **Materialet e Nevojshme:**

- Fletushkë me deklarata objektivash (objektiva të mësimit dhe të shërbimit) për çdo pjesëmarrës.

Shembuj:

Objektivat e të mësuarit (LO - Learning Objectives):

**LO 1:** Pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të hartojnë dhe zbatojnë një plan vlerësimi për të matur efektivitetin e një projekti shërbimi në komunitet.

**LO 2:** Pjesëmarrësit do të zhvillojnë aftësi në punën ekipore dhe bashkëpunim duke punuar në grupe të larmishme për të zgjidhur probleme të komunitetit.

**LO 3:** Pjesëmarrësit do të përmirësojnë aftësitë e tyre të të menduarit kritik duke analizuar nevojat dhe sfidat e komunitetit përmes mbledhjes së të dhënave dhe reflektimit.

**LO 4:** Pjesëmarrësit do të zhvillojnë aftësi komunikimi duke prezantuar rezultatet e projekteve përpara grupeve të interesit dhe anëtarëve të tjerë të grupit.

Objektivat e Shërbimit (SO - Service Objectives):

**SO 1:** Përmirësimi i aksesit në burime edukative për fëmijët në nevojë në zonat rurale përmes ngritjes së një shërbimi biblioteke mobile.

**SO 2:** Rritja e ndërgjegjësimit mjedisor në komunitet përmes organizimit të një sërë punëtorish mbi uljen e mbetjeve dhe riciklimin.

**SO 3:** Ofrimi i shërbimeve mbështetëse për shëndetin e popullsisë së moshuar në komunitet përmes ofrimit të kontrollit mjekësor falas dhe edukatës shëndetësore.

**SO 4:** Trajtimi i pasigurisë ushqimore në një lagje lokale përmes krijimit të një kopshti komunitar dhe një programi shpërndarjeje ushqimore.

#### **Materiale të nevojshme:**

- Fletë me letra të mëdha (flipchart paper)
- Markera

### **Vendosja e Qëllimeve në Vullnetarizmin Edukativ**

#### **Përshkrimi:**

Para këtij aktiviteti është e këshillueshme që të përfshihet një sesion për formulimin e qëllimeve në Vullnetarizmin Edukativ dhe në projekte - p.sh. duke përdorur metodën SMART. Aktiviteti shërben për të konsoliduar bazat teorike, për të provuar në praktikë formulimin e objektivave të shërbimit dhe të mësuarit dhe mbi të gjitha, për të ndërgjegjësuar se si mund të lidhet Vullnetarizmi Edukativ me lëndë të veçanta në kurrikulën e shkollës.

#### **Materiale:**

- Fletë për përshkrimin e problemeve/nejave (të përgatitura në përputhje me numrin e pjesëmarrësve duke siguruar që 2 fletë të përshkruajnë të njëjtin problem/nejë)
- Fletë për lëndët (p.sh. matematikë, gjuhë, biologji, arti viziv, etj.)
- 2 fletë ngjyrë për çdo pjesëmarrës
- Kurrikula të shtypura ose digjitale për lëndë të ndryshme (për frymëzim)
- Fletë flipchart (opsionale)
- Bandë ngjitëse (stickers)

**Kohëzgjatja:** 60 minuta

- Hyrje dhe udhëzime: 8 minuta
- Punë individuale: 8 minuta (shkrimi i qëllimeve të shërbimit dhe të mësimit)
- Punë në dyshe: 10 minuta (shkrimi i qëllimeve të reja të shërbimit dhe të mësimit në dysh)
- Punë në grupe: 10-15 minuta (shkrimi i një qëllimi të ri të shërbimit dhe të mësimit në grupe me katër pjesëmarrës)
- Rishikimi dhe krijimi i "murit të qëllimeve": 20-30 minuta

Përgatitni fletët për përshkrimin e problemeve/nevojave dhe fletët për lëndët për çdo pjesëmarrës. Çdo pjesëmarrës do të marrë një fletë që përshkruan një problem/nejë të komunitetit dhe një fletë që lidhet me një lëndë. Pjesëmarrësit do të punojnë fillimisht individualisht, më pas në dyshe dhe në fund në grupe me katër persona. Propozimet do të prezantohen vetëm në pjesën përfundimtare.

#### **Udhëzime:**

1. Përgatitni fletët e përshkrimit të problemeve/nevojave dhe fletët për lëndët, duke siguruar që çdo problem/nejë të ketë dy kopje identike.
2. Shpërndani një fletë për përshkrimin e problemit/nejës dhe një fletë me një lëndë për secilin pjesëmarrës.
3. Jepni secilit pjesëmarrës 2 fletë me ngjyra. Pjesëmarrësit duhet të shkruajnë një qëllim shërbimi në fletën e parë, bazuar në fletën e problemit/nejës që kanë tërhequr. Të gjithë pjesëmarrësit do të shkruajnë qëllimet e shërbimit në të njëjtën ngjyrë të fletës.
4. Në fletën tjetër, pjesëmarrësit duhet të shkruajnë një qëllim të të mësuarit që lidhet me lëndën që kanë marrë, me një lidhje të qartë me qëllimin e shërbimit. Për frymëzim, sigurohuni që kurrikulat përkatëse të jenë të gatshme, të shtypura ose digjitale.
5. Lejoni 8 minuta për punë individuale.
6. Përzgjidhni pjesëmarrësit në dyshe, duke i vendosur me ata që kanë të njëjtin përshkrim problemi/nejë. Në dyshe, ata duhet të shkruajnë të paktën një qëllim të ri shërbimi dhe një qëllim të të mësuarit për secilën lëndë. Kjo fazë do të zgjasë 10 minuta.
7. Pas punës në dyshe, grupojini pjesëmarrësit në grupe me katër veta. Në grupet me katër, ata do të shkruajnë një qëllim të ri shërbimi (për një nga problemet/nejat e tyre) dhe një qëllim të të mësuarit për secilën lëndë. Kjo fazë duhet të zgjasë 10-15 minuta.
8. Pasi të mbarohet puna në grupe, krijoni "murin e qëllimeve". Fillimisht, shkruani problemet/nejat në mur ose në flipchart. Më pas, pjesëmarrësit do të ngjisin qëllimet e shërbimit të propozuara në mur dhe do të paraqesin qëllimet përkatëse të të mësuarit për secilën lëndë, duke i vendosur ato në një kolonë të veçantë.
9. Për çdo qëllim që paraqitet, udhëheqësi duhet të rishikojë formulimin e qëllimit për të siguruar qartësinë dhe saktësinë.

**Vërejtje:** Ana e djathtë e murit të qëllimeve mund të lihet e hapur për të shtuar aktivitete shtesë në seancat e ardhshme, si dhe për të propozuar vlerësime për projektet e Vullnetarizmit Edukativ, sidomos në lidhje me lëndët e caktuara.



## Identifikimi i Shkaktarëve dhe Pasojave të Problemit

**Kohëzgjatja:** 60 minuta

**Faza 1:** 20 minuta

**Faza 2:** 20 minuta

**Faza 3:** 20 minuta

### **Përshkrimi:**

Ky aktivitet do t'i ndihmojë pjesëmarrësve të kuptojnë logjikën: nevoja – problemi – shkaktarët – pasojat – zgjidhja. Aktiviteti i ndihmon pjesëmarrësit të zhvillojnë mendimin analitik dhe të hetojnë shkaktarët e vërtetë të problemeve shoqërore për të kuptuar më mirë dhe për të ofruar shërbime të dobishme dhe me ndikim. Ky aktivitet ka 3 faza: 1. Definimi i "Pemës së Problemit", 2. Definimi i qëllimeve, 3. Definimi i ndikimit. Ky aktivitet mund të përdoret lehtësisht për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të Vullnetarizmit Edukativ me fëmijë ose të rinj.

### **Faza 1: Pema e Problemit**

#### **Udhëzime:**

Pasi të jetë identifikuar problemi kryesor dhe të jetë shkruar në një formulim të përmbledhur të problemit, tani është koha për të identifikuar shkaktarët dhe pasojat e tij. Një mjet i thjeshtë dhe i dobishëm për këtë është "**Pema e Problemit**".

Pema e Problemit është një përfaqësim vizual i problemit të zgjedhur dhe i shkaktarëve dhe pasojave të tij. Në trungun e pemës, pjesëmarrësit duhet të shkruajnë formulimin e problemit që kanë identifikuar në fazën e mëparshme – kjo është "zemra" e problemit që ata duan të adresojnë përmes projektit të Vullnetarizmit Edukativ në komunitet.

Pjesëmarrësit duhet të mendojnë për shkaktarët që kontribuojnë në këtë problem të caktuar: Çfarë qëndron pas këtij problemi? Nga vjen ai? Çfarë faktorësh e lejojnë që të vazhdojë? Ata duhet të shkruajnë secilin nga këta shkaktarë te rrënjët e pemës.

Gjithashtu, pjesëmarrësit duhet të reflektojnë mbi pasojat e problemit: Çfarë ndodh kur ky problem nuk zgjidhet? Çfarë probleme të tjera krijon nëse mbetet i pazgjidhur? Ata duhet të shkruajnë këto pasoja mbi gjethet e pemës.

Si trajner, është e rëndësishme të qarkulloni mes grupeve për t'u siguruar që ata po e kuptojnë aktivitetin dhe po punojnë siç duhet. Pas 15 minutash, kërkoni që grupet të përqendrohen tek ju për të shpjeguar hapin tjetër. (Ata nuk duhet të ndajnë rezultatet e tyre me të tjerët në këtë fazë.)

#### **Materiale:**

- Fletë pune për Pemën e Problemit (për të rekomanduar: vizatoni pemën në flipchart para sesionit)
- Markera
- Letër flipchart

Faza 2: Qartësimi i qëllimit të projektit

**Udhëzime:**

Shpjegoni se hapi tjetër në procesin e dizajnit të projektit është kalimi nga problemet te zgjidhjet – duke zhvilluar planin tuaj të projektit. Kjo do të fillojë duke "përmbysur" formulimin e problemit nga ushtrimi i Pemës së Problemit në një formulim të qëllimit që do të udhëheqë projektin.

Pyetni pjesëmarrësit nëse mund të identifikojnë karakteristikat e një qëllimi të shkruar mirë, duke nxjerrë në pah këto pika:

Përmbysja e problemit – qëllimi duhet të prezantojë zgjidhjen e problemit, duke e eliminuar ose zvogëluar atë.

Nuk supozohet një zgjidhje e vetme – qëllimi nuk duhet të përshkruajë një zgjidhje të caktuar, por duhet të ketë hapësirë për mundësi të ndryshme.

Përqendrimi në një qëllim të qartë dhe të vetëm – qëllimi duhet të jetë i fokusuar dhe të mos devijojë.

Përmbledhje në një fjali e asaj që dëshironi të bëni me projektin tuaj.

Pasi të kenë analizuar këto shembuj dhe karakteristika, ftoni çdo grup të marrë formulimin e problemit dhe ta kthejë atë në një qëllim të qartë. Si trajner, ju mund të dëgjoni grupet dhe t'i udhëzoni nëse hasin vështirësi por duhet të evitoni të dominoni procesin. Ky proces duhet të zgjasë disa minuta. Kur çdo grup të ketë shkruar një qëllim, mund të kaloni në fazën tjetër. (Ata nuk duhet ende të ndajnë rezultatet me grupin e madh.)

**Materiale:**

- Flipcharts
- Markera
- Shembuj të formulimeve të problemeve dhe qëllimeve
- Fletë pune për sqarimin e qëllimit të projektit

Fletushkë – ndryshimi midis deklaratës së problemit dhe qëllimit të projektit

Deklarata e problemit	Deklarata e qëllimit/ Qëllimi i projektit tuaj
<i>SHEMBULL:</i> LAGJJA KU TAKOHET KLUBI YNË I SUPER-VULLNETARËVE KA SHUMË MBETURINA NË RRUGË.	<i>SHEMBULL:</i> LAGJJA KU TAKOHET KLUBI YNË I SUPER-VULLNETARËVE KA RRUGË TË PASTËRTA.

*QENËT ENDACAK PO RREZIKOJNË SIGURINË E FËMIJËVE GJATË RRUGËS SHTËPISË – SHKOLLË*

*FËMIJËT LËVIZIN TË SIGURT NË LAGJE NGA SHTËPIA NË SHKOLLË NDERSA PËR QENËT ENDACAK KA KUJDES NË MËNYRË HUMANE.*

### **Faza 3: Objektivat dhe parashikimi i ndikimit**

**Përshkrimi:** Pasi të jetë identifikuar deklarata e qëllimit, është koha për të identifikuar hapat kryesorë që klubi do të ndërmarrë për të përmbushur atë qëllim. Këto janë objektivat e projektit. Një mjet i thjeshtë dhe i dobishëm për t'u përdorur në identifikimin e objektivave është Pema e Zgjidhjes së Problemit.

#### **Udhëzimet**

Kërkojini secilit grup t'i referohet ushtrimit të përfunduar të Pemës së Problemeve. Më pas jepini secilit grup një flipchart, markera, dhe një kopje të fletushkës së Pemës së Zgjidhjes së Problemeve. Pema e Zgjidhjes së Problemeve është një version pozitiv i Pemës së Problemeve dhe shërben si një përfaqësim i qëllimit të zgjedhur dhe hapave të nevojshëm për të arritur atje (objektivat) si dhe ndikimin e pritshëm që mund të ketë zgjidhja e atij problemi (rezultatet).

Në trungun e pemës thujuni pjesëmarrësve të shkruajnë deklaratën e tyre të qëllimit. Më pas ftoni grupet e vogla të marrin disa minuta për të reflektuar mbi shkaqet rrënjësore që kanë shkruar në pemën e tyre të problemit. Cilën nga këto mund t'i adresojnë ata nëpërmjet veprimeve konkrete për të ndihmuar në arritjen e qëllimit të tyre? Njejtë siç kanë bërë tek deklarata e qëllimit "duke e përmbysur problemin dhe duke e shkruar versionin pozitiv të deklaratës së problemit" ftoni grupet që të gjejnë shkaqet rrënjësore dhe t'i "përmbysin" ato në mënyrë që të përshkruajnë objektivat për projektin. Kërkoni nga secili grup që të prioritojnë vetëm tri objektiva në mënyrë që të mund të menaxhohet madhësia e projektit.

Pasi të kenë zgjedhur tri shkaqet rrënjësore, ata duhet të fokusohen në objektivat e projektit, kërkoni grupit që të formulojnë këto objektiva në një fjali më specifike (dhe të limituara) duke i bërë ato "SMART" duke përdorur formulën e mëposhtme:

- Specifike: Çfarë? Kur? Ku? Për kë?
- Të matshme: Çfarë rezultatesh do të marr? Sa persona do të preken/afektohen?
- Të arritshme: A i ka Klubi burimet e nevojshme për të përmbushur këtë objektiv ose këto objektiva?
- Realiste: A është afati kohor realist? A janë të mundshme të mirren/gjinden burimet e nevojshme?
- I kufizuar në kohë (Time-bound): Në çfarë periudhe kohore do të ndodhë kjo? A ka një datë të caktuar përfundimi i asaj objektivave

Sigurohuni t'i kushtoni vëmendje progresit të grupeve dhe t'i ndihmoni t'i drejtoni ata kur kanë pengesa në rrugë. Sigurohuni që t'u kujtoni grupeve se sa kohë ka mbetur.

Pasi grupet të kenë shkruar objektivat e tyre, kërkojuni atyre të diskutojnë dhe të shkruajnë efektet dhe ndikimin e parashikuar që do të ketë projekti i tyre nëse arrihet qëllimi. Këto efekte duhet të shkruhen në mes të gjetheve të Pemës së Zgjidhjes së Problemit. Ato nuk duhet të formulohen në një mënyrë të veçantë por shërbejnë si një vlerësim për të ndihmuar një klub të parashikojë se cili do të jetë rezultati përfundimtar i projektit të tyre nëse ai projekt ka sukses.

Pasi të mbarojnë grupet, ftoni të kthehen në grupin e madh dhe caktoni një anëtar që të ndajë Pemën e

tyre të Zgjidhjes së Problemit dhe të merrni koment.

**Materiale:**

- Fletë pune për Pemën e Zgjidhjeve,
- flipcharts,
- shënues.

**Një aktivitet ose çështje e komunitetit**

**Kohëzgjatja: 15 minuta**

**Përshkrimi:**

Hartimi i nevojave të komunitetit është një pjesë thelbësore e çdo projekti të Vullnetarizmit Edukativ. Nevoja gjithmonë merr përparësi ndaj idesë, kjo është një nga karakteristikat kyçe. Një nevojë e paplotësuar mund të riformulohet në një qëllim shërbimi, por jo në një aktivitet. Ky ushtrim është i thjeshtë dhe nuk kërkon shumë kohë. Pjesëmarrësit duhet të mësojnë dallimet mes një nevojë të hartuar paraprakisht dhe një aktiviteti.

**Udhëzime:**

Trajneri përgatit paraprakisht një fletë pune të shtypur me shembuj aktivitetesh dhe nevojash. Secilit pjesëmarrës i jepet një fletë pune dhe i jepen afërsisht 5 minuta për ta plotësuar. Më pas, trajneri i shqyrton përgjigjet e sakta me pjesëmarrësit dhe justifikimin e tyre. Në fund, pjesëmarrësit duhet të shtojnë një aktivitet dhe një nevojë komunitare shtesë.

**Materiale të nevojshme:**

Fletë pune: një aktivitet ose çështje/nevojë komunitare

Shembuj	Aktivitet	Nevojë ose çështje
1. Fushatë publike ose promovim i vullnetarizmit të të rinjve.		
2. Cilësi e ulët e shërbimeve sociale për të moshuarit në zonat rurale.		
3. Ndërgjegjësim i pamjaftueshëm i banorëve lokalë për dëmet e deponive ilegale.		
4. Mësimdhënie shtesë për fëmijët e shkollave fillore për arritjen e shkrim-leximit.		
5. Kompetenca të pamjaftueshme në fushën e pjesëmarrjes aktive në komunitetin lokal.		
6. Punëtori për fëmijët mbi qëllimet e qëndrueshmërisë globale.		

7. Rikonstruktimi i një ndërtese publike për qëllime të aktiviteteve kulturore të të rinjve.		
8. Shkalla e lartë e papunësisë së personave me aftësi të kufizuara.		

## Harta e Komunitetit dhe Identifikimi i Problemeve në Komunitet

**Kohëzgjatja:** 2 orë

1. Çfarë është një Hartë e Komunitetit? (15 minuta)
2. Harta e Komunitetit në Terren (45 minuta)
3. Vizatimi i Hartës së Komunitetit (30 minuta)
4. Prezantimi i Hartave të Komunitetit (30 minuta)

### Përshkrimi:

Ky aktivitet ka për qëllim t'u ndihmojë pjesëmarrësve të mësojnë rreth hartës të komunitetit si një mjet për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta të një komuniteti të caktuar. Përmes eksplorimit praktik dhe diskutimit në grup, pjesëmarrësit do të fitojnë një kuptim më të thellë të sfidave me të cilat përballet komuniteti i tyre dhe do të identifikojnë mundësitë për projekte të vullnetarizmit edukativ.

### Udhëzime:

1. Shpjegoni pjesëmarrësve se një hartë e komunitetit është një mjet që përdoret për të vëzhguar dhe vlerësuar në mënyrë kritike pikat e forta dhe të dobëta të një komuniteti specifik. Harta ndihmon në vizualizimin e aseteve dhe sfidave brenda komunitetit.
2. Ndani pjesëmarrësit në 3-4 grupe. Udhëzoni të dalin në terren dhe të vëzhgojnë me kujdes komunitetin. Ata duhet t'i kushtojnë vëmendje rrugëve, ndërtesave, shtëpive, hapësirave të gjelbra, shkollave, qendrave shëndetësore, dyqaneve dhe institucioneve të tjera të rëndësishme. Inkurajoni pjesëmarrësit të bëjnë fotografi dhe të intervistojnë të paktën një person nga komuniteti për një çështje lokale.
3. Pas kthimit, secili grup vizaton hartën e komunitetit të tyre duke përfshirë veçoritë kryesore si kufijtë, rrugët, ndërtesat dhe institucionet. Pikat pozitive (asetet) duhet të shënohen me një ngjyrë, ndërsa problemet me një ngjyrë tjetër. Diskutoni rëndësinë e secilës veçori dhe rolin e saj në përmirësimin ose sfidimin e komunitetit.
4. Pasi grupet të kenë përfunduar hartat e tyre, udhëzoni ata të reflektojnë mbi pyetjet e mëposhtme:
  - Cilët probleme do të priorizonin si grup?
  - Cilat probleme janë më urgjente ose kanë pasoja më serioze?
  - Cilat asete të komunitetit mund të përdoren për të adresuar këto probleme?
  - Me kë mund të bashkëpunoni në komunitet për të trajtuar këto çështje?
5. Çdo grup prezanton hartën e tyre dhe përfundimet për pjesëmarrësit e tjerë. Secili grup ka 3 minuta për të shpjeguar çështjen që kanë prioritarizuar dhe pse ajo është një pikë e mirënjohjes për një projekt të vullnetarizmit edukativ.
6. Përfundoni duke kujtuar se një projekt i vullnetarizmit edukativ ka disa faza, përfshirë sigurimin e

mbështetjes nga komuniteti dhe zhvillimin e planeve të veprimit.

#### 7. Përfundoni sesionin me pyetje reflektuese:

- Cilat janë pikat e forta të këtij ushtrimi? Po dobësitë e mundshme?
- Çfarë mësuat personalisht nga ky ushtrim?
- Si mund të përfshihet komuniteti në një mënyrë kuptimplotë?
- A mendoni se hartimi i komunitetit do të jetë një mjet i dobishëm për klubin tuaj?
- Cili mendoni se është hapi tjetër në zhvillimin e një projekti të vullnetarizmit edukativ?

#### **Materiale të nevojshme:**

- Fletë të mëdha (flipchart)
- markera
- shishe uji për pjesëmarrës
- projektor (opcionale)

### **Shkrepja e Fotografive**

#### **Materialet:**

- 2 korniza kartoni për çdo grup (një e kuqe dhe një e gjelbër)
- Letër flipchart, markera
- Projektor (opsional)

#### **Kohëzgjatja:**

45 - 60 minuta

- 10 minuta: Hyrje dhe udhëzime
- 20 minuta: Aktiviteti i fotografisë
- Koha shtesë për rishikimin dhe diskutimin e fotografive (rreth 15-20 minuta)

#### **Përshkrimi:**

Ky aktivitet është i përshtatshëm si hyrje në temën e hartimit të nevojave të komunitetit. Ai përqendrohet kryesisht në hartimin e problemeve/nevojave të lokalitetit në aspektin hapësinor por mund të përdoret edhe për domenin social. Në këtë rast, në hyrje do të shtohet një diskutim mbi temën e “komunitetit” siç e kuptojmë në Vullnetarizmin Edukativ, kush mund të jetë një komunitet, etj.

#### **Udhëzime:**

1. Ndani pjesëmarrësit në grupe të vogla (4-5 persona).
2. Jepni çdo grupi një kornizë kartoni të kuqe dhe një të gjelbër.
3. Udhëzoni grupet të lëvizin rreth ndërtesës ose zonës përreth dhe të bëjnë fotografi duke përdorur kornizat.
  - Korniza e gjelbër për zonat e këndshme ose të dizajnuara mirë.

- Korniza e kuqe për zonat problematike, të neglizhuara ose që kanë nevojë për përmirësim.
4. Lejoni grupet të shkrepin fotot për 20 minuta.
  5. Pas sesionit të fotografimit, mbliidhni të gjithë pjesëmarrësit dhe rishikoni fotografitë së bashku.
  6. Për fotot me kornizë të kuqe, identifikoni çështjet specifike ose problemet në ato zona.
  7. Nxisni pjesëmarrësit të mendojnë për mënyra alternative të hartimit të problemeve dhe nevojave, që ata ose fëmijët/të rinjtë mund të përdorin në të ardhmen.
  8. Shkruani metodat e sugjeruara në flipchart për diskutime të mëtejshme.

## Misioni i Pamundur

**Kohëzgjatja:** 60 minuta

### Përshkrimi:

Ky aktivitet nënvizon rëndësinë e veprimit brenda Vullnetarizmit Edukativ dhe rolin e mësimitdhënësit/punonjësit rinor gjatë zbatimit të aktiviteteve. Pjesëmarrësit do të marrin rolet që zakonisht kanë fëmijët/të rinjtë gjatë një projekti të Vullnetarizmit Edukativ. Në fund, ata reflektojnë mbi këtë përvojë dhe diskutojnë rolin e mësimitdhënësit/punonjësit gjatë procesit.

### Procesi hap pas hapi për trajnerin:

1. Trajneri ndan pjesëmarrësit në grupe të vogla (maksimumi 8 anëtarë). Shpjegohet që detyra e grupeve është të përfundojnë disa detyra të caktuara brenda një kohe të përcaktuar.

Përfundimi i detyrave përbëhet nga 4 faza:

1. Faza - anëtarët e grupit kanë 3 minuta për të rënë dakord mbi një strategji për të përfunduar detyrat e mëposhtme
2. Faza - pas tre minutash pushojnë së foluri, kanë mbetur edhe 4 minuta për të përfunduar
3. Faza - pasi të ketë kaluar koha (gjithsej 7 minuta), do të kontrollojmë përfundimin e detyrave
4. Faza - reflektim mbi lojën

2. Trajneri përdor një kohëmatës dhe shfaq detyrat (me projektor/flipchart ose të printuara).

3. Pasi të kalojë koha, bëhet reflektimi, pjesëmarrësit mbeten ende në grupe ndërsa kryejnë detyrat individuale.

Reflektimi pas lojës përbëhet nga këto detyra:

- Sa mirë u ndjetë gjatë zgjidhjes së detyrave? (me nota nga 1 deri në 10)
- Sa ishit të angazhuar në përmbushjen e detyrave? (me nota nga 1 deri në 10)
- Si e menaxhuat aktivitetin? Çfarë bëtë fillimisht, më pas?
- Kush sugjeroi idetë, kush koordinoi, dhe kush kontrolloi?
- Si mendoni se lidhet ky aktivitet me temën: roli i mësimitdhënësit gjatë implementimit?

4. Trajneri i drejton grupit një pyetje: Çfarë mendoni se duhet bërë ndërkohë që fëmijët/të rinjtë kryejnë aktivitetin e dhënë në komunitet? Trajneri do t'i lërë pjesëmarrësit të sugjerojnë dhe të shtojnë në

mënyrë të përshtatshme.

Roli i mësuesit/punonjësit të të rinjve varet nga modeli i Vullnetarizmit Edukativ dhe nga mosha e fëmijëve/të rinjve, por kryesisht konsiston në krijimin e një hapësire për të mësuar nëpërmjet shërbimit në komunitet.

Gjatë realizimit të aktivitetit, mësuesi/punonjësi i të rinjve duhet kryesisht:

- Rritni përfitimin e përgjithshëm të përvojës së Vullnetarizmit Edukativ
- Sqaroni angazhimet, pritjet dhe rolet.
- Mbani fokusin në qëllimet e të mësuarit dhe zhvillimit.
- Mbështetni fëmijët/të rinjtë vajzat dhe djemt gjatë shërbimit të tyre.
- Inkurajoni përvojat ndërpersonale dhe ndërkulturore.
- Ndhmoni në menaxhimin e ndryshimeve gjatë zbatimit të projektit të Vullnetarizmit Edukativ
- Siguroni mbikëqyrje dhe siguroni siguri.
- Ruani energjinë dhe entuziazmin.
- Dokumentoni përvojat dhe përgatitni reflektim.
- Jini aktiv

#### **Materialet e nevojshme:**

- Flipchart/ prezantim me detyra/ detyra të printuar
- Fletë pune: shembuj të detyrave për grupet:

#### **Shembuj detyrash:**

1. Sjellni 3 gurë të ndryshëm.
2. Ndërtoni një totem (të paktën 30 cm të lartë) nga gjërat që keni në dispozicion.
3. Shkruani emra femrash me alfabet të shkurtër.
4. Sjellni 3 gjethe nga pemë të ndryshme.
5. Mblidhni 10 datëlindje dhe emra nga të pranishmit.
6. Këndoni një pjesë të një kënge.
7. Tre anëtarë të grupit duhet të bëjnë nga 20 ulje-ngritje secili.
8. Shpikni një poezi me 4 vargje për të enjten.
9. Vishni një anëtar të grupit me 6 rroba të tjera nga anëtarët e grupit.
10. Hartoni një menu dreke për çdo ditë të javës.
11. Ndërtoni 3 avionë letre.
12. Bëni një foto të të gjithë anëtarëve të grupit.
13. Shpikni 5 arsye pse është më mirë të jeni në trajnim sesa në shtëpi.
14. Mbledhni numrat e këmbëve të të gjithë pjesëmarrësve.
15. Numëroni dritaret në dhomë.
16. Tregoni diçka që lidhet me ekologjinë.

#### **Reflektimi në Vullnetarizmin Edukativ**

**Kohëzgjatja:** 20 minuta



## **Përshkrimi:**

Ky aktivitet prezanton pjesëmarrësit me rëndësinë e reflektimit në vullnetarizmin edukativ duke krahasuar dy shembuj të rezultateve të reflektimit—një me aktivitete reflektuese dhe një tjetër pa aktivitete reflektuese. Ushtrimi gjithashtu përfshin pjesëmarrësit në identifikimin e dallimeve dhe sugjerimin e përmirësimeve.

## **Procesi hap pas hapi për trajnerin:**

### **1. Caktimi i Roleve (2 minuta):**

- "Në fillim të kësaj pjese, do të caktoj role për dy pjesëmarrës. Njëri do të jetë aktiv dhe do të marrë pjesë në diskutimin grupor, ndërsa tjetri do të jetë pasiv dhe do të vëzhgojë. Roli i vëzhguesit është i rëndësishëm për pjesën tjetër të sesionit. Ju lutem, regjistroni atë që vëreni gjatë këtij aktiviteti."
- "Pjesëmarrësi aktiv do të angazhohet si zakonisht, ndërsa pjesëmarrësi pasiv do të vëzhgojë vetëm atë që po ndodh."

### **2. Prezantimi i Shembujve (5 minuta):**

- "Tani do të prezantoj dy shembuj të rezultateve të reflektimit: një është një reflektim i pasur që përfshin aktivitete gjatë gjithë semestrit, dhe tjetri është një reflektim i dobët pa aktivitete reflektuese."
- "Le të shohim këta dy shembuj dhe të diskutojmë: 'Cili është ndryshimi kryesor mes tyre?' Çfarë ndodhi në çdo rast dhe çfarë mungon në shembullin e dobët?"

### **3. Diskutimi në Grup (10 minuta):**

- "Le të diskutojmë këta shembuj. Çfarë vini re në shembullin 'e pasur' që nuk është në shembullin 'e dobët'? Çfarë mendoni se ndodhi këtu? Pse është reflektimi i rëndësishëm në vullnetarizmin edukativ?"
- "Do të shkruaj vërejtjet tuaja në flipchart, duke theksuar dallimet midis dy shembujve."

### **4. Prezantimi i Ciklit të të Nxënit Përmes Përvojës (5 minuta):**

- "Le të kalojmë tani te koncepti i të nxënit përmes përvojës. Reflektimi është një element kyç në ciklin e mësimi. Tani do t'ju shfaq një slajd që shpjegon ciklin e të nxënit përmes përvojës, ku reflektimi luan një rol thelbësor."
- "Duke u kthyer te shembujt që diskutuam, si mund ta përmirësonim reflektimin në shembullin e dobët për ta bërë më të pasur?"

### **5. Pyetje për reflektim:**

- "Cilat ishin dallimet kyçe mes shembujve?"
- "Pse është reflektimi një pjesë e domosdoshme e vullnetarizmit edukativ?"
- "Cilat hapa praktike mund të ndërmarrim për të përmirësuar reflektimin në mësimdhënien tonë?"

## **Materialet e Nevojshme:**

- Flipchart dhe markerë
- Slajde me shembuj të rezultateve të reflektimit (një i pasur dhe një i dobët)
- Slajd për ciklin e mësimi përmes eksperiencës.

## **FLETUSHKË: SHEMBUJ TË REFLEKTIMIT**

## **Slajdi 1 - Reflektimi i Mirë**

Kjo është hera e parë që u përballa me dobishmërinë e njohurive të mia për problemin praktik që po përballesha. Më dukej kaq abstrakt më parë dhe tani kuptova. Mendova se do të ishte më e lehtë. Shumë komunikim, keqkuptime, kompromise. Partneri i komunitetit ishte i ngarkuar dhe duhej të punonim rreth orarit të tij. Me fat që kisha një ekip dhe ia dolëm të ndajmë barrën e projektit. Mësova shumë për profesionin tim të ardhshëm. Mezi pres të filloj punë. Partneri im në komunitet e pëlqeu projektin dhe do të qëndrojmë në kontakt për nevojat e ardhshme. Ndoshta do të punojmë së bashku në një projekt tjetër. (Nensi, 2016)

## **Slajdi 2 - Reflektimi Jo i Mirë**

Herë pas here kam bërë punën, por në fakt nuk kam mësuar asgjë. Mendoj se e kam humbur kohën. Nuk e shoh kuptimin e punës aq shumë dhe për një periudhë kaq të gjatë dhe gjithë atë falas. Nuk ka lidhje me kursin përkatës. Do të kisha mundur ta përdorja kohën më efektivisht. Partneri i komunitetit nuk ishte aspak i interesuar për projektin. Ishim thjesht prishës të orarit të tij shumë të ngarkuar. (John, 2017)

## **Reflektimi – Niveli, Llojet dhe Pyetjet**

**Kohëzgjatja:** 35 minuta

### **Përshkrimi:**

Ky ushtrim fton pjesëmarrësit të reflektojnë mbi momentet e ndryshme të reflektimit gjatë trajnimit. Qëllimi është të identifikojmë kur ka ndodhur reflektimi, çfarë është reflektuar dhe cilat pyetje janë përdorur. Kjo inkurajon pjesëmarrësit të njohin aspektet kyçe të reflektimit në vullnetarizmin edukativ.

### **Procesi hap pas hapi për trajnerin:**

- 1. Pyetje për Reflektimin në Grup (5 minuta):**
  - "Le të fillojmë duke shikuar pas në trajnimin që keni marrë deri tani. Mund të na tregoni ndonjë moment gjatë këtij trajnimi kur kemi bërë reflektim?"
  - Trajneri shkruan përgjigjet në flipchart.
- 2. Identifikimi i Momenteve të Reflektimit (10 minuta):**
  - "Për çdo moment që përmendni, ne do të shtojmë kohën ose sesionin e trajnimit kur ka ndodhur reflektimi. Kjo do të na ndihmojë të kuptojmë si është integruar reflektimi gjatë sesionit."
  - Trajneri shkruan oraret e momentit të reflektimit përkatës në flipchart.
- 3. Çfarë është Reflektuar? (10 minuta):**
  - "Tani, le të diskutojmë se për çfarë kemi reflektuar gjatë këtyre momenteve. Çfarë temash, sfidash ose ide kanë qenë objekt i reflektimit?"
  - Trajneri shton nivelet e reflektimit (p.sh., personal, teorik, praktik, etj.) në flipchart.
- 4. Pyetjet e Reflektimit të Përdorura (5 minuta):**
  - "Cilat pyetje specifike kemi përdorur për të udhëhequr reflektimet tona? Mund të kujtoni ndonjë pyetje që ju ndihmoi të mendoni më thellë gjatë momenteve tona reflektuese?"

- Trajneri shkruan pyetjet e reflektimit që janë përmendur nga grupi në flipchart.
5. **Pyetje për reflektim:**
- "Pse është e rëndësishme të reflektojmë në momente të ndryshme gjatë një seance trajnimi?"
  - "Si e ndihmuan llojet e ndryshme të reflektimit (personal, teorik, praktik) për të fituar njohuri të thella?"
  - "Si mund të aplikoni këto teknika reflektimi në praktikën tuaj të mësimdhënies?"

#### **Materialet e Nevojshme:**

- Flipchart dhe markerë
- Fletushkë: Reflektimi në Vullnetarizmin Edukativ

#### **Pse Reflektimi dhe Vlerësimi**

**Kohëzgjatja:** 30 minuta

#### **Përshkrimi:**

Ky aktivitet ka për qëllim të ndihmojë pjesëmarrësit të kuptojnë rëndësinë e reflektimit dhe vlerësimit në projektet e vullnetarizmit edukativ. Reflektimi i lejon individët të mendojnë pas për eksperiencat e tyre, ndërsa vlerësimi përfshin vlerësimin e këtyre eksperiencave sipas kriterëve të caktuar. Aktiviteti përfshin punë grupore ku pjesëmarrësit reflektojnë mbi çfarë do të thonë këto terma dhe prezantojnë reflektimet e tyre nëpërmjet një ushtrimi të krijimit të statujave. Pas prezantimit të statujave, grupet do të angazhohen në një diskutim të shpejtë dhe reflektim për të sqaruar ndryshimin mes reflektimit dhe vlerësimit dhe pse të dyja janë thelbësore për suksesin e projekteve të vullnetarizmit edukativ.

#### **Udhëzime:**

1. Filloni sesionin duke shpjeguar rëndësinë e reflektimit dhe vlerësimit. Sqaroni dallimin: reflektimi është të mendosh pas për eksperiencat, ndërsa vlerësimi përfshin vlerësimin e këtyre eksperiencave ndaj disa kriterëve të caktuar.
2. Udheheqni grupin në një diskutim të shkurtër mbi pse është i rëndësishëm reflektimi dhe vlerësimi në projektet e vullnetarizmit edukativ. Përdorni një flipchart të zbrazët për të shkruar përgjigjet e pjesëmarrësve në pyetjet:
  - Pse është i rëndësishëm vlerësimi dhe reflektimi?
  - Çfarë vlerësojmë/reflektojmë mbi projektet e vullnetarizmit edukativ?
3. Kërkoni nga pjesëmarrësit të mendojnë për çfarë do të thotë reflektimi për ta dhe çdo grup të krijojë një statujë që përfaqëson idenë e tyre të reflektimit. Inkurajoni ata të punojnë së bashku për 15 minuta.
4. Pas përfundimit të statujave, ftoni çdo grup të prezantojë statujën e tij para pjesëmarrësve të tjerë. Grupi tjetër do të komentojë statujën, duke diskutuar nëse reflektimi është përfaqësuar qartë dhe duke eksploruar rolet e figurave në secilën statujë.
5. Pas çdo prezantimi, bëni pyetje ndihmuese, si:
  - Çfarë përfaqëson statuja?
  - A është reflektimi i qartë?

- Çfarë roli luan çdo person apo figurë në statujë?
6. Pas përfundimit të prezantimeve, bashkujini pjesëmarrësit në një reflektim të madh grupor. Përcillni pikë kyçe mbi rolin e reflektimit dhe vlerësimit në projektet e vullnetarizmit edukativ, duke përfshirë tema si:
- Rëndësia e reflektimit dhe vlerësimit për monitorimin e forcave dhe dobësive të projektit.
  - Si vlerësimi ndihmon për të ndjekur rritjen personale dhe zhvillimin e ekipit.
  - Pse vetëvlerësimi dhe reagimi i sinqertë janë thelbësore për të mësuar nga projektet e vullnetarizmit edukativ.
7. Përmbylleni sesionin duke shpjeguar se reflektimi dhe vlerësimi ndodhin pas çdo projekti të vullnetarizmit edukativ, zakonisht gjatë takimeve të vlerësimit që mbahen çdo 4-6 muaj. Këto takime ndihmojnë ekipin të mësojë nga projektet e kaluara dhe të planifikojë për të ardhmen.

### **Materialet e Nevojshme:**

- Flipchart
- Markerë
- Hapësirë e zbrazët për prezantimin e statujave të grupeve (ose objekte për krijimin e statujave, në varësi të burimeve të disponueshme)

### **Hyrje në Reflektim**

**Kohëzgjatja:** 40 minuta

- Punë në grupe: 8 minuta
- Prezantime dhe diskutime në grupe: 15 minuta
- Përmbledhje dhe bazë teorike: 10 minuta

### **Udhëzime për Trajnerin:**

#### **1. Përgatitja Fillestare (2 minuta):**

- Pjesëtarët ndahen në grupe të vogla.
- Çdo grup merr një studim rasti të ndryshëm që përshkruan një projekt Vullnetarizmi Edukativ. Sigurohuni që studimet e rasteve të vijnë nga fusha të ndryshme (p.sh., puna me të moshuarit në një institucion kujdesi, përmirësimi i hapësirave publike, ruajtja e mjedisit, angazhimi me komunitetin, etj.).

#### **2. Punë në Grupe (8 minuta):**

- Kërkojini grupeve të analizojnë studimin e rastit të caktuar dhe të identifikojnë se çfarë kanë mësuar fëmijët/të rinjtë gjatë përvojës së Vullnetarizmit Edukativ të përshkruar në projekt.
- Inkurajoni grupet të fokusohen në rezultatet e mësimit akademik dhe jo-akademik, si:
  - Njohuri dhe aftësi në fushën e lëndës,
  - Rritje personale, si përgjegjësia, komunikimi dhe puna në ekip,
  - Ndërgjegjësimi social dhe komunitar.
- Kërkojini grupeve të shkruajnë përfundimet e tyre në një flipchart ose tabelë të bardhë.

#### **3. Prezantime në Grupe (15-20 minuta):**

- Pasi grupet të kenë përfunduar punën, kërkojini atyre të prezantojnë përfundimet e tyre. Ata duhet të shpjegojnë se çfarë kanë mësuar fëmijët/të rinjtë nga projekti dhe pse mendojnë që këto janë rezultate kyçe.
- Pasi të kenë prezantuar të gjitha grupet, udhëhiqni një diskutim me pyetjet udhëzuese si:
  - "Si e dini se çfarë kanë mësuar fëmijët/të rinjtë nga këto projekte?"
  - "Si mund të siguroheni që fëmijët/të rinjtë të mësojnë atë që keni identifikuar si rezultate kyçe?"
  - "Çfarë hapash do të ndërmerri për të siguruar që këto rezultate mësimi të arrihen?"

#### 4. Diskutim dhe Reflektim (10 minuta):

- Përmbledhni pikat kryesore të diskutimit.
- Theksoni rëndësinë e reflektimit në procesin e Vullnetarizmit Edukativ dhe rolin që ai luan në sigurimin që fëmijët/të rinjtë të mësojnë në mënyrë efektive.
- Prezantoni bazën teorike mbi reflektimin në Vullnetarizmin Edukativ:
  - Shpjegoni se reflektimi është një element kyç sepse ndihmon fëmijët/të rinjtë të lidhin përvojat e tyre me mësimin dhe zhvillimin personal.
- Prezantoni disa metoda reflektimi që mund të përdoren në Vullnetarizmin Edukativ, si:
  - Ditorë ose shënime reflektimi
  - Diskutime grupore ose reflektime
  - Metoda kreative si arti, prezantime ose tregime
- Përmbyllni duke theksuar se reflektimi duhet të integrohet gjatë gjithë procesit të Vullnetarizmit Edukativ, jo vetëm në fund.

#### Materiale të Nevojshme:

- Përshkrime të studimeve të rasteve të projekteve të ndryshme të Vullnetarizmit Edukativ (p.sh., puna me të moshuarit në një institucion kujdesi, një projekt për përmirësimin e hapësirave publike, etj.)
- Flipchart ose tabela të bardha dhe markerat për punën dhe prezantimet në grupe.

### Standardet e Cilësisë për Projektet e Vullnetarizmit Edukativ

**Kohëzgjatja:** 60 minuta

**Përshkrimi:** Ky aktivitet siguron kuptimin e Standardeve të Vullnetarizmit Edukativ si aspekte të cilësisë për çdo ide të Vullnetarizmit Edukativ dhe si fazat e ndryshme të projektit të Vullnetarizmit Edukativ duhet të duken në lidhje me procesin dhe rezultatet përfundimtare. Për shembull, nëse vëzhgojmë standardet e angazhimit të fëmijëve/të rinjve, është e rëndësishme të kuptojmë çfarë do të thotë që fëmijët/të rinjtë të zhvillojnë, zbatojnë dhe vlerësojnë projektin e Vullnetarizmit Edukativ. Pranimi i Standardeve të Cilësisë si udhëzues të cilësisë në projektet e Vullnetarizmit Edukativ ndikon në qëndrimet e mësimdhënësve ose udhëheqësve të të rinjve ndaj punës me fëmijët/të rinjtë: çfarë roli duhet të kenë të rriturit kur punojnë me fëmijët/të rinjtë: roli i lehtësuesit dhe mentorit ose roli i marrjes përsipër të procesit dhe rrjedhës së punës.

#### Udhëzime Hapi-për-Hapi:

Për këtë aktivitet do të përdorni Fletushkën e Standardeve të Cilësisë për Vullnetarizmin Edukativ.

1. Informoni pjesëmarrësit se për këtë aktivitet do të kalojmë përmes të gjitha kriterëve të Standardeve të Vullnetarizmit Edukativ dhe do të shohim se si mund të arrihen këto kritere dhe përmes cilave veprime.
2. Sigurohuni që të kaloni çdo kriter të Standardeve të Vullnetarizmit Edukativ një nga një dhe që të jetë e qartë për të gjithë pjesëmarrësit.

### **Materiale të Nevojshme:**

- FLETUSHKË – Standardet e Cilësisë për Vullnetarizmin Edukativ

Fletushkë – Standartet e Cilësisë për Vullnetarizmin Edukativ

1. **Angazhimi i fëmijëve/të rinjve përgjigjet ndaj një nevoje reale ose një problemi të vërtetë në mjedisin e komunitetit.** Fëmijët/të rinjtë janë të përfshirë në përzgjedhjen dhe planifikimin e angazhimit të tyre dhe marrin një detyrë me kuptim dhe dobi. Vullnetarizmi Edukativ fillon atje ku fëmijët/të rinjtë angazhohen. Kur ata ndjehen se njohuritë dhe aftësitë e tyre janë vërtet të nevojshme dhe se mund të kontribuojnë me diçka me vlerë, ata përjetojnë efikasitetin e vetvetes. Një aktivitet sfidues krijon kureshtje, motivim dhe shumë tema për diskutim që mund të ndërtohen në shkollë ose organizatë. Përkundrazi, një aktivitet i mërziqshëm dhe pakuptim mund të çojë në demotivim dhe refuzimin e projektit. Prandaj gjetja e nevojës reale së bashku në një fazë kërkimore duhet të jetë pjesë e çdo projekti. Është e rëndësishme që fëmijët/të rinjtë të marrin përsipër një detyrë ku ata mund të kontribuojnë me pikat e forta dhe interesat e tyre dhe për këtë arsye ta kuptojnë atë si detyrë "të tyre". Kjo i pengon ata të perceptohen si "praktikanti i dhjetë" apo edhe të shihen si barrë ("gur mulliri në qafë").
2. **Projektet janë pjesë e mësimëve dhe/ose të lidhura me përmbajtjen e kurrikulës.** Një qëllim kyç i Vullnetarizmit Edukativ është që fëmijët/të rinjtë të përjetojnë aplikueshmërinë praktike të njohurive akademike. Dhe, përkundrazi, që ata të mund të pasurojnë mësimet me përvojat e tyre. Kjo i jep kuptim njohurive të mësuara në shkollë ose organizatë. Kjo lidhje e ngushtë mes mësimin kognitiv dhe atij social është veçoria e veçantë e Vullnetarizmit Edukativ. Për të përdorur fjalët e John Dewey ajo shndërrohet nga "njohuri e rikuperueshme" në "të kuptuarit e njohurive" që mund të zbatohet në situata të tjera. Lidhja e ngushtë mes të mësuarit njohës dhe social, në mënyrë që të dyja të përfitojnë nga njëri-tjetri, është karakteristikë e veçantë e Vullnetarizmit Edukativ. Lidhja me mësimdhënien lëndore ose kurrikulën e arsimit joformal është gjithashtu e rëndësishme për të arritur tek fëmijët/të rinjtë që nuk do të angazhoheshin vullnetarisht jashtë shkollës ose organizatës. Nëpërmjet Vullnetarizmit Edukativ, mësimdhënia bëhet e gjallë dhe e orientuar drejt veprimit.
3. **Ka reflektim të rregullt dhe të planifikuar mbi përvojat e fëmijëve/të rinjve.** Reflektimi është LIDHJA që lidh përvojat personale të angazhimit dhe mësimin akademik në shkollë ose organizatën rinore. Reflektimi ndihmon për të kuptuar dhe lidhur përvojat, forcimin e aftësive metakognitive dhe zhvillimin e kompetencave për zgjidhje komplekse të problemeve. Të menduarit për kontekstin dhe kuptimin e përvojës vetjake, i udhëhequr nga pyetje të synuara, ua bën të qartë qëllimin e angazhimit fëmijëve/të rinjve. Pikat e forta dhe të dobëta personale bëhen më të qarta, transferimi i njohurive të lëndës lehtësohet dhe kompetencat metakognitive

(p.sh., zgjidhja komplekse e problemeve, menaxhimi i proceseve të të mësuarit).

4. **Angazhimi praktik i fëmijëve/të rinjve ndodh jashtë shkollës/organizatës rinore.** Puna jashtë shkollës ose organizatës rinore ofron një mundësi të re për mësim dhe praktikë të aftësive që fëmijët/të rinjtë nuk do t'i përjetonin ndryshe. Ata praktikojnë transferimin e njohurive dhe aftësive nga "hapesira e mbrojtur" e shkollës në "jetën reale". Ky angazhim u mundëson atyre të bëjnë një kontribut të vërtetë në shoqëri. Kjo i lejon ata të përjetojnë kuptimin e të mësuarit dhe veprimeve të tyre.

Dhe: Fëmijët/të rinjtë vijnë në kontakt me njerëz që përndryshe mund të mos i takonin kurrë (p.sh., klasa të ndryshme shoqërore, fe, etni). Kontakte të tilla ndihmojnë në ndërtimin e urave brenda shoqërisë dhe zhvillimin e kapitalit social. Për më tepër, ekspertiza e jashtme nga komuniteti ose shoqëria përdoret për të pasuruar mësimin. Shkolla ose organizata rinore në tërësi mund të përfitojë gjithashtu nga bashkëpunimi me partnerë të jashtëm sepse Vullnetarizmi Edukativ ka të bëjë gjithmonë me hapjen e shkollës/organizatës rinore, me zhvillimin drejt një "shkolle në komunitet" ose "organizatës rinore proaktive".

5. **Fëmijët/të rinjtë janë aktivisht të përfshirë në planifikimin e projektit dhe dizajnimin e aktiviteteve të Vullnetarizmit Edukativ.** Vullnetarizmi Edukativ nuk duhet të jetë vetëm një aktivitet ku fëmijët/të rinjtë bëjnë atë që u urdhërojnë mësuesit ose udhëheqësit rinorë. Ata duhet të kenë një "zë" të vërtetë dhe mund të ndikojnë në planifikimin, ekzekutimin dhe vlerësimin e projektit. Kjo rrit motivimin dhe ndjenjën e angazhimit të fëmijëve/të rinjve. Fëmijët/të rinjtë e bëjnë projektin me të vërtetë të tyre ("pronësinë") dhe praktikojnë të folurit dhe vendimmarrjen demokratike në grupet e klasës/të rinjve. Fëmijët/të rinjtë inkurajohen të gjejnë projektet e tyre dhe të marrin përsipër sa më shumë përgjegjësi. Hulumtimi i situatave problematike dhe zbulimi i projekteve që vlejnë është në thelb të Vullnetarizmit Edukativ. Vetëvendosja dhe marrja e përgjegjësisë janë thelbësore për zhvillimin personal dhe suksesin e të mësuarit në projekt.

## Hetuesit e Standardeve të Cilësisë

**Kohëzgjatja:** 90 minuta

**Përshkrimi:** Pjesëmarrësit do të vlerësojnë në mënyrë kritike projektet e kaluara të Vullnetarizmit Edukativ duke aplikuar Standardet e përcaktuara të Vullnetarizmit Edukativ.

### Udhëzime Hapi-për-Hap:

1. Informoni pjesëmarrësit se do të punojnë në grupe të vogla për të shqyrtuar dhe vlerësuar shembuj të vërtetë të projekteve të mëparshme të Vullnetarizmit Edukativ. Secili grup do të marrë përshkrime të detajuara që përfshijnë informacion mbi objektivat, zbatimin, rezultatet dhe reagimet nga pjesëmarrësit dhe komuniteti.
2. Shpjegoni shkurtimisht qëllimin e aktivitetit të vlerësimit dhe si ai lidhet me Standartet e Vullnetarizmit Edukativ. Informoni ata se do të kemi dy sesione për vlerësimin e projekteve: një

do të jetë për projektet e zbatuara nga grupe/klube jo-formale dhe një tjetër për ato të shkollave.

3. Përsëritni standardet e cilësisë dhe sigurohuni që pjesëmarrësit të kuptojnë secilin nga ato dhe si mund të përdoren si kritere vlerësimi për projektet. Shpjegoni formularin e vlerësimit dhe sigurohuni që ata të kuptojnë çdo pjesë të tij.
4. Jepini çdo grupi dy projekte të Vullnetarizmit Edukativ.
5. Grupet do të diskutojnë se sa mirë ka përbushur secili projekt secilin standard, do të identifikojë pikat e forta dhe dobësitë e tij dhe do të sugjerojë përmirësime për projektet e ardhshme.
6. Thuajuni pjesëmarrësit që të mbajnë shënime për diskutimet e tyre, pasi do të shqyrtojmë ato në një sesion të veçantë më pas.

**Materiale të Nevojshme:**

- Fletushkë: FLETUSHKË - Matriks Vlerësimi i Standardeve të Cilësisë për Vullnetarizmin Edukativ
- Projekte të shtypura të Vullnetarizmit Edukativ
- Stilolapsa

**Fletushkë Matrica e Vlerësimit të Standardeve të Cilësisë**

STANDARDI		Përshkrimi
1.VULLNETARIZM I KUPTIMPLOTË	Nxënësit do të angazhohen në aktivitete vullnetare domethënëse dhe të rëndësishme duke:	



	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Marrur pjesë në përvoja që janë të përshtatshme për moshën dhe aftësitë zhvillimore.</li> <li>2. Zhvilluar një kuptim të perspektivave dhe zgjidhjeve të mundshme për çështjet shoqërore dhe/ose mjedisore.</li> <li>3. U angazhuan në qasjen e Vullnetarizmit Edukativ për të adresuar nevojat dhe çështjet reale.</li> <li>4. Adresuar çështjet që janë personalisht të rëndësishme.</li> <li>5. Demonstruar përgjegjësinë qytetare si një qytetar global personalisht i përgjegjshëm.</li> </ol> <p>Pyetjet kryesore:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Sa efektivisht po i kuptojnë vullnetarët perspektivat e ndryshme dhe po zhvillojnë zgjidhje të mundshme për çështjet shoqërore ose mjedisore?</li> <li>2. A trajtojnë në mënyrë efektive projektet e Vullnetarizmit Edukativ në komunitet nevojat dhe çështjet reale të komunitetit?</li> <li>3. Deri në çfarë mase vlerësohen aktivitetet vullnetare nga komuniteti?</li> <li>4. Sa të rëndësishme janë personalisht çështjet që trajtohen nga nxënësit?</li> </ol>	
<p>2. NDËRLIDHJA ME KURRIKULËN</p>	<p>Mësimdhënsit do të përdorin qëllimisht aktivitetet vullnetare si një strategji udhëzuese për të përmbushur qëllimet e të mësuarit dhe/ose standardet duke:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Artikuluar qëllimet dhe pritshmëritë nga Vullnetarizmi Edukativ.</li> <li>2. Krijuar lidhje mes asaj që mësohet në klasa dhe asaj që nxënësit mësojnë në Vullnetarizmin Edukativ.</li> <li>3. Lehtësuar transferimin e njohurive dhe aftësive nga një mjedis (kontekst) në tjetrin.</li> </ol> <p>Pyetjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. A janë në gjendje nxënësit të krijojnë lidhje ndërmjet mësimin në klasë dhe përvojave të tyre në Vullnetarizmin Edukativ?</li> <li>2. Sa qartë janë të artikuluar nga mësimdhënsit synimet dhe pritshmëritë e të nxënësve në Vullnetarizmin Edukativ?</li> </ol>	

	<p>3. Sa efektivisht po i transferojnë nxënësit njohuritë dhe aftësitë nga Vullnetarizmi Edukativ në kontekste të tjera?</p>	
<p>3. ZËRI I TË RINJVE</p>	<p>Nxënësit do te avokojne dhe ngrisin zërin e tyre duke:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Demonstruar shkathtësitë efektive me shkrim, verbale dhe teknologjike në komunikimin e të gjitha fazave të një projekti me akterë të ndryshëm.</li> <li>2. Gjeneruar idetë gjatë proceseve të planifikimit, zbatimit dhe vlerësimit.</li> <li>3. Angazhuar në proceset vendimmarrëse përgjatë përvojave të Vullnetarizmit Edukativ.</li> <li>4. Krijuar një mjedis mbështetës që mbështet shprehjen e hapur të ideve.</li> <li>5. Demonstruar aftësitë për të zhvilluar plotësisht një projekt të Vullnetarizmit Edukativ që përmbush qëllimet e të nxënit të nxënësve dhe komunitetit.</li> </ol> <p>Pyetjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Në çfarë mase përfshihen nxënësit në gjenerimin e ideve gjatë fazave të planifikimit, zbatimit dhe vlerësimit të projektit të Vullnetarizmit Edukativ?</li> <li>2. Sa aktivisht janë të përfshirë nxënësit në proceset vendimmarrëse gjatë përvojave të tyre në projektet e Vullnetarizmit Edukativ?</li> <li>3. Sa mirë demonstrojnë nxënësit aftësi komunikimi efektive (të shkruara, verbale dhe teknologjike) me akterë të ndryshëm gjatë projektit?</li> <li>4. A është mjedisi mbështetës për të shprehur nxënësit hapur idetë e tyre?</li> <li>5. Sa me sukses janë nxënësit duke zhvilluar projekte të Vullnetarizmit Edukativ që përmbushin qëllimet e të nxënit të nxënësve dhe nevojat e komunitetit?</li> </ol>	

<p>4. REFLEKTIMI</p>	<p>Nxënësit do të kryejnë reflektim dhe vlerësim të vazhdueshëm që kërkon mendim dhe analizë të thellë duke:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Demonstruar të kuptuarit e njohurive, aftësive dhe/ose qëndrimeve përmes një sërë reflektimesh verbale, të shkruara, artistike dhe joverbale.</li> <li>2. Reflektuar përvojat para, gjatë dhe pas projektit të Vullnetarizmit Edukativ për të thelluar të mësuarit dhe të kuptuarit.</li> <li>3. Menduar thellësisht dhe në mënyrë kritike për problemet komplekse të komunitetit dhe zgjidhjet alternative.</li> <li>4. Vetë-vlerësuar pikat e forta dhe të dobëta të tyre dhe strategjinë për mënyrat për të mbështetur përmirësimin e vazhdueshëm.</li> <li>5. Ekzaminuar një sërë çështjesh sociale, mjedisore dhe qytetare për të kuptuar lidhjet me politikën, procedurat dhe normat publike.</li> <li>6. Vlerësuar besueshmërinë e një sërë burimesh kërkimore për të kuptuar më thellë çështjet sociale dhe mjedisore.</li> </ol> <p>Pyetjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. A po reflektojnë nxënësit përvojat para, gjatë dhe pas projektit të Vullnetarizmit Edukativ për të thelluar të mësuarit dhe të kuptuarit e tyre?</li> <li>2. Sa mirë po demonstrojnë nxënësit të kuptuarit e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve përmes formave të ndryshme të reflektimit (verbal, me shkrim, artistik, joverbal)?</li> <li>3. Sa thellë dhe në mënyrë kritike po mendojnë nxënësit për problemet komplekse të komunitetit dhe zgjidhjet alternative?</li> <li>4. A po vetëvlerësojnë nxënësit në mënyrë efektive pikat e forta dhe të dobëta të tyre dhe a po hartojnë strategji për përmirësim të vazhdueshëm?</li> </ol>	
<p>5. PËRFSHIRJA DHE PARTNERETET E KOMUNITETIT</p>	<p>Përfshirja e komunitetit tuaj lokal dhe bashkëpunimi drejtpërdrejt me ta jo vetëm që angazhon anëtarët e komunitetit për të ndihmuar me projektin, por siguron që rezultati përfundimtar t'i përgjigjet nevojave aktuale të komunitetit.</p>	

	<p>Mësuesit dhe, sipas rastit nxënësit do të krijojnë partneritete të cilat janë bashkëpunuese, të dobishme dhe adresojnë nevojat e komunitetit duke:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përfshirë një sërë partnerësh për të adresuar nevojat e komunitetit.</li> <li>2. Bashkëpunuar në krijimin e një vizioni të përbashkët dhe qëllimeve të përbashkëta për të adresuar nevojat e komunitetit.</li> <li>3. Bashkëpunuar në zhvillimin dhe zbatimin e planeve të veprimit për të përmbushur qëllimet specifike.</li> <li>4. Vazhduar zhvillimin e cilësisë dhe efektivitetit të partneritetit.</li> </ol> <p>Pyetjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Sa i rregullt dhe efektiv është komunikimi ndërmjet partnerëve për t'i mbajtur ata të informuar për aktivitetet dhe progresin e projekteve?</li> <li>2. A janë partneritetet bashkëpunuese, të dobishme dhe që adresojnë nevojat e komunitetit?</li> <li>3. Sa mirë po bashkëpunojnë partnerët në krijimin e një vizioni të përbashkët dhe qëllimeve të përbashkëta?</li> <li>4. Sa efektivisht po bashkëpunojnë partnerët në zhvillimin dhe zbatimin e planeve të veprimit për të përmbushur qëllimet specifike?</li> <li>5. Sa të angazhuar janë mësuesit dhe nxënësit të përfshijnë një sërë partnerësh për të adresuar nevojat e komunitetit?</li> </ol>	
--	--	--

## Dhoma e Enigmave të Standardeve

**Kohëzgjatja:** 60 minuta

**Përshkrimi:** Ky aktivitet është vazhdim i aktivitetit "Hetuesit e Standardeve të Cilësisë" dhe angazhon pjesëmarrësit në aktivitete lojëra-probleme që forcojnë kuptimin e Standardeve të Cilësisë së Vullnetarizmit Edukativ. Ai mund të bëhet edhe veçmas.

Pjesëmarrësit janë pjesë e një ekipi të Vullnetarizmit Edukativ që duhet të zgjidhin enigma të lidhura me standardet e cilësisë të Vullnetarizmit Edukativ për të hapur një arkë thesari që përmban "Çelësin për Mësimdhënje Kuptimplotë." Çdo enigmë i përkon një standarti të ndryshëm, dhe zgjidhja e të gjitha enigmave do t'i ndihmojë ata të "arratisen" dhe të hapin thesarin.

### **Udhëzime hap pas hapi:**

1. Krijoni enigmat dhe sfidat të lidhura me standartet e cilësisë. Këto duhet të përfshijnë enigma, enigma logjike dhe detyra që kërkojnë aplikimin e standarteve në skenarë hipotetikë.
2. Zgjidhni një temë për dhomën e arratisjes që lidhet me Vullnetarizmin Edukativ, si “Shpëtoni Projektin e Komunitetit” ose “Zhblllokoni Standartet e Cilësisë”, për të shtuar lidhshmërinë dhe angazhimin.
3. Sigurohuni që secila zgjidhje enigme të çojë në të ardhmen, duke kulmuar në "arratisjen" përfundimtare.
4. Ndani pjesëmarrësit në grupe të vogla, duke theksuar natyrën bashkëpunuese të dhomës së arratisjes.
5. Jepni një përmbledhje grupit mbi temën dhe historinë e dhomës së arratisjes. Shpjegoni se ata duhet të aplikojnë njohuritë e tyre të standardeve të cilësisë për të zgjidhur enigmën dhe “shpëtuar” projektin.
6. Grupi punon përmes enigmave, me secilën sfidë të zgjidhur që tregon të dhënat për enigmën e ardhshme. Për shembull, zgjidhja e një enigme mbi caktimin e objektivave të matshme mund të hapë një kod për një kuti të mbyllur që përmban detyrën e ardhshme.
7. Inkurajoni mendimin krijues dhe aplikimin e koncepteve të mësuara. Enigmat duhet të jenë të dizajnuara për të aplikuar në praktikë standartet.
8. Caktoni një kufi kohor për të shtuar urgjencë dhe për të simuluar presionet e menaxhimit të projekteve në botën reale.
9. Pas përfundimit të dhomës së arratisjes (ose pas mbarimit të kohës), mbani një diskutim me të gjithë pjesëmarrësit.
10. Rishikoni secilën enigmë dhe lidhjen e saj me standartet e cilësisë, duke theksuar aplikimet e sakta dhe ndikimin e tyre në zgjidhjen e dhomës së arratisjes. Po ashtu, si ndihmoi kjo në suksesin e dhomës së arratisjes.
11. Ftoni pjesëmarrësit të ndajnë mendimet e tyre mbi mënyrën se si aktiviteti i ndihmoi ata të kuptonin rëndësinë e aplikimit të standarteve të cilësisë në projekte të vërteta Vullnetarizmi Edukativ.

### **Materiallet:**

- Kutia/Zarfa
- Çelësa ose drynë me kod
- Orë matëse
- Stilolapsa
- Fletë A4
- Fletushkë me enigma të printuara

## Standardet e Cilësisë – Jigsaw

**Kohëzgjatja:** 30 minuta

**Përshkrimi:** Në këtë aktivitet, pjesëmarrësit do të përqendrohen te standardet e cilësisë për praktikën e suksesshme të Vullnetarizmit Edukativ për të kontrolluar qëndrimet e tyre ndaj komponentëve të rëndësishëm të projekteve të Vullnetarizmit Edukativ. Aktiviteti do të sigurojë një analizë të thellë për sa është e rëndësishme për pjesëmarrësit të mësojnë ose të lehtësojnë punën e tyre me fëmijët ose të rinjtë.

### **Udhëzime:**

1. Jepni një pasqyrë të shkurtër se cilat janë standardet e cilësisë për praktikën e suksesshme të Vullnetarizmit Edukativ, pse janë të rëndësishme dhe cilat standarde të cilësisë janë të rëndësishme për projektet e Vullnetarizmit Edukativ. Kjo mund të bëhet në formën e një prezantimi me ose pa përdorur një prezantim PowerPoint.
2. Pjesëmarrësit duhet të ndahen në grupe. Idealja është të formohen 5 grupe, secili për të punuar mbi një nga 5 standardet e cilësisë. Në rast se ka më shumë grupe, mund t'i jepni të njëjtin standard cilësie dy ose më shumë grupeve për ta diskutuar. Nëse grupi i trajnimit është më i vogël, mund të formohen çifte ose grupe prej tre vetësh për të mbuluar të gjitha standardet.
3. Ndajini fletushkën me çdo grup dhe udhëzoni ata të:
  - Lexojnë përmbajtjen e fletushkës
  - Mendojnë individualisht: çfarë është e rëndësishme për mua në lidhje me përmbajtjen e fletushkës dhe çfarë përfitimesh do të kenë fëmijët/të rinjtë nëse ky standard plotësohet në projektin e Vullnetarizmit Edukativ, cilat pyetje lindin gjatë leximit të fletushkës së standardeve.
  - Në grup: ndani përgjigjet tuaja individuale dhe përgatitni një prezantim të përbashkët grupi.
4. Pas kësaj, në seancën plenare, çdo grup do të ndajë punën e tij: prezantoni/lexoni standardin, prezantoni çfarë është e rëndësishme, përfitimet për fëmijët/të rinjtë dhe pyetjet që janë ngritur.
5. Në fund, trajneri bën përfundimin duke pasur parasysh të gjitha prezantimet.

### **Materialet e Nevojshme:**

- Fletë palosëse
- Markera
- Fletushka Standardet e Cilësisë për Vullnetarizmin Edukativ

## **Fletushkë – Standardet e Cilësisë për Vullnetarizmin Edukativ**

### **1. Angazhimi i fëmijëve/të rinjve i përgjigjet një nevoje reale ose problemi të vërtetë në mjedisin e komunitetit.**

Fëmijët/të rinjtë janë të përfshirë në përzgjedhjen dhe planifikimin e angazhimit të tyre dhe marrin përsipër një detyrë kuptimplotë dhe të dobishme. Vullnetarizmi Edukativ fillon kur fëmijët/të rinjtë përfshihen. Kur ata ndiejnë se njohuritë dhe aftësitë e tyre janë vërtet të nevojshme dhe mund të kontribuojnë në diçka të rëndësishme, ata përjetojnë vetëefikasitet. Aktivitetet sfiduese krijojnë kuriozitet, motivim dhe shumë tema diskutimi që mund të zhvillohen në shkollë ose organizatë. Përkundrazi, një aktivitet i mërzitshëm dhe pa kuptim mund të çojë në demotivim dhe refuzimin e projektit. Gjetja e nevojës reale së bashku gjatë një faze kërkimore duhet të jetë pjesë e çdo projekti. Është e rëndësishme që fëmijët/të rinjtë të marrin përsipër një detyrë ku mund të kontribuojnë me pikat e tyre të forta dhe interesat dhe për këtë arsye ta kuptojnë atë si "detyrën e tyre". Kjo parandalon që ata të perceptohen si "praktikantët e dhjetë" ose madje të shihen si një ngarkesë ("gur në qafë").

---

### **2. Projektet janë pjesë e mësimëve dhe/ose janë të lidhura me përmbajtjen e kurrikulës.**

Një qëllim thelbësor i Vullnetarizmit Edukativ është që fëmijët/të rinjtë të përjetojnë aplikueshmëri praktike të njohurive akademike. Dhe përkundrazi, që ata të mund të pasurojnë mësimet me përvojat e tyre. Kjo e vë njohurinë të mësuar në shkollë ose organizatë në kontekst. Për të përdorur fjalët e John Dewey-t, ajo kthehet nga "njohuri të rikuperueshme" në "njohuri të kuptuara" që mund të aplikohen në situata të tjera. Lidhja e ngushtë midis mësimin kognitiv dhe social, në mënyrë që të dyja të përfitojnë nga njëra-tjetra, është karakteristikë e Vullnetarizmit Edukativ. Lidhja me lëndët e mësimin ose me kurrikulat e arsimit jo-formal është gjithashtu e rëndësishme për të arritur fëmijët/të rinjtë që nuk do të angazhoheshin vullnetarisht jashtë shkollës ose organizatës. Me anë të Vullnetarizmit Edukativ, mësimi bëhet më i gjallë dhe i orientuar drejt veprimit.

---

### **3. Ka një reflektim të rregullt dhe të planifikuar mbi përvojat e fëmijëve/të rinjve.**

Reflektimi është LIDHJA që lidh përvojat personale të angazhimit dhe mësimin akademik në shkollë ose organizatën rinore. Reflektimi ndihmon për të kuptuar dhe lidhur përvojat, forcimin e aftësive metakognitive dhe zhvillimin e kompetencave për zgjidhje komplekse të problemeve. Të menduarit për kontekstin dhe kuptimin e përvojës vetjake, i udhëhequr nga pyetje të synuara, u'a bën të qartë qëllimin e angazhimit fëmijëve/të rinjve. Pikat e forta dhe të dobëta personale bëhen më të qarta, transferimi i njohurive të lëndës lehtësohet dhe kompetencat metakognitive (p.sh., zgjidhja komplekse e problemeve, menaxhimi i proceseve të të mësuarit).

---

### **4. Angazhimi praktik i fëmijëve/të rinjve ndodh jashtë shkollës/organizatës rinore.**

Puna jashtë shkollës ose organizatës rinore ofron një mundësi të re për mësim dhe praktikë të aftësive që fëmijët/të rinjtë nuk do t'i përjetonin ndryshe. Ata praktikojnë transferimin e njohurive dhe aftësive nga "hapesira e mbrojtur" e shkollës në "jetën reale". Ky angazhim u mundëson atyre të bëjnë një kontribut të vërtetë në shoqëri. Kjo i lejon ata të përjetojnë kuptimin e të mësuarit dhe veprimeve të tyre.

Dhe: Fëmijët/të rinjtë vijnë në kontakt me njerëz që përndryshe mund të mos i takonin kurrë (p.sh., klasa të ndryshme shoqërore, fe, etni). Kontakte të tilla ndihmojnë në ndërtimin e urave brenda shoqërisë dhe zhvillimin e kapitalit social. Për më tepër, ekspertiza e jashtme nga komuniteti ose shoqëria përdoret për të pasuruar mësimin. Shkolla ose organizata rinore në tërësi mund të përfitojë gjithashtu nga bashkëpunimi me partnerë të jashtëm sepse Vullnetarizmi Edukativ ka të bëjë gjithmonë me hapjen e shkollës/organizatës rinore me zhvillimin drejt një "shkolle në komunitet" ose "organizatës rinore proaktive".

---

#### **5. Fëmijët/të rinjtë janë aktivisht të përfshirë në planifikimin e projektit dhe dizajnimin e aktiviteteve të Vullnetarizmit Edukativ.**

Vullnetarizmi Edukativ nuk duhet të jetë vetëm një aktivitet ku fëmijët/të rinjtë bëjnë atë që u urdhërojnë mësuesit ose udhëheqësit rinorë. Ata duhet të kenë një "zë" të vërtetë dhe mund të ndikojnë në planifikimin, ekzekutimin dhe vlerësimin e projektit. Kjo rrit motivimin dhe ndjenjën e angazhimit të fëmijëve/të rinjve. Fëmijët/të rinjtë e bëjnë projektin me të vërtetë të tyre ("pronësinë") dhe praktikojnë të folurit dhe vendimmarrjen demokratike në grupet e klasës/të rinjve. Fëmijët/të rinjtë inkurajohen të gjejnë projektet e tyre dhe të marrin përsipër sa më shumë përgjegjësi. Hulumtimi i situatave problematike dhe zbulimi i projekteve që vlejnë është në thelb të Vullnetarizmit Edukativ. Vetëvendosja dhe marrja e përgjegjësisë janë thelbësore për zhvillimin personal dhe suksesin e të mësuarit në projekt.



## **Udhëzime për zbatimin cilësor të Vullnetarizmit Edukativ**

**Koha:** 40 minuta

**Përshkrimi:** Standardet e cilësisë për Vullnetarizmin Edukativ janë udhëzime për projekte të suksesshme Vullnetarizmi Edukativ. Çdo standard përfaqëson një fushë cilësie dhe tregon një proces ose rezultat thelbësor që duhet të ndodh gjatë zbatimit të Vullnetarizmit Edukativ. Ky ushtrim i ndihmon pjesëmarrësit të vlerësojnë praktikën e tyre të Vullnetarizmit Edukativ para se të fillojë ose pasi të përfundojë projekti.

### **Udhëzime:**

Pjesëmarrësit në çifte (përfaqësues nga e njëjta shkollë ose organizatë rinore) vlerësojnë projektin e tyre të Vullnetarizmit Edukativ duke përdorur fletushkën Matrica e Vlerësimit të Standardeve të Cilësisë. Ata duhet të kenë projektin e tyre të Vullnetarizmit Edukativ (ose një përmbledhje të projektit ose projekt të detajuar) dhe përmes diskutimit të plotësojnë kolonën Përshkrimi. Pyetjet përqendrohen në një fushë të caktuar cilësore të Vullnetarizmit Edukativ. Ky hap mund të zgjasë deri në 20 - 25 minuta. Pyetjet në kolonën Standardet janë në kohën e shkuar por mund të përdoren gjatë formulimit të praktikës së Vullnetarizmit Edukativ.

Pas punës në grupe pjesëmarrësit mund të ndajnë të dhënat e matiksës ose të kenë një përmbledhje të përgjithshme të mësimëve që kanë nxjerrë nga aktiviteti.

### **Materialet e Nevojshme:**

- Projekt i zhvilluar i Vullnetarizmit Edukativ nga pjesëmarrësit
- Matrica e Vlerësimit të Standardeve të Cilësisë
- Stilolapsa

STANDARDI		Përshkrimi
<p>1.VULLNETARIZMI KUPTIMPLOTË</p>	<p>Nxënësit do të angazhohen në aktivitete vullnetare domethënëse dhe të rëndësishme duke:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>6. Marrur pjesë në përvoja që janë të përshtatshme për moshën dhe aftësitë zhvillimore.</li> <li>7. Zhvilluar një kuptim të perspektivave dhe zgjidhjeve të mundshme për çështjet shoqërore dhe/ose mjedisore.</li> <li>8. Angazhuar në qasjen e Vullnetarizmit Edukativ për të adresuar nevojat dhe çështjet reale.</li> <li>9. Adresuar çështjet që janë personalisht të rëndësishme.</li> <li>10. Demonstruar përgjegjësinë qytetare si një qytetar global personalisht i përgjegjshëm.</li> </ol> <p>Pyetjet kryesore:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>5. Sa efektive po i kuptojnë vullnetarët perspektivat e ndryshme dhe po zhvillojnë zgjidhje të mundshme për çështjet shoqërore ose mjedisore?</li> <li>6. A trajtojnë në mënyrë efektive projektet e Vullnetarizmit Edukativ në komunitet nevojat dhe çështjet reale të komunitetit?</li> <li>7. Deri në çfarë mase vlerësohen aktivitetet vullnetare nga komuniteti?</li> <li>8. Sa të rëndësishme janë personalisht çështjet që trajtohen nga nxënësit?</li> </ol>	
<p>2. NDËRLIDHJEME KURRIKULËN</p>	<p>Mësimdhënësit do të përdorin qëllimisht aktivitetet vullnetare si një strategji udhëzuese për të përmbushur qëllimet e të mësuarit dhe/ose standardet duke:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>4. Artikuluar qëllimet dhe pritshmëritë nga Vullnetarizmi Edukativ.</li> <li>5. Krijuar lidhje mes asaj që mësohet në klasë dhe asaj që nxënësit mësojnë në Vullnetarizmin Edukativ.</li> <li>6. Lehtësuar transferimin e njohurive dhe aftësive nga një mjedis (kontekst) në tjetrin.</li> </ol> <p>Pyetjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>4. A janë në gjendje nxënësit të krijojnë lidhje ndërmjet mësimin në klasë dhe përvojave të tyre në Vullnetarizmin Edukativ?</li> </ol>	

	<ol style="list-style-type: none"> <li>5. Sa qartë janë të artikuluar nga mësimdhënësit synimet dhe pritshmëritë e të nxënit në Vullnetarizmin Edukativ?</li> <li>6. Sa efektivisht po i transferojnë nxënësit njohuritë dhe aftësitë nga Vullnetarizmi Edukativ në kontekste të tjera?</li> </ol>	
<p>3. ZËRI I TË RINJVE</p>	<p>Nxënësit do të avokojnë dhe ngrisin zërin e tyre duke:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>6. Demonstruar shkathtësitë efektive me shkrim, verbale dhe teknologjike në komunikimin e të gjitha fazave të një projekti me akterë të ndryshëm.</li> <li>7. Gjeneruar idetë gjatë proceseve të planifikimit, zbatimit dhe vlerësimit.</li> <li>8. Angazhuar në proceset vendimmarrëse përgjatë përvojave të Vullnetarizmit Edukativ.</li> <li>9. Krijuar një mjedis mbështetës që mbështet shprehjen e hapur të ideve.</li> <li>10. Demonstruar aftësitë për të zhvilluar plotësisht një projekt të Vullnetarizmit Edukativ që përmbush qëllimet e të nxënit të nxënësve dhe komunitetit.</li> </ol> <p>Pyetjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>6. Në çfarë mase përfshihen nxënësit në gjenerimin e ideve gjatë fazave të planifikimit, zbatimit dhe vlerësimit të projektit të Vullnetarizmit Edukativ?</li> <li>7. Sa aktivisht janë të përfshirë nxënësit në proceset vendimmarrëse gjatë përvojave të tyre në projektet e Vullnetarizmit Edukativ?</li> <li>8. Sa mirë demonstrojnë nxënësit aftësi komunikimi efektive (të shkruara, verbale dhe teknologjike) me akterë të ndryshëm gjatë projektit?</li> <li>9. A është mjedisi mbështetës për të shprehur nxënësit hapur idetë e tyre?</li> <li>10. Sa me sukses janë nxënësit duke zhvilluar projekte të Vullnetarizmit Edukativ që përmbushin qëllimet e të nxënit të nxënësve dhe nevojat e komunitetit?</li> </ol>	

<p>4. REFLEKTIMI</p>	<p>Nxënësit do të kryejnë reflektim dhe vlerësim të vazhdueshëm që kërkon mendim dhe analizë të thellë duke:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>7. Demonstruar të kuptuarit e njohurive, aftësive dhe/ose qëndrimeve përmes një sërë reflektimesh verbale, të shkruara, artistike dhe joverbale.</li> <li>8. Reflektuar përvojat para, gjatë dhe pas projektit të Vullnetarizmit Edukativ për të thelluar të mësuarit dhe të kuptuarit.</li> <li>9. Menduar thellësisht dhe në mënyrë kritike për problemet komplekse të komunitetit dhe zgjidhjet alternative.</li> <li>10. Vetë-vlerësuar pikat e forta dhe të dobëta të tyre dhe strategjinë për mënyrat për të mbështetur përmirësimin e vazhdueshëm.</li> <li>11. Ekzaminuar një sërë çështjesh sociale, mjedisore dhe qytetare për të kuptuar lidhjet me politikën, procedurat dhe normat publike.</li> <li>12. Vlerësuar besueshmërinë e një sërë burimesh kërkimore për të kuptuar më thellë çështjet sociale dhe mjedisore.</li> </ol> <p>Pyetjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>5. A po reflektojnë nxënësit përvojat para, gjatë dhe pas projektit të Vullnetarizmit Edukativ për të thelluar të mësuarit dhe të kuptuarit e tyre?</li> <li>6. Sa mirë po demonstrojnë nxënësit të kuptuarit e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve përmes formave të ndryshme të reflektimit (verbal, me shkrim, artistik, joverbal)?</li> <li>7. Sa thellë dhe në mënyrë kritike po mendojnë nxënësit për problemet komplekse të komunitetit dhe zgjidhjet alternative?</li> <li>8. A po vetëvlerësojnë nxënësit në mënyrë efektive pikat e forta dhe të dobëta të tyre dhe a po hartojnë strategji për përmirësim të vazhdueshëm?</li> </ol>	
<p>5. PËRFSHIRJA DHE PARTNERETET E KOMUNITETIT</p>	<p>Përfshirja e komunitetit tuaj lokal dhe bashkëpunimi drejtpërdrejt me ta jo vetëm që angazhon anëtarët e komunitetit për të ndihmuar me projektin, por siguron që rezultati përfundimtar t'i përgjigjet nevojave aktuale të komunitetit.</p> <p>Mësuesit dhe sipas rastit, nxënësit do të krijojnë partneritete të cilat janë bashkëpunuese, të dobishme dhe adresojnë nevojat e komunitetit duke:</p>	

5. Përfshirë një sërë partnerësh për të adresuar nevojat e komunitetit.
6. Bashkëpunuar në krijimin e një vizioni të përbashkët dhe qëllimeve të përbashkëta për të adresuar nevojat e komunitetit.
7. Bashkëpunuar në zhvillimin dhe zbatimin e planeve të veprimit për të përmbushur qëllimet specifike.
8. Vazhduar zhvillimin e cilësisë dhe efektivitetit të partneritetit.

Pyetjet:

6. Sa i rregullt dhe efektiv është komunikimi ndërmjet partnerëve për t'i mbajtur ata të informuar për aktivitetet dhe progresin e projekteve?
7. A janë partneritetet bashkëpunuese, të dobishme dhe që adresojnë nevojat e komunitetit?
8. Sa mirë po bashkëpunojnë partnerët në krijimin e një vizioni të përbashkët dhe qëllimeve të përbashkëta?
9. Sa efektivisht po bashkëpunojnë partnerët në zhvillimin dhe zbatimin e planeve të veprimit për të përmbushur qëllimet specifike?
10. Sa të angazhuar janë mësime dhe nxënës të përfshijnë një sërë partnerësh për të adresuar nevojat e komunitetit?

## Një Yll Publik me Projektin e Vullnetarizmit Edukativ

**Kohëzgjatja:** 45 minuta

### **Përshkrimi:**

Në këtë aktivitet, pjesëmarrësit do të reflektojnë mbi momentet kyçe të projekteve të tyre personale të vullnetarizmit edukativ dhe do të planifikojnë se si t'i komunikojnë dhe promovojnë këto momente tek palët përkatëse të interesuara. Ushtrimi fokusohet në identifikimin dhe organizimin e momenteve kyçe të projektit duke marrë parasysh audiencën e mesazhit, format dhe transmetuesin.

### **Udhëzime:**

1. Filloni duke ftuar pjesëmarrësit të reflektojnë individualisht mbi projektet e tyre personale të vullnetarizmit edukativ që kanë punuar.
2. Jepni secilit pjesëmarrës një tabelë të printuar që përmban katër pyetje kyçe:
  - Çfarë? (Momentet kyçe të projektit të vullnetarizmit edukativ)
  - Për kë? (Palët specifike të interesuara për t'u komunikuar)
  - Si? (Forma dhe kanali i komunikimit, si për shembull gojarisht, me shkrim, ose video)
  - Kush? (Persona përgjegjës për përcjelljen e mesazhit)
3. Shpenzoni 5 minuta për të shpjeguar secilën pyetje:
  - "Çfarë?" i referohet momenteve kyçe në projekt që duhet të komunikohen.
  - "Për kë?" i referohet palëve të interesuara (persona, grupe, etj.) që duhet të informohen.
  - "Si?" i referohet formës së mesazhit dhe mënyrës se si do të dërgohet.
  - "Kush?" i referohet personit nga ekipi i projektit që është përgjegjës për dërgimin e mesazhit.
4. Jepni 10 minuta për të reflektuar dhe plotësuar tabelën sipas projekteve të tyre.
5. Pasi të kenë përfunduar tabelën, ndani pjesëmarrësit në grupe nga 4 persona. Kërkoni që ata të ndajnë momentet kyçe (Çfarë?) dhe të diskutojnë si do t'i komunikojnë këto momente tek palët e interesuara (Për kë? dhe Si?). Jepni 20 minuta për diskutimin në grup.
6. Pas diskutimit në grup, mblidhni të gjithë pjesëmarrësit dhe udhëheqësi i aktivitetit do t'i kërkojë pjesëmarrësve të ndajnë momentet kyçe që kanë identifikuar dhe t'i shkruajnë ato në një tabelë të madhe në rend kronologjik. Udhëheqësi duhet të ndihmojë në identifikimin e pikave të përbashkëta që duhet të komunikohen në çdo projekt dhe të diskutojë çdo pikë të munguar.
7. Nëse ka boshllëqe në përgjigjet e grupeve, pyetni nëse ata do të donin të shtonin ndonjë detaj tjetër.

### **Pyetje Reflektimi:**

- Çfarë bëre?
- Si shkoi?
- Pse është e rëndësishme promovimi?
- Çfarë mësove nga të tjerët gjatë ndarjes?

- Çfarë ishte e vështirë? Çfarë informacioni po të mungon ende?

Pas reflektimit, udhëheqësi i aktivitetit do të sqarojë çdo dilemë dhe do të theksojë rëndësinë e momenteve kyçe në projektet e vullnetarizmit edukativ, si fazat e mbylljes dhe festimeve.

### **Materialet e Nevojshme:**

- Fletë për flipchart
- Markera
- Fletushka me tabela të shtypura për secilin pjesëmarrës

### **Vlerësimi në Vullnetarizmin Edukativ**

**Kohëzgjatja:** 30 minuta

#### **Përshkrimi:**

Ky aktivitet prezanton konceptin e vlerësimit në projektet e vullnetarizmit edukativ duke udhëhequr pjesëmarrësit në një ushtrim që eksploron kriteret për vlerësimin e suksesit dhe metodat e ndryshme të vlerësimit. Ushtrimi fillon me një aktivitet të thjeshtë krahasimi, i pasuar nga një diskutim grupor mbi konceptet dhe metodat e vlerësimit dhe mbyllet me një ushtrim praktik ku pjesëmarrësit planifikojnë vlerësimin për projektet e tyre të vullnetarizmit edukativ.

#### **Udhëzime:**

1. Filloni sesionin duke kërkuar dy vullnetarë për të marrë pjesë në një ushtrim të shkurtër të quajtur "Një lule".
2. Përdorni një fletë të bardhë për flipchart ku të dy vullnetarët do të vizatojnë një lule. Udhëzoni ata që të vizatojnë lulet më të bukura që mund të bëjnë. Jepni 1-2 minuta për të përfunduar vizatimin.
3. Pasi të përfundojnë, kërkonin nga pjesëmarrësit që të votojnë se cila lule është më e bukur.
4. Pas votimit, filloni një diskutim me grupin mbi kriteret që janë përdorur për të gjykuar bukurinë e luleve. Pyetni pyetje si:
  - Si e di një person se çfarë po vlerësohet?
  - Si do ta përkufizonit "bukurinë" për secilin individ?
5. Kaloni në një diskutim mbi vlerësimin në vullnetarizmin edukativ duke pyetur:
  - Si e dijmë nëse kemi pasur sukses ose dështim në fund të një projekti?
  - Si e vlerësojmë punën tonë në një projekt vullnetarizmi edukativ?
  - Si do ta bënit vlerësimin për një projekt vullnetarizmi edukativ?
6. Nëse grupi nuk ofron ndonjë përgjigje, pyetni: "Kush mendoni se duhet të vlerësohet në një projekt vullnetarizmi edukativ?"
7. Prezantoni këto terma të përdorura në vullnetarizmin edukativ:
  - Vlerësim
  - Vlerësim i mësimet
  - Nota
  - Matje

- Reflektim
  - Përshtypje
  - Monitorim
8. Filloni një diskutim të shkurtër mbi kuptimin e secilit term dhe ftoni pjesëmarrësit të ndajnë kuptimin e tyre.
  9. Shpjegoni llojet e ndryshme të vlerësimit/vlerësimit në vullnetarizmin edukativ:
    - Vlerësimi = Matja e ndikimit të një projekti vullnetarizmi edukativ
    - Vlerësimi = Notimi dhe vlerësimi i rezultateve të mësimit ose i performancës individuale
    - Vlerësimi = Përshtypje mbi aspekte të ndryshme të projektit nga palët e ndryshme të interesuara
  10. Pjesëmarrësit do të ndahen në tre grupe, ku secilit grup do t'i caktohet një nga llojet e vlerësimit/vlerësimit të përmendura më lart (Matja e ndikimit, Notimi/Vlerësimi i rezultateve të mësimit, Përshtypje/Vlerësimi i implementimit të projektit).
  11. Çdo grup do të bëjë pyetjet e mëposhtme:
    - Cili është qëllimi i vlerësimit?
    - Për kë është vlerësimi?
    - Nga kush marrim informacion për të vlerësuar? Kush është i përfshirë në vlerësim?
    - Çfarë po vlerësojmë / çfarë mund të vlerësojmë?
    - Cilat mjete mund të përdorim për vlerësim?
    - Si lidhet ky vlerësim me reflektimin?
  12. Pas diskutimit në grupe, çdo pjesëmarrës do të plotësojë individualisht një plan për implementimin e një projekti vullnetarizmi edukativ duke u fokusuar veçanërisht në mënyrën se si do të trajtojnë vlerësimin për projektin e tyre.

### **Pyetje Reflektimi:**

- Si e vendosët se cila lule është më e bukur?
- Pse është e rëndësishme të vlerësojmë suksesin ose dështimin në fund të një projekti vullnetarizmi edukativ?
- Si mendoni se lidhen vlerësimi dhe reflektimi në vullnetarizmin edukativ?

### **Materialet e Nevojshme:**

- Flipchart
- Markera
- Prezantim PPT
- Fletushka – plan për implementimin e projektit të Vullnetarizmit Edukativ

### **Koha për Festë**

**Kohëzgjatja:** 30 minuta

### **Përshkrimi:**

Ky aktivitet prezanton konceptin e festimit dhe thekson rëndësinë e tij në procesin e projekteve të vullnetarizmit edukativ. Pjesëmarrësit diskutojnë dhe krijojnë ide për mënyra kreative për të festuar



përfundimin e projekteve të vullnetarizmit edukativ duke marrë parasysh llojet e ndryshme të projekteve dhe palët e interesuara të përfshira.

#### **Udhëzime:**

1. Filloni duke shpjeguar rëndësinë e festimit në procesin e vullnetarizmit edukativ dhe si ndihmon në njohjen e përpjekjeve dhe arritjeve të të gjithë personave të përfshirë.
2. Për të hyrë në temë, mund të filloni me një deklaratë si: "Tani që dimë si të mbyllim siç duhet projektet e vullnetarizmit edukativ duhet të festojmë!"
3. Pjesëmarrësit ndahen në grupe të vogla nga 3-4 persona. Secilit grup iu jepet një shembull i shkurtër i një projekti të realizuar vullnetarizmi edukativ.
4. Udhëzoni grupet të krijojnë dhe zhvillojnë ide për mënyra se si mund të festojnë përfundimin e projektit, duke marrë parasysh palët e interesuara të përfshira dhe rezultatet e projektit.
5. Jepni pjesëmarrësve 15 minuta për të punuar së bashku, duke përgatitur një prezantim të shkurtër mbi idetë e tyre për festimin dhe si i kanë përshtatur ato me shembullin specifik të projektit.
6. Lejoni secilin grup të prezantojë idetë e tij për 5 minuta.

Në fund të prezantimeve, ofroni një shpjegim të shkurtër mbi rëndësinë e festimit pas përfundimit të projekteve të vullnetarizmit edukativ duke theksuar vlerën e njohjes së kontributeve dhe shënimit të ndikimit pozitiv të projektit.

#### **Materialet e Nevojshme:**

- Fletë për flipchart
- Markera
- Shembuj të projekteve të vullnetarizmit edukativ

### **Mbyllja Kuptimplotë e Projektit të Vullnetarizmit Edukativ**

**Kohëzgjatja:** 15 minuta

#### **Përshkrimi:**

Ky aktivitet fokusohet në eksplorimin e konceptit të mbylljes në kontekstin e vullnetarizmit edukativ. Pjesëmarrësit do të reflektojnë mbi përvojat dhe ndjenjat e tyre për mbylljen e një kursi ose projekti dhe do të analizojnë se si mbyllja në vullnetarizmin edukativ mund të jetë ndryshe nga mbylljet e tjera. Përmes diskutimeve në grup dhe pyetjeve të udhëheqësit, grupi do të identifikojë elementet kryesore që kontribuojnë në një proces të saktë mbylljeje.

#### **Udhëzime:**

1. Filloni seancën duke i pyetur pjesëmarrësit: "Si jeni sot?" dhe dëgjoni përgjigjet e tyre me respekt.
2. Pas marrjes së përgjigjeve, udhëheqësit dalin nga dhoma pa shpjegime të tjera dhe presin që pjesëmarrësit t'i thërrasin për t'u kthyer. Nëse askush nuk vjen t'i thërrasë pas 5 minutash, udhëheqësit rikthehen vetë në dhomë.

3. Pasi udhëheqësit kthehen, ata i kërkojnë grupit: "Çfarë mendoni se ndodhi këtu?" dhe "Si u ndjetë në këtë situatë?" Mblidhni mendimet dhe opinionet e grupit.
4. Pas disa përgjigjeve, udhëheqësit zbulojnë: "Për ne, kjo ishte fundi i kursit. Çfarë mendoni për këtë informacion?" dhe vazhdojnë të mbledhin mendimet dhe ndjenjat nga pjesëmarrësit.
5. Kalon në një seri pyetjesh reflektive për grupin:
  - o "Si do të na kishit dashur t'ua jepnim këtë informacion që ta kuptonit qartë se ky është fundi i kursit?"
  - o "Si duhet të menaxhoni mbylljen në këtë lloj situatë?"
  - o "Ku në procesin e vullnetarizmit edukativ mund të hasim këtë situatë?"
  - o "A mund të gjeni ndonjë veçori të mbylljes për një projekt vullnetarizmi edukativ? Si mendoni se është ndryshe nga çdo kurs tjetër?"
6. Ndërkohë që një udhëheqës drejton diskutimin, tjetri shënon idetë kryesore në një flipchart, duke u fokusuar në aspektet e mbylljes që identifikojnë pjesëmarrësit.
7. Pasi të jenë mbledhur mendimet, udhëheqësit e përfundojnë seancën duke theksuar elementët kryesorë të nevojshëm për një mbyllje të saktë duke i'u referuar ideve të shkruara në flipchart.
8. Udhëheqësit mund të zgjedhin të theksojnë disa pika që ata mendojnë se janë më të rëndësishme për pjesëmarrësit për t'i kuptuar në lidhje me mbylljen në vullnetarizmin edukativ.

#### **Pyetje Reflektimi:**

- Cili ishte reagimi juaj i parë kur ne dolëm nga dhoma?
- Si ndikoi përvoja e pritjes në kuptimin tuaj të mbylljes?
- Pse mendoni se mbyllja është e rëndësishme në projektet e vullnetarizmit edukativ?
- Çfarë e bën mbylljen në projektet e vullnetarizmit edukativ ndryshe nga mbylljet e tjera?

#### **Materialet e Nevojshme:**

- Fletë për flipchart
- Markera

### **Cinquain**

**Kohëzgjatja:** 10 minuta

#### **Përshkrimi:**

Cinquain është një ushtrim reflektues që ka për qëllim të ndihmojë pjesëmarrësit të përmbledhin dhe kapin mendimet, emocionet dhe besimet e tyre kryesore mbi një temë përmes frazash të shkurtra. Përmes përdorimit të këtij formati pesë-linjësh, pjesëmarrësit përmbledhin njohuritë e tyre në një mënyrë që thekson aspektet më të rëndësishme të temës. Ky aktivitet mund të kryhet individualisht ose në grupe të vogla në varësi të vendit të zhvillimit.

#### **Udhëzime:**

1. Shpjegoni strukturën e Cinquain dhe ofroni udhëzime për pjesëmarrësit:
  - o Linja 1: Shkruani një fjalë për të emëruar temën (një emër).
  - o Linja 2: Përdorni dy fjalë (ndihmuese) për të përshkruar temën.

- Linja 3: Përdorni tre fjalë (folje) për të shprehur një veprim ose histori të lidhur me temën.
  - Linja 4: Shkruani një fjali me katër fjalë që shpreh një lidhje emocionale ose qëndrimin personal ndaj temës.
  - Linja 5: Shkruani një fjalë përfundimtare që kap esencën ose një sinonim të temës në linjën e parë.
2. Jepni pjesëmarrësve kohë për të krijuar Cinquain-in e tyre.
  3. Ftoni pjesëmarrësit të ndajnë Cinquain e tyre me grupin duke nxitur një diskutim të hapur mbi perspektivat dhe njohuritë e ndryshme.

#### **Materialet e Nevojshme:**

- Fletë dhe pena për çdo pjesëmarrës (opsionale: fletushka të përgatitura me strukturën e Cinquain)
- Flipchart ose tablo për çdo shembull që mund të dëshirojë të demonstrojë trajneri

#### **Çfarë pritet nga ne?**

**Kohëzgjatja:** 5 minuta

#### **Përshkrimi:**

Ky është një ushtrim i shkurtër reflektues, ku pjesëmarrësit rishikojnë pritshmëritë që vendosën në fillim të trajnimit. Qëllimi është që secili pjesëmarrës të vlerësojë nëse pritshmëritë e tij apo saj fillestare u realizuan dhe të reflektojnë mbi përvojën e tyre personale të mësimit.

#### **Udhëzime:**

1. Përsëritni për pjesëmarrësit pritshmëritë që ata diskutuan ose shkruan në fillim të sesionit të trajnimit.
2. Kërkoni që ata të marrin një moment për të menduar nëse dhe si trajnimi i plotësoi ato pritshmëri.
3. Inkurajoni pjesëmarrësit të ndajnë nëse ndihen komod, mendime mbi si trajnimi plotësoi ose nuk plotësoi pritshmëritë e tyre, si dhe çdo njohuri të papritur që ata fituan.

#### **Materialet e Nevojshme:**

- Flipchart ose tabelë për të shfaqur listën origjinale të pritshmërive (nëse është e disponueshme)

### **3 PPP në Projektet e Vullnetarizmit Edukativ**

Kjo strukturë udhëzon trajnerin përmes hapave duke siguruar që ai të mund të menaxhojë aktivitetin në mënyrë efikase, duke angazhuar pjesëmarrësit në diskutime kuptimplotë mbi Vullnetarizmin Edukativ.

#### **Materialet:**

- Flipchart dhe markera
- Përshkrimi i projektit të Vullnetarizmit Edukativ për secilin grup (përshkrim i shkurtër me qëllimin e shërbimit, lëndët e lidhura dhe aktivitetet e projektit)
- Diagram vizual i hapave të Vullnetarizmit Edukativ (për frymëzim)

- Ngjitëse post-it me ngjyra (të verdhë, portokalli, të kuqe, blu, jeshile)
- Karta me muajt e vitit shkollor për aktivitetin e hartës kohore për secilin grup

**Kohëzgjatja:** 60 - 80 min.

- Prezantimi – 5 min.
- 20 minuta për pjesën e parë të aktivitetit (hartimi i hapave të Vullnetarizmit Edukativ)
- 5-10 minuta për grupet të shkëmbejnë dhe diskutojnë flipchart-et e tyre
- 10 minuta për të shënuar hapat
- 10 minuta për aktivitetin e hartës kohore (lidhen hapat e Vullnetarizmit Edukativ me muajt)
- 15-20 minuta për prezantimet e grupeve dhe reflektimin

**Udhëzimet për trajnerin:**

**Përgatitja Fillestare:**

- Pjesëmarrësit ndahen në grupe prej 4-5 personash.
- Jepni secilit grup një përshkrim të shkurtër të një projekti Vullnetarizmi Edukativ duke përfshirë qëllimin e shërbimit, lëndët me të cilat projekti lidhet dhe aktivitetet e përfshira.
- Shpjegoni detyrën: secili grup duhet të ndaj hapat e projektit të Vullnetarizmit Edukativ nga hartimi i nevojave deri te festimi duke përfshirë edhe hapat ndërmjetës.
- Ndani një diagram vizual të procesit të Vullnetarizmit Edukativ (p.sh., një diagram fluksi) për t'i ndihmuar ata të orientohen.
- Përdorni një kohëmatës për 20 minuta që grupet të hartojnë hapat e Vullnetarizmit Edukativ në flipchart.

**Puna në Grup (20 minuta):**

- Udhëzo grupet të punojnë së bashku për të detajuar hapat e procesit të Vullnetarizmit Edukativ në flipchart. Ata duhet të përfshijnë:
  - Hartimi i nevojave
  - Zhvillimi i qëllimit të shërbimit
  - Planifikimi i aktiviteteve
  - Ekzekutimi i aktiviteteve të shërbimit
  - Reflektimi mbi procesin
  - Festimi i rezultateve
  - Hapat ndërmjetës (si monitorimi i progresit, rregullimi i planeve, etj.)
- Inkurajoni kreativitetin dhe sigurohuni që të gjithë anëtarët e grupit të kontribuojnë.

**Shkëmbimi i Grupit dhe Përshtypjet (5-10 minuta):**

- Pasi të kalojnë 20 minutat, kërkoni që grupet të shkëmbejnë flipchart-et me një grup tjetër.
- Grupi tjetër do të shqyrtojë flipchart-in që kanë krijuar dhe do të reflektojnë mbi mënyrën se si ata e adresuan detyrën.
- Ata mund të shtojnë sugjerimet, ide të tjera ose mendime në flipchart-in që marrin.

### **Caktimi i Roleve (15-20 minuta):**

- Shpërndani ngjitëse post-it me ngjyra për secilin grup. Secila ngjyrë do të përfaqësojë një nivel të ndryshëm angazhimi ose përgjegjësie në procesin e Vullnetarizmit Edukativ:
  - Të verdhë: Fëmijët/ të rinjtë mund të kryejnë këtë hap vetë
  - Portokalli: Fëmijët/ të rinjtë mund ta bëjnë këtë hap me udhëzim të mësimitdhënësit
  - Të kuqe: Fëmijët/ të rinjtë mund të marrin pjesë në këtë hap por kërkojnë udhëheqje të fortë nga mësimitdhënësit
  - Blu: Roli i mësimitdhënësit në këtë hap
  - Jeshile: Roli i një palë të jashtme (p.sh., udhëheqësia e shkollës, organizatat e komunitetit, grupe të tjera)
- Kërkoni që grupet të vendosin ngjitëset me ngjyra pranë çdo hapi në flipchart. Ata mund ta bëjnë këtë individualisht ose në grupe, sipas dinamikave dhe aftësive të komunikimit të pjesëmarrësve.
- Pasi të përfundojnë, vendosni të gjitha flipchart-et në qendër të dhomës për prezantim.

### **Prezantimet e Grupeve dhe Reflektimi (15-20 minuta):**

- Kërkoni që çdo grup të prezantojë hapat e Vullnetarizmit Edukativ dhe rolet që kanë caktuar duke përdorur ngjitëset me ngjyra.
- Udhëhiqni një diskutim mbi qëllimet e aktivitetit, duke theksuar rëndësinë e angazhimit dhe pjesëmarrjes së fëmijëve/të rinjve në projektet e Vullnetarizmit Edukativ. Mund të prezantoni konceptin e "shkallës së pjesëmarrjes" duke shpjeguar se si fëmijët/të rinjtë mund të marrin gradualisht më shumë përgjegjësi ndërsa projekti përparon.
- Theksoni rolin e mësimitdhënësit gjatë gjithë procesit dhe rëndësinë e planifikimit të kujdesshëm në projektet e Vullnetarizmit Edukativ.

### **Planifikimi i Afateve Kohore (10 minuta):**

- Jepni karta me muajt e vitit shkollor të shkruara mbi to.
- Kërkoni që pjesëmarrësit të caktojnë çdo hap të projektit të Vullnetarizmit Edukativ për një muaj ose periudhë kohore të caktuar gjatë vitit shkollor.
- Lejoni 10 minuta për të organizuar hapat në hartën kohore.
- Grupi të prezantojë hartën kohore dhe të diskutojnë rëndësinë e planifikimit, vendosjes së pritshmërive të realizueshme dhe mos nxjerrjes në përfundime të nxituara.

### **Diskutimi mbi Fazën e Planifikimit:**

- Përmbyllni diskutimin duke theksuar se faza e planifikimit të një projekti Vullnetarizmi Edukativ është vendimtare dhe nuk duhet nxituar.
- Diskutoni si përgatitja, sigurimi i lejeve dhe detyrat e tjera logjistike janë mundësi të vlefshme mësimi për fëmijët/të rinjtë.

**Shënim:** Aktiviteti mund të udhëhiqet duke ndarë pjesën e parë – përshkrimi i hapave individualë të projektit midis grupeve në blloqe (1- hartimi, përgatitja për zbatimin e Vullnetarizmit Edukativ + hapa

ndërmjetës, 2- ndarja e detyrave, zbatimi + hapa ndërmjetës, 3- vlerësimi, festimi + hapa ndërmjetës). Aktiviteti me përcaktimin e një plani kohor është gjithashtu opsional.

## **Porta - Rrugëtimi im i Vullnetarizmit Edukativ**

Ky aktivitet u jep pjesëmarrësve kohë për kreativitet, reflektim personal dhe shpërndarje në grup, duke u mundësuar ata të lidhin përvojat e tyre të mësimin në një mënyrë kuptimplotë dhe të paharrueshme. Mund ta përdorni këtë aktivitet në bllokun e Reflektimit ose në fund të trajnimit për të reflektuar mbi të gjithë procesin dhe përparimin edukativ.

### **Materialet:**

- Letra të bardha dhe me ngjyra (p.sh., A4, fletë të mëdha)
- Shënime ngjitëse (Post-it)
- Gërshërë
- Penca, marka dhe ngjyra
- Ngjitës letre, ngjitës
- Piktura dhe penela
- Plastelinë
- Litar ose mëndafsh
- Shkopinj druri ose materiale të tjera të vogla artizanale (opsionale)
- Qiri, muzikë

### **Kohëzgjatja:**

- Të paktën 30 minuta për krijimin
- 15-20 minuta për prezantimet

### **Udhëzimet për trajnerin**

#### **Përgatitja Fillestare:**

- Përgatiteni dhomën duke vendosur materialet (letër, marka, gërshërë, shënime ngjitëse, etj.) në qendër duke i mundësuar pjesëmarrësve të kenë qasje në gjithçka që u nevojitet për aktivitetin.
- Vendosni tonin për aktivitetin duke e errësuar dritën ose ndezur një qiri për të krijuar një atmosferë të qetë dhe reflektuese. Luani muzikë të qetë dhe të butë në sfond për të inkurajuar fokusimin dhe kreativitetin.

#### **Hyrje në Aktivitet (5 minuta):**

- Shpjegoni pjesëmarrësve se ata do të krijojnë një "portë" simbolike që përfaqëson udhëtimin e tyre personal përmes përvojës së Vullnetarizmit Edukativ. Kjo portë duhet të simbolizojë kalimin e tyre përmes trajnimit atë që kanë mësuar dhe atë që shohin për të ardhmen.
- "Porta" mund të jetë një përfaqësim literal ose abstrakt. Duhet të jetë diçka që reflekton se ku kanë qenë (sa i përket mësimëve, perspektivave mbi Vullnetarizmin Edukativ, mësimdhënien, vullnetarizmin ose rritjen personale) dhe ku po shkojnë pas trajnimit.

- Theksoni që nuk ka mënyra të gabuar ose të drejta për të krijuar portën. Duhet të jetë personale dhe kuptimplotë për secilin pjesëmarrës.

### **Krijimi i "Portës" (30 minuta):**

- Udhëzoni pjesëmarrësit të fillojnë të punojnë me materialet e ofruara. Ata mund të zgjedhin se si ta krijojnë portën duke përdorur letra, markera, shënimet ngjitëse dhe çdo material tjetër.
- Inkurajoni ata të jenë kreativ:
  - Mund të vizatojnë, pikturojnë, presin forma, ose përdorin plastelinën për të përfaqësuar elemente të ndryshme të udhëtimit të tyre.
  - Përdorni shënime ngjitëse për të shkruar reflektime specifike ose momente kyçe të trajnimit që ata dëshirojnë të vizualizojnë.
  - Porta mund të përfaqësojë një strukturë fizike (si një hark ose derë), ose një koncept më abstrakt (si një seri hapash, një urë ose një rrugë).
- Ndërkohë që ata punojnë, trajneri duhet të qarkullojë për të ofruar mbështetje dhe për të angazhuar një bisedë të lehtë me pjesëmarrësit, duke i inkurajuar ata të reflektojnë më thellë mbi udhëtimin e tyre deri tani dhe pritshmëritë e tyre për të ardhmen.

### **Reflektimi dhe Prezantimi (15-20 minuta):**

- Pasi portat të jenë përfunduar, ftojini çdo pjesëmarrës të prezantojë krijimin e tij para grupit. Ata duhet të shpjegojnë:
  - Çfarë përfaqëson porta (çfarë është mësuar, rritje personale, ose ndryshim gjatë trajnimit)?
  - Cilat aspekte të Vullnetarizmit Edukativ, mësimdhënies, ose vullnetarizmit janë ndryshuar ose forcuar?
  - Çfarë parashikojnë përtej portës (planet, objektivat ose kuptimet e reja për aplikimin e Vullnetarizmit Edukativ në të ardhmen)?
- Inkurajoni pjesëmarrësit të reflektojnë mbi lidhjet mes udhëtimit të tyre të mësimit dhe portës që kanë krijuar.
- Pas çdo prezantimi, lëri hapësirë për komente të shkurtra ose pyetje nga pjesëmarrësit e tjerë. Kjo mund të ndihmojë në thellimin e përvojës së përbashkët dhe procesit të reflektimit.

### **Reflektimi përmbyllës - opsional (i përshtatshëm nëse përfshini këtë aktivitet në bllokun e Reflektimit):**

- Pas prezantimit të të gjithëve, udhëhiqni grupin në një diskutim të shkurtër mbi procesin:
  - Si janë ndjerë duke reflektuar për të kaluarën dhe të ardhmen në një mënyrë kaq krijuese?
  - Çfarë mësimesh morët nga dëgjimi i reflektimeve të të tjerëve?
  - Si mund të ndihmojë ky ushtrim në punën e tyre të ardhshme me projektet e Vullnetarizmit Edukativ?

- Përfundoni aktivitetin duke njohur përpjekjet dhe kreativitetin e të gjithë pjesëmarrësve. Theksoni që ashtu si porta që krijuan, udhëtimi i tyre me Vullnetarizmin Edukativ është një proces i vazhdueshëm dhe në zhvillim.





# VULLNETARIZMI EDUKATIV

